



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 13 SHKURT 2014**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13. FEBRUARA 2014. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2014**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Shërbimin mjekësor emergjent,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligji për sigurimin shëndetësor,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligji për skemat pensionale të financuara nga Shteti,
12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Razmatranje Predloga-programa rada Skupštine za 2014. god.
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona o registraciji poljoprivrede,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o osnivanju Agencije za službu vazdušne navigacije,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o emergentnoj zdravstvenoj službi,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o mentalnom zdravlju,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o stručnom osposobljavanju, reosposobljavanju i zapošljavanju osoba sa ograničenim sposobnostima,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zdravstvenom osiguranju,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o zaštiti konkurencije,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o penzijskim šemama finansiranim od države,
12. Osnivanje Ad hoc Komisije za izbor članova Nezavisne komisije za medije.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Standard në këtë pikë është deputeti Halit Krasniqi. Regjia, fjalën deputetit Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,
Për ta relativizuar diskutimin për përvjetorin e një ngjarjeje tragjike, ishte krijuar një alibi për një pretekst shkencor me premisat komprometuese për një CV akademike, por që nuk ishte e vetmja dhe nuk do të duhej të bëhej kështu komprometim i trurit nacional, siç është universiteti.

Sa më shumë që përplasemi për teori të pragmatizmit politik, sa më shumë zhvillime të padinjitetshme në emër të perspektivës më të mirë, që konfrontojnë opozitën me institucionet e Republikës së Kosovës, sa më të shpeshta që janë aksionet e opozitës, aq më i madh për ne bëhet Fan Noli. Sa më të ashpra të bëhen përplasjet në diskurse fetare, aq më i madh duket Gjergj Fishta. Sa më shumë ashpërsohet gjuha në mbrojtje të Islamit, aq më i madh bëhet myderrizi Ymer Prizreni deri te Mulla Maliqi dhe një armatë e hoxhallarëve nëpër shekuj, të cilët i janë kundërvënë pushtimit shumëshekullor otoman.

Sa më shumë ndarje regjionale që manifestohen në angazhimet tona politike, aq më i madh bëhet Abdyl Fashëri, por veçanërisht edhe aktual për inspirim që është qëndrimi i Fan Nolit pas Luftës së Dytë Botërore. Ky peshkop dhe tribun i demokracisë i qetësonte dhe i inkurajonte bashkëkohanikët në SHBA, duke u thënë “Lëreni shembjen e demokracisë, shembjen e tempujve fetarë, duhet ta ndihmojmë Shqipërinë të anëtarësohet në familjen e kombeve”. Për 10 vjet e kishte këtë justifikim, kur Shqipëria u anëtarësua ai bashkëkohanikëve edhe 10 vjet të tjera u kërkonte të kenë durim deri të forcohet shteti si i identitet i tyre.

Mendojeni kur ka qenë shtet Kosova në këtë mbamendje njëvjeçare. Me përplasjet 500-vjeçare për t’u çliruar populli shqiptar nga pushtimi otoman, me gërhamat e fundit çliroi 28 mijë km/2, duke lënë edhe dy herë pjesë të atdheut të copëtuara në robëri të ndryshme.

Pas 100 vjet përpjekjesh u arrit çlirimi i afro 11 mijë km/2 të vendit tonë që i quajmë Kosovë dhe që në vitet e para dalin zëra të ngulfatin rritjen e këtij shteti me dallimin, kërkesat - të gjithë janë rreshtuar në një qëllim, në këtë front - me çfarëdo emërtimi të diskurseve justifikuese: Poshtë KFOR-i!, Jashtë UNMIK-u!, Jashtë EULEX-i!, mbrojtje

të prodhimeve vendore, kundër marrëveshjes, autonomi universitare, kundër e pro, e pro e kundër, pretekst pas preteksti, justifikim pas justifikimi, për ta mbuluar qëllimin, i cili do të krijojë anarki e përçudnim, sterkeqe e komprometim, gjuhëzim në prapqthim.

Dashtë Zoti të mbeten në kujtesën tonë e të brezave si kujtime të këqija të gjitha këto përpjekje dhe protagonistë të tyre që e pengojnë forcimin e integritetit të shtetit tonë dhe rritjen e dinjitetit të popullit tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Skënder Hyseni.

SKËNDER HYSENI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Çështja të cilën dua ta ngre sot këtu, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është dialogu aktual me Republikën e Serbisë, që po zhvillohet në Bruksel, dhe është shqetësim i bazuar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mosraportimi në pajtim me Rezolutën e këtij Kuvendi nga kryeministri i Republikës për rrjedhjen e këtyre bisedimeve.

Mosraportimi dhe të gjitha spekulimet që aty-këtu bëhen në opinion e bëjnë akoma më shqetësuese mungesën e transparencës, përkatësisht faktin që ky Kuvend dhe opinioni në Kosovë si i tillë lihet në terr pothuaj total informativ rreth rrjedhës, përmbajtjes dhe një varg marrëveshjes të paralajmëruara që do të arrihen javëve në vijim në Bruksel.

Më lejoni në këtë pikë ta theksoj pëlqimin parimor që LDK-ja i jep dialogut si instrument për t'i zgjidhur të gjitha problemet, e në veçanti me fqinjët, e në veçanti në këtë rast edhe me Republikën e Serbisë, dhe LDK-ja nuk shmanget asnjëherë nga parimi se nuk ka zëvendësim për dialogun që të arrihen këto qëllime madhore për një stabilitet përfundimtar në Ballkan. Mirëpo, LDK-ja e kundërshton dialogun vetëm sa për dialog, kundërshton çfarëdo lloj dialogu sa për faktin që dikush të duket mirë para kamerave, qoftë në Prishtinë, qoftë në Bruksel, qoftë në Beograd, kudo qoftë.

LDK-ja është për një dialog përmbajtjesor që do të arrijë zgjidhje të qëndrueshme, që nuk do ta dëmtojë asnjë variant karakterin unitar të Kosovës. Po flitet për marrëveshjet së shpejt për gjyqësinë. LDK-ja fton që çfarëdo marrëveshje në këtë fushë ta ruajë totalisht unitaritetin e legjislacionit, unitaritetin e jurisprudencës, unitaritetin gjyqësisë së Kosovës. Kjo është thelbësore dhe për të gjitha këto Lidhja Demokratike e Kosovës e fton kryeministrin që në rastin e parë të mundshëm t'i raportojë këtij Kuvendi dhe opinionit të gjerë në Kosovë mbi rrjedhat në këtë proces.

Flitet shumë për marrëveshjet që mund të arrihen, por, të nderuar deputetë, ju dhe të gjithë ne dimë shumë pak. Unë dua ta theksoj edhe njëherë që të mos ketë keqinterpretime dhe spekulime rreth qëndrimit shumë parimor dhe të qartë të LDK-së. LDK-ja qëndron fuqishëm për dialog me fqinjët, në rend të parë me Serbinë. Mirëpo, LDK-ja mendon se normalizim të plotë të marrëdhënieve me Republikën e Serbisë do të ketë vetëm atëherë kur këto dy shtete do ta njohin njëra-tjetrën si shtete të pavarura dhe sovraane, dhe mbi bazën e njohjes si shtete të pavarura dhe sovraane do të ndërtojnë raporte

edhe fqinjësore, edhe ndërshtetërore, do të hyjnë në marrëveshje të llojllojshme rreth bashkëpunimit, që është pjesë e bashkëpunimit të përgjithshëm rajonal.

Zotni kryetar!

Në emër të Grupit të LDK-së, unë kërkoj që ju në mbledhjen e parë ta shtroni kërkesën që kryeministri i Kosovës t'i raportojë Kuvendit mbi rrjedhat e dialogut në Bruksel. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit Skënder, por marrëveshjen e kemi ratifikuar në Kuvend. Ju po e shihni si raporton Qeveria në Kuvend. Fjalën e ka Faton Topalli, me kartelën e deputetes Albulena Haxhiu.

FATON TOPALLI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Është folu bukur shumë për reformën zgjedhore në Kosovë dhe mundësitë më të mira që zgjedhjet e ardhshme parlamentare të jenë më të rregullta dhe të jenë më demokratike se që kanë qenë deri tash.

Më vjen keq që në këtë diskutim për reformën zgjedhore, të zhvilluar për më shumë se dy vjet me radhë, më së paku i është kushtuar rëndësi pjesëmarrjes së qytetarëve të Kosovës jashtë vendit në procesin zgjedhor dhe përfaqësimin e tyre në Parlamentin e Kosovës.

Kur flasim për mërgatën, nuk po flasim për arbëreshët e Italisë, as për shqiptarët e Turqisë, siç i trajtoi ata Qeveria aktuale e Kosovës, por po flasim për qytetarët e Kosovës të dëbuar me dhunë politike, apo ekonomike. Po flasim për qytetarët e vendit tonë me dokumente të identitetit, me pasaporta të Kosovës. Po flasim për 30 deri 40% të popullsisë së Kosovës, sepse vetëm në Gjermani dhe Zvicër jetojnë mbi 500 mijë prej tyre. Pra, po flasim për qytetarët që mbajnë lidhje të ngushta me atdheun dhe që janë thellësisht të interesuar për proceset politike, gjë që ata e kanë dëshmuar për dekada me radhë.

Qytetarët jashtë vendit janë faktor i rëndësishëm ekonomik për vendin tonë. Në vitin 2000, sipas Drejtorisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Zvicrës, mërgata jonë dërgoi në Kosovë 550 milionë marka, gjë që në atë kohë përbënte 17% të të ardhurave kombëtare të vendit tonë. 25% e të gjitha bizneseve në Kosovë janë themeluar me fonde të pjesërishme ose të plota të krijuara nga puna jashtë vendit.

Prej vitit 2004 e deri në vitin 2008, emigracioni i Kosovës ka dërguar në Kosovë 2,4 miliardë euro, pra më shumë mjete se të gjitha ndihmat ndërkombëtare për zhvillim që në atë kohë kapnin vlerën prej 2,3 milionë eurosh. Sot mërgata e Kosovës sjell mjete materiale me vlerë prej 600 milionë eurosh në vit. Kjo shumë është më e lartë se 1/3 e buxhetit aktual të Kosovës. Asnjë ndërmarrje në Kosovë, asnjë korporatë, qoftë vendore, qoftë e huaj, nuk i siguron ekonomisë së vendit më shumë të ardhura, asnjë sigurim shoqëror i shtetit të Kosovës nuk kontribuon më shumë se sa mërgata shqiptare për ruajtjen e paqes sociale në vend.

Dhe, në të njëjtën kohë asnjë shtresë e shoqërisë së Kosovës nuk është lënë kaq shumë anash dhe nuk është trajtuar me kaq shumë ironi dhe shpotitje sa mërgata e Kosovës.

Të rezervosh 20 vende në Parlamentin e Kosovës për 5% të popullsisë dhe të mos mundësosh për 30 deri 40% të qytetarëve jashtë vendit ta kenë një përfaqësim politik në Parlament, nuk është vetëm miopi politike, injorancë, bukëpërmbysje, por edhe shkelje themelore e të drejtave të njeriut dhe përjashtim i qytetarëve nga procesi i vendimmarrjes dhe përfaqësimit demokratik në Parlamentin e Kosovës.

Me ligjin aktual për zgjedhjet, qytetarët e Kosovës jashtë vendit e kanë vetëm formalisht të drejtën e votimit, ndërsa praktikisht për shkak të procedurave të komplikuar dhe të afateve të shkurtra kohore për t'u regjistruar për votim përjashtohen nga kjo e drejtë. Këtë e vërteton më së miri fakti që në zgjedhjet e vitit 2010, vetëm 1014 prej tyre morën pjesë në zgjedhje. Ne kërkojmë të thjeshtëzohen procedurat e pjesëmarrjes në votim për ta siguruar mundësinë për një pjesëmarrje sa më të gjerë edhe të mërgimtarëve shqiptarë.

Në lidhje me këtë temë, ne kemi paraqitur një varg propozimesh konkrete para komisionit dhe do t'i paraqesim ato sa herë që të jetë nevoja. Kërkojmë që mërgimtarët shqiptarë të marrin pjesë në proceset politike në Kosovë, sepse ata përbëjnë 30 deri në 40% të popullsisë që jeton jashtë vendit tonë. Pra, është shkelje demokratike që të përjashtosh 30% qytetarëve nga procesi i vendimmarrjes.

KRYETARI: Zgjidhni disa tema pak më të buta në deklaratimet jashtë rendit të ditës! Fjalën e ka deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

DONIKA KADAJ-BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja të cilën dua ta trajtoj është temë disaditore në media dhe në opinion. Bëhet fjalë për të dhënat dhe deklaratat shumë kontradiktore ndërmjet palëve të interesuara për çështjen e naftës, e cila po shfrytëzohet për ngrohje nëpër shkolla në Prishtinë, ku për çdo ditë po kemi informata nga palët, qoftë ministritë përkatëse, qoftë Komuna e Prishtinës, qoftë opinionin, që nafta, e cila po shfrytëzohet, është ose s'është kancerogjene.

Kjo me të drejtë ka nxjerr panik te qytetarët, te prindërit, te të gjithë ne që jetojmë në Prishtinë, por edhe te qytetarët e Kosovës, në përgjithësi. Po e ngre këtë çështje, sepse pas angazhimit për të kuptuar se cila është e vërteta, ose për t'i rehatuar shpirtrat, edhe veten time, sepse jam nënë që dy fëmijë i kam në shkollën "Hasan Prishtina", kemi gjetur të dhëna që në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në fakt, janë dy institute, të cilat kohë më parë kanë ngrehur padi në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me ç'rast e kanë paditur Mimoza Kusari-Lilën, atëherë ministre e Tregtisë dhe Industrisë, Bernard Nikajn, shef i Kabinetit, dhe dy anëtarë të tjerë, kryeinspektorin dhe drejtorin e Akreditimit.

Në këtë akt padi thuhet: "Kundër ndotjes së ambientit me gazra kancerogjene dhe për dëmtim financiar të bizneseve të licencuara me vlerë, të cilën e cakton gjykata sipas parametrave të kapitullit 11, të propozuar me këtë padi nga paditësit". Nuk po e lexoj tutje, sepse është punë e gjykatës, mirëpo po kërkoj që në gjithë këtë maskara, e cila ka

ndodhur në javët e fundit, të gjitha organet, të pandikuara politikisht, organet profesionale, këtu edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, të dalin t'i kryejnë punët e veta, do të thotë edhe organet e hetuesisë, edhe trupat e tjerë të autorizuar, në mënyrë që të jepet një përgjigje e saktë, e papolitikë, një çështjeje kaq themelore dhe kaq të ndjeshme për qytetarët dhe për të gjithë ne.

Po dua të theksoj se në këtë vit, në Kosovë janë paraqitur 730 raste të reja të kancerit dhe për çdo ditë të sëmurët nga kanceri janë fëmijë të moshës shumë të re. Prandaj, dalja në opinion me këto informata, jo vetëm që po shqetëson, por në fakt është një temë, e cila ka bërë panik te prindërit, te qytetarët dhe kemi borxh si institucione, në rend të parë ministritë përkatëse, por edhe komunat, që të dalin me informata të sakta dhe të japin informata të sakta të papolitizuara.

Në këtë rast, edhe organet e hetuesisë ta japin përgjigjen e vet në raport me lëndën, e cila gjendet atje pothuajse 2-3 vjet e papërfillur. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka kryetarja e Grupit e Koalicionit për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Përshëndetje për deputetët,

Duke marrë parasysh se e kam një kërkesë nga bizneset e naftës, Shoqata e Afaristëve Naftëtarë të Kosovës kërkon nga Kuvendi që t'i përkrahim kërkesat e tyre që Ministria e Financave për kompensimin e pajisjeve fiskale, si për shembull në formë të TVSH-së, apo të tatimit në fitim për të gjitha pikat e karburantit që operojnë në gjithë territorin e Kosovës, duke e ndjekur shembullin e vendeve të rajonit, si për shembull të Shqipërisë.

Ne, siç e dimë, pikat e shitjes së naftës kanë pasur një fiskalizim që në vitin 2010, gjë që e cila ka kushtuar mjaft shtrenjtë për blerjen e pajisjeve dhe për mirëmbajtjen e tyre. Njëkohësisht, kërkoj nga ministri i Financave, edhe pse nuk është këtu, dhe nga gjithë Qeveria, në rast se duam që të bëjnë lehtësira për bizneset e vogla dhe të mesme, në rast se ata duan që ta bëjnë edhe një fiskalizim të dytë me 8 500 euro, atëherë do të jetë një ngarkesë e madhe për bizneset e vogla dhe të mesme.

Kërkoj nga ministri i Financave, duke e ditur që është njeri i biznesit, që të hiqen shpenzimet, apo kompensimi i tyre të bëhet nëpërmjet taksave, të cilat mund t'i paguhen Administratës Tatimore në formë më të shkurtër, mirëpo jo që të bëhet fiskalizimi i dytë me shumë marramendëse dhe të ndërpritet Inspektorati i Administratës Tatimore, i cili për momentin është duke u shkaktuar gjoha shumë të mëdha.

Kërkoj në formë të prerë që ministri i Financave dhe Administrata Tatimore të merren seriozisht me çështjen e bizneseve, që të mos i detyrojnë bizneset e vogla dhe të mesme të mbyllën për arsyet e fiskalizimit të dytë, duke e ditur se në shumë vende të rajonit arkat fiskale janë dhënë nga shteti, ndërsa janë kompensuar në forma tjera, që të mos dëmtohet shteti. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë veç dua ta falënderoj Kuvendin për djegien e bleshkëve të Prevallës së Brezovicës që miratoi planifikimin hapësinor të martën këtu. Është një përgjegjësi e Kuvendit që ua dha zjarrin pishave atje, edhe e deputetëve që patën guximin ta miratojnë atë. Këto janë raporte të policisë për 2 hektarë që veç janë djegur dhe e kanë sakrifikuar edhe jetën e tyre për shuarjen e atij zjarri dhe është një çudi që më 12 shkurt digjen pyjet në Kosovë.

Për çështjen e naftës, Shoqata e Naftëtarëve e ka bërë një kallëzim penal në Prokurorinë Themelore të EULEX-it, edhe në Prokurorinë Speciale dhe nuk është çështje e tashme e janarit, ose e shkurtit të vitit 2014, por kjo është prej viteve 2011, 2012, 2013, dhe kjo është lënda që e kanë dërguar ata në Prokurori për Mimoza Kusari-Lilën, atëherë ministre, tash kryetare e Gjakovës, e cila i ka bërë keqpërdorimet dhe e ka lejuar naftën me sasi të PPM-it deri në 1 000 herë ose 700 herë është sasia më e madhe e lejuar e naftës, e cila tash thuhet që është kancerogjene.

Ne nuk do të merremi nëse është apo s'është, por do të merremi me atë se sasia e sulfurit është shumë e madhe në atë naftë dhe nuk është çështje vajit që e kanë deklaruar, por është çështje e naftës, e cila është e dëmshme për shëndetin e njeriut thjesht në Kosovë dhe kjo ka shkaktuar pasoja edhe te nxënësit, siç e tha edhe Teuta. Prandaj, pajtohem me Teutën, por, megjithatë, një lëndë është e ngritur në vitin 2013, nuk është e 2014, për çështjen e Mimosës. Ajo duhet t'i përgjigjet kësaj lënde për shkatërrimin dhe prishjen e cilësisë dhe ajrit në Kosovë.

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Edhe unë do të vazhdoj me çështjen, e cila e shqetëson Shoqatën e Naftëtarëve dhe sektorin e këtij biznesi, komunitetit të biznesit në tërësi.

Së pari, nuk duhet të keqkuptohem se as ne si Lidhje Demokratike dhe as Shoqata e Naftëtarëve nuk janë kundër fiskalizimit. Bile ne jemi që ky proces i filluar që sa vite të përfundojë, sepse kjo gjendje e ka deformuar konkurrencën e lirë në treg dhe e ka thelluar tutje evazionin fiskal.

Shoqata e Naftëtarëve e ka hallin e fiskalizimit dhe atë me plot të drejtë. Pasi është kryer procesi i fiskalizimit në këtë sektor komplet, në fund të vitit 2012, Administrata Tatimore e Kosovës nxjerr një njoftim, me të cilin kërkon nga të gjitha pikat e karburantit në Kosovë që të vënë arka fiskale elektronike, të cilat kushtojnë 4 210 euro për një aparat.

Në letrën e një afaristi dërguar ministrit të Financave dhe më pas përcjellë te ne, thuhet: "Ne sot i fiskalizuar aparatet tona, ku për dy aparate në pikën e shitjes u desh të paguhen 8 417 euro". Ky është çmimi më i shtrenjtë në botë dhe këtu thuhet se asnjë kompjuter në botë nuk kushton kaq me 50 metra kablllo. Dhe, për kompensimin e kësaj kostoje, një

pikë e karburantit duhet të shesë 300 000 litra karburant, gjë që shumica e pikave të shitjes në Kosovë nuk e arrijnë brenda vitit.

Nga pamundësia, thotë, për t'i fiskalizuar të katër aparatet, ne kemi vendosur që dy prej pikave t'i mbyllim dhe t'i largojmë dy punëtorë nga puna.

Të nderuar deputetë,

Shqetësimi i këtij sektori, i këtij biznesi të vogël është komplet me vend. Kostoja e madhe e arkave fiskale e ka shqetësuar deri sot çdo sektor. Tani arkat fiskale elektronike janë tepër të shtrenjta, edhe kjo krejt për shkakun se Qeveria e ka monopolizuar tregun, duke licencuar vetëm dy kompani në Kosovë, të cilat mund ta furnizojnë sektorin e biznesit me arka fiskale.

Një arkë e tillë fiskale, e cila kërkohet nga Administrata Tatimore e Kosovës, e cila te ne kushton 4 210 euro, në vendet e rajonit kushton 1 300 euro. Meqenëse koston e fiskalizimit në shumë vende të rajonit e ka bartur komplet shteti dhe Qeveria, kjo nuk ka ndodhur në Kosovë, e ajo çfarë këta po kërkojnë është që të liberalizohet tregu i furnizimit me arka fiskale, ose Qeveria thjesht t'i japë, t'i specifikojë veçoritë e arkave fiskale dhe të hapet një tender ndërkombëtar, ku këto biznese mund t'i blejnë këto aparate me çmime më të ulëta.

Ne i shohim deklaratimet e Qeverisë që kinse po mundohet që ta ndihmojë sektorin e biznesit. Ne e kemi një ligj shumë kontravers...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdojmë! Fjalën e ka deputeti Florin Krasniqi.

FLORIN KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Çështjen të cilën do ta ngre këtu sot, nuk dua në asnjë mënyrë ta tërheq vëmendjen e opinionit dhe tuajin prej problemeve shumë të mëdha ekonomike dhe politike, nëpër të cilat po kalon Kosova.

Fjala është për UDB-ashët, e assesi nuk dua ta përdorë fjalën ish-UDB-ashët, se në opinionin po flitet për ish-UDB-ashët. Unë besoj që njeriu që ka punuar për UDB-në një herë, deri në vdekje do të punojë për të.

Fjala është për këta njerëz që në opinionin publik dhe jopublik dalin me deklaratat se këta i dinë njerëzit në këtë Kuvend, në Qeveri dhe në institucionet tjera të Kosovës që punojnë për UDB-në.

A e dini çka është kjo, deputetë të Kuvendit të Kosovës? Dhe këta fshihen mbrapa Kodit Etik. Kodi Etik thonë nuk na lejon ne të tregojmë kush janë këta njerëz. Është sikur t'u them ju unë e di ku është një bombë nukleare në Prishtinë, po Kodi Etik nuk më lejon të kallëzoj, se po të kallëzoj unë e thyej atë. Po t'i përdorte instrumentet, janë ato metoda që

këta njerëz i kanë përdorur kundër mijëra të rinjve e të reja të Kosovës e dhjetëra deputetë të këtij Kuvendi, po t'i përdornim ne të njëjtat instrumente, këta për një minutë do ta thyenin Kodin Etik.

Andaj, e ftoj Prokurorinë e Kosovës, menjëherë e urgjentisht, t'i marrë këta njerëz në pyetje dhe këta njerëz të tregojnë kush janë njerëzit në radhët tona që punojnë për shërbimet e huaja informative, e sidomos ato armike.

Andaj, e ftoj Prokurorinë menjëherë dhe urgjentisht të merret me këta njerëz. Këta njerëz prapë po e bëjnë të tyren që e kanë bërë me dekada, po krijojnë konfuzion në radhët tona. Ne mund të mos pajtohemi politikisht, e të argumentojmë gjithë ditën, por mendoj se kombëtarisht pajtohemi. Andaj, e ftoj Prokurorinë të merret me këta njerëz. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsjednice!

Razlog mog današnjeg javljanja je nezadovoljstvog građana iz dva opština, pojedinih delova dve opštine, opštine Lipljane i opštine Gračanica, radom KEDS-a u zadnje vreme. Jer znamo da privatizacijom tog preduzeća, da su nam obećali nove investicije od 200 miliona u narednih 15. godina, koje treba da ulože.

Moram da kažem da u ovom periodu to se ne održava na građane i na potrošače koji KEDS-u isključivo plaćaju redovnu struju. Ja sam u više navrata od 2011. godine ovde postavljao poslanička pitanja upravo iz razloga i na račun rada, tada KEK-a, sada KEDS-a, zato što svoje obaveze ne ispunjava, i mislim da je u opštini u Gračanici u ovom trenutku ljudi su ne nezadovoljno, nego preko nezadovoljni jer samim tim, ako nestane struja u 10 sata uveče, oni ostaju do 12 i do 14 sati dnevno bez električne energije.

Ja apelujem na rukovodstvo KEDS-a da ulaži više napa da počinje da troši tih 200 miliona koji je obećao da će uložiti u infrastrukturu, i da svoje potrošače zaštiti na najadekvatniji način. Hvala!

KRYETARI: E përfunduar pikën e parë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë:

2. Koha për pyetje parlamentare

Sot, ju deputetë e keni rastin vetëm një ministri t'i parashtroni pyetje, pasi është i pranishëm dhe po fillojmë me pyetjet që i janë drejtuar ministrit të Shëndetësisë, zotit Ferid Agani.

Deputetja Kimete Bytyçi, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, mund ta lexosh pyetjen.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër,

Gjatë vizitës që i është bërë Spitalit Rajonal të Pejës, përkatësisht Repartit Gjinekologjik, është konstatuar mungesa e disa aparateve shumë të rëndësishme për punën e këtij reparti. Në këtë repart të kësaj qendre ka mungesë të inkubatorëve në të cilët vendosen foshnjat e porsalindura, vendosja e të cilave është e domosdoshme për mbijetesën e tyre.

Pyes ministrin se cila është arsyeja e mungesës së këtyre aparateve shumë të rëndësishme dhe kur do të eliminohet ky fenomen mjaft shqetësues për këtë qendër rajonale. Pra, është fjala për Pejën.

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti ministër,

E nderuara deputete,

Pajisja me aparaturën e domosdoshme medicinale e institucioneve shëndetësore paraqet një preokupim dhe brengë të vazhdueshme.

Dihet që shëndetësia bashkëkohore kërkon investime të mëdha. E di mirë edhe situatën me mundësitë financiare të shtetit tonë sa i përket kësaj fushe, mirëpo megjithatë kujdesi për foshnjat e porsalindura gjithmonë ka qenë prioritet i veçantë i Ministrisë së Shëndetësisë dhe sa i përket pyetjes suaj konkrete po e lexoj informatën që e kam marrë nga drejtori i Spitalit të Përgjithshëm në Pejë, i cili reflekton për gjendjen në Repartin e Neonatologjisë, jo të Gjinekologjisë, por që është i bashkëngjitur, Repartin e Neonatologjisë. Pra, në këtë repart janë gjithsej pesë inkubatorë, prej tyre dy janë transportues në gjendje funksionale dhe tre janë në gjendje funksionale, si donacion për tretman brenda repartit.

Janë edhe pajisjet e tjera të nevojshme përkitazi me ofrimin e këtyre shërbimeve, si infra tavolina, cipapa, pompat infuzive, shiring pompa, foto llamba, monitori, aspiratori mekanik, ultrazëri dhe të tjera, mos të ju lodh me detaje teknike tash. Përpos inkubatorit të specifikuar si donacion, aparatura tjetër ka qenë investim i Ministrisë së Shëndetësisë.

Do të thotë ka pasur nevojë dhe ka nevojë ende për përmirësimin e këtyre kapaciteteve. Me këto pajisje ofrohen shërbimet në masën e nevojshme dhe sipas konstatimit të drejtorit të Spitalit, ato i përgjigjen nevojave momentale të Spitalit të Pejës, por Spitali i Pejës e ka buxhetin për investime kapitale të dedikuara dhe është në përgjegjësinë e tij që të përcaktojë prioritetet e tyre dhe në këtë aspekt ata janë të lirë dhe nuk kanë kurrfarë ndikimi politik.

Në anën tjetër, ne si ministri qëndrojmë gjithmonë në dispozicion për kërkesa të tilla prioritare. Një kërkesë e tillë nga Spitali i Pejës për një financim plotësues emergjent nuk ka ardhur deri më sot, që do të thotë se udhëheqja e këtij spitali vlerëson se për momentin janë duke ofruar një nivel të shërbimeve i cili është i kënaqshëm dhe për nevojat dhe mundësitë e spitalit të Pejës, për momentin.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë?

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Zoti ministër,

Ne e kemi bërë këtë vizitë vitin e kaluar. Sipas informatave që kam tani, prapë ka mungesë e kjo nuk është çështje e muajve, por është çështje e viteve që mungon kjo aparaturë. Ju thoni që ka pasur, tre janë funksionale, mirëpo tre janë aty, por sa janë funksionale? Ne kur kemi qenë atëherë edhe tash që i kam informacionet, vetëm dy janë funksionale, jo tre.

Dhe, ju i përmendët të gjitha ato, por dua ta di Ministria e Shëndetësisë, kur do t'i sjellë këto aparatura tjera, që e cekët edhe më herët. Dhe a keni ndonjë plan konkret në këtë aspekt.

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI FERID AGANI: Zonja deputete,

Po flasim për informatën e datës 12 shkurt nga drejtori i Spitalit të Përgjithshëm Pejë. Në spital janë funksionalë pesë aparate, pesë inkubatorë. Do të thotë, nuk duhet dyshuar në këtë informatë, vjen nga personi më përgjegjës i spitalit.

Ndërsa, sa i përket furnizimit me pajisje të tjera dhe aparaturën tjetër, unë thashë edhe njëherë se çdo spital i përgjithshëm e ka buxhetin për investime kapitale dhe nuk ka nevojë të presë nga Ministria e Shëndetësisë që të blejnë inkubatorë që nuk janë pajisje të shtrenjta.

Dhe, përfundimisht do ta kemi situatën e zgjidhur pas hyrjes në fuqi të Ligjit të sigurimeve shëndetësore dhe fillimit të funksionimit të fondit të sigurimeve shëndetësore, me të cilin do të sigurohen 85 milionë euro plotësuese për sistemin shëndetësor dhe me këtë, përfundimisht do ta zgjidhim edhe problemin e pajisjes të institucioneve shëndetësore me aparaturën e nevojshme.

KRYETARI: Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Agani.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Banorëve të fshatrave shqiptare në Leposaviq, siç raportojnë disa media, prej shumë muajsh nuk po u ofrohet kurrfarë shërbimi shëndetësor. Banorët e fshatrave: Bistricë, Cerajë dhe Koshutovë, jo vetëm që po ndjehen të izoluar për shkaqe sigurie, por po rrezikohen edhe nga izolimi mjekësor.

Ministria e Shëndetësisë duket se nuk po merret me ta, nuk po merret me këtë problem dhe nuk po u ofron përkujdesje mjekësore.

Pyetja ime për ministrin është: Pse po ndodh kjo, a keni kërkuar ju mbështetje nga forcat e policisë për të shkuar atje dhe nëse po, si ju kanë përgjigjur kërkesës së mjekëve?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

E nderuara zonja deputete,

Përfundimisht nuk është e vërtetë se nuk ofrohet kurrfarë shërbimi në këto njësi. Nga informatat që i kemi nga Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë, kemi informatë se në këto fshatra ofrohen shërbime shëndetësore në ambulancën e Mjekësisë Familjare në fshatin Bistricë.

Ka vështirësi në qarkullimin e mjekut nga Mitrovica, i cili shkon njëherë në javë në këtë ambulancë dhe ofron shërbime atje. Ka pasur vështirësi në qarkullim, mirëpo në vazhdimësi Spitali i Mitrovicës ka qenë në dispozicion dhe ka ofruar shërbime për banorët e këtyre fshatrave.

Natyrisht se ka hapësirë për përmirësimin e komunikimit ndërmjet qeverisë lokale dhe qendrore. Ne e kemi situatën aktuale e cila premtan që pas konstituimit të Drejtorisë Komunale të Shëndetësisë në Komunën e Leposaviqit, që të krijohet një mundësi e vendosjes së komunikimit drejtpërdrejt me autoritetet që e respektojnë shtetin e Kosovës dhe me të cilët do të vendosim një marrëdhënie të bashkëpunimit dhe obligimit të respektimit të dispozitave ligjore në fuqi.

Në këtë drejtim veç janë ndërmarrë hapat e parë dhe kemi komunikuar edhe me përgjegjësen kryesore, zyrtaren kryesore administrative në komunën e Mitrovicës, zonjën Hoxhiq, në mënyrë që të vendosim edhe komunikimin e drejtpërdrejtë me këto autoritete. Përndryshe, ofrimi i shërbimeve shëndetësore për popullatën e fshatrave të komunës së Leposaviqit: Bistricë, Cerajë dhe Koshutovë, po ju informoj me të dhënat nga zëvendës drejtori i qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare, pra ofrohet në ambulancën e Mjekësisë Familjare në Bistricë, nga qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë dhe atë nëpërmjet shërbimeve shëndetësore nga mjeku familjar, një herë në javë, transporti i mjekut ofrohet me automjete të Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare, por disa herë për shkaqe të sigurisë, është dashur të shkohet edhe me rrugë alternative, rrugë malore, në të kaluarën po them, që ka qenë mjaftë e papërshtatshme.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare i ka siguruar barërat dhe materialin shpenzues nga lista esenciale. Në listën e pagave të punëtorëve shëndetësorë, që ofrojnë shërbime në këto fshatra janë tre punëtorë shëndetësorë.

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

ALMA LAMA: Po, faleminderit zoti kryetar!

Nga përgjigja e zotit ministër shoh që është shumë kontradiktor në atë që thotë. Një herë thotë që i ofrojmë shërbimin një herë në dy javë, pastaj po kanë probleme.

Unë për vete jam e prirë t'ju besoj medieve që kanë raportuar duke intervistuar vetë banorët. Dhe, vetë banorët thonë që nuk u ofrohet dhe justifikimi i mjekëve është për shkaqe sigurie, të cilin mund ta kuptojmë që është për shkaqe sigurie. Dhe, prandaj,

pyetja ime ishte: A keni bashkëpunuar me forcat e policisë, në mënyrë që këtyre banorëve t'u ofrohet shërbimi?

Një herë në javë, besoj e dini si ministër i Shëndetësisë, që është krejtësisht e pamjaftueshme. Të gjithë banorët duhet të kenë qasje të përditshme në shërbimet shëndetësore, sepse sëmundjet nuk pyesin kur dikush sëmuret. Bëhet fjalë edhe për fëmijë të vegjël.

Dhe, pyetja tjetër, kjo Marrëveshja në Bruksel e Qeverisë, ku bëni pjesë edhe ju, nuk ua paska mundësuar bashkëpunimin në komunë atje?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Fillimisht, e nderuara zonja deputete, nuk ka kurrfarë kundërthënie në atë që e thashë. Unë thashë se shërbimet janë të strukturuar, ofrohen si shërbime të infermierisë çdo ditë në atë ambulancë të Mjekësisë Familjare dhe një herë në javë nga mjeku.

Në shumë fshatra në Republikën e Kosovës, ofrohen në të njëjtën mënyrë. Do të ishte ideale, sikur ne të mundnim në çdo fshat të kemi mjekun dhe të kemi ambulancën e Mjekësisë Familjare të pajisur me mjekë, por nuk është e mundur. Një, për shkak të resurseve profesionale, në anën tjetër për shkaqe financiare.

Prandaj, e kemi situatën e ngjashme edhe në shumë fshatra tjera. Vështirësitë i përmenda, ka pasur vështirësi në qarkullimin e mjekut, në realizimin e vizitave dhe Qendra kryesore e Mjekësisë Familjare në Mitrovicë i ka ndërmarrë të gjitha masat që ka pasur në dispozicion, me siguri edhe lajmërimin e organeve të sigurimit për t'i ofruar këto shërbime, por kur thashë se shumë herë mjeku ka shkuar edhe me rrugë alternative, kjo flet për përkushtimin e punëtorëve shëndetësorë që të jenë afër qytetarëve.

Dhe, nuk mund të thuhet se nuk ka shërbime shëndetësore në qoftë se atje e kemi ekipin e infermierëve, i cili është në atë ambulancë të Mjekësisë Familjare, por vështirësi në ofrimin e shërbimeve ka pasur.

Dhe, tash po dalim në pyetjen e dytë, Marrëveshja e Brukselit ka hapur rrugë për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit kemi pasur zgjedhjet e lira në komunën e Leposaviqit. Si rezultat i kësaj marrëveshjeje do të kemi konstituimin e drejtorisë, qeverisjes lokale dhe Drejtorisë komunale të shëndetësisë dhe në këtë mënyrë do të vendosim raportin zyrtar me autoritetet shëndetësore, që e pranojnë shtetin e Kosovës dhe jam i bindur që në këtë dialog dhe këtë komunikim do të përmirësojmë dukshëm edhe shërbimet shëndetësore për të cilat po flasim.

KRYETARI: Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputete, e ke fjalën.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Kërkoj falje, zoti ministër, se sot po më duket paskeni pyetje vetëm ju, por, megjithatë unë e kam bërë edhe në seancën e kaluar, por s'kam qenë e pranishme. Pyetja ka të bëjë me Ligjin e duhanit, pra sa zbatohet Ligji i duhanit, sa ka inspektorë, a ka inspektorë të mjaftueshëm për të dhënë gjoba për moszbatimin e këtij ligji të duhanit?

Dhe po ashtu, dua ta di se ky ligj, përveç Prishtinës, sa gjoba ka marrë edhe në qytetet tjera dhe sa po zbatohet edhe në qytetet tjera?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: E nderuara, zonja deputete,

Të nderuar deputetë,

Ligji për kontrollin e duhanit, siç e dini, ka qenë njëra prej ndërmarrjeve më të mëdha në lëmin e shëndetit publik, në kohën e fundit dhe me kënaqësi mund të them se ka arritur që në masë të madhe të ndryshojë mentalitetin dhe kulturën qytetarëve, banorëve të vendit duke kontribuar drejtpërdrejt në ruajtjen e shëndetit publik.

Natyrisht, përpos kësaj disipline të veçantë qytetare, të treguar në gjithë vendin, institucionet e shtetit i kanë ndërmarrë edhe masat e duhura për zbatimin dhe për kontrollin e zbatimit të tij. Unë e kryesoj Këshillin Ndërministror në bazë të ligjit, pra Këshillin Ndërministror të themeluar nga Qeveria e Kosovës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe jemi shumë aktivë në këtë proces me mbledhje të rregullta dhe me raportime të rregullta të inspektorateve përgjegjëse.

Një vlerë e veçantë e këtij ligji dhe e zbatimit të tij që është me rëndësi, ka qenë bashkëpunimi i shkëlqyeshëm me shoqërinë civile dhe bashkëpunimi i tillë është kah rezulton edhe me një vazhdimësi të monitorimit të zbatimit të ligjit jo vetëm nga organet e inspektorateve, por edhe nga vetë qytetarët dhe shoqëria civile, që po i jep një cilësi të re këtij procesi.

Konkretisht, si përgjigje në pyetjen e juaj, monitorimin e zbatimit të Ligjit për kontrollin e duhanit e bëjnë 52 inspektorë sanitarë, 12 inspektorë shëndetësorë dhe e bëjnë të gjithë inspektorët e arsimit, të punës dhe të transportit. Pra, ka kapacitete të mjaftueshme për monitorimin e zbatimit të këtij ligji, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se në kohën e fundit, pas vizitave të mija dhe kontakteve e takimeve të drejtpërdrejta me kryetarë të komunave, disa komunave ku është vërejtur se ligji po zbatohet më pak, kemi edhe angazhimin e inspektorateve të komunave në këtë drejtim.

Janë ndërmarrë gjithsej 1 700 inspektime, janë iniciuar 60 lëndë gjyqësore, janë shqiptuar 8 gjoba mandatore dhe janë zbatuar 17 aksione të përbashkëta me Policinë e Kosovës, e cila ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të këtij ligji.

Natyrisht se ka hapësirë për përmirësim. Në komunat tjera, siç thatë, përveç kryeqytetit, ka veprime të njëjta. Në qendrat e mëdha rajonale janë formuar këto këshillat për monitorimin e zbatimit të ligjit nga shoqëria civile dhe drejtoritë komunale të shëndetësisë.

Prandaj, mendoj se është kah bëhet një punë e organizuar, sistematike dhe jemi duke identifikuar ato qendra dhe ato lokalitete brenda qendrave rajonale ku ligji nuk po zbatohet e ka edhe aso rastesh, veçanërisht në periferi dhe veçanërisht në orët e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shtesë?

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, ministër!

Sa i përket gjobave, 8 gjoba ishin gjithsej dhe konsideroj që nuk janë të mjaftueshme për zbatimin e këtij ligji. Po ashtu konsideroj që ligji nuk zbatohet sikurse në Prishtinë, sidomos në qytezat të cilat janë më të vogla, nuk zbatohet fare e sidomos në periudhën e dimrit.

Ju keni mbajtur më herët dhe keni formuar një trup multisektorial në Ferizaj dhe dua ta di se kur do ta formoni një trup të njëjtë në vendet tjera apo qytetet tjera të Kosovës, që ky ligj të gjejë zbatim sikurse në Prishtinë?

Po ashtu dua ta bëj një koment i cili ka të bëjë me të ardhurat apo gjobat të cilat vijnë nga Ligji kundër duhanit, të cilat konsideroj dhe vlerësoj që ta keni parasysh edhe protestën e fundit të infermierëve në QKUK që t'u paguhen kujdestaritë të cilat u mohohen që sa muaj.

KRYETARI: Vazhdo, ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Kjo pjesa e fundit ishte pyetje e veçantë, mund edhe në atë ta adresoj, vetëm t'ju them se kur janë në pyetje gjobat, të kemi parasysh se është një praktikë e re, një përvojë e re edhe për inspektorët në zbatimin e këtij ligji dhe natyrisht në proces të zbatimit të ligjit janë vërejtur edhe mangësi. Shumë parashpresa që janë bërë nga inspektorët nuk kanë qenë të plotësuara në mënyrë adekuate, ka pasur mungesa dhe nuk kanë qenë të mjaftueshme për iniciimin e procedurave gjyqësore.

Këto mangësi janë identifikuar, janë tejkaluar, janë duke u tejkaluar me trajnime të veçanta që po bëhen me inspektorë dhe, unë mendoj se në periudhën e ardhshme do të kemi shumë më tepër edhe lëndë gjyqësore edhe gjoba të shqiptuara, në këtë drejtim.

Sa u përket këtyre këshillave ndërsektoriale që i përmendët, këto këshilla janë formuar në të gjitha qendrat e tjera rajonale, jo vetëm në Ferizaj, dhe jemi duke i formuar në vazhdim e sipër jo vetëm në këto kryesoret, por edhe në komunat më të vogla. Do të thotë është duke u punuar në atë drejtim në mënyrë maksimale, ndërsa kur janë në pyetje tash mjetet financiare që grumbullohen nga gjobat, natyrisht, ato shkojnë në buxhetin e Kosovës dhe

ato janë subjekt i ndarjeve brenda Qeverisë së Kosovës, nuk mund të shkojnë të dedikuara për një qëllim, ndërsa kur janë në pyetje infermierët dhe që e përmendët edhe çështjen e kujdestarive, besoj se edhe ju e dini, edhe infermierët e dinë se në qoftë se dikush ka bërë për infermierinë dhe për pagesën e punës së tyre është kjo Ministri dhe atë nga ditët e para të këtij mandati, sepse është bërë dyfishimi dhe trefishimi i kompensimeve të punës së tyre nëpërmjet kontratës kolektive që është nënshkruar.

Ka pasur tejkalime dhe keqpërdorime të pagesës së kujdestarive gjatë verës së vitit të kaluar, janë konstatuar këto dhe ka pasur rregullime të këtyre tejkalimeve. Në qoftë se ka pasur mungesa unë do t'i analizoj ato, unë me kujdes e kam marrë parasysh parashtresën e tyre dhe ne do ta adresojmë këtë brenda një kohe shumë të shkurtër dhe kam thënë, deri në fund të javës së ardhshme do të ketë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj, pyetje për ministrin Nenad Rashiq.

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Zoti ministër,

Dua të di se sa po zbatohet Ligji për të verbrit sipas jush dhe kur do t'u jepet retroaktivisht kompensimi për vitin 2013 duke e ditur se ky ligj ka hyrë në fuqi që nga janari i vitit 2013?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Poštovani kolege ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

I prošle nedelje sam odgovorio na ovo pitanje, tako da ću pokušati što kraće i što preciznije da kažem još jednom.

Zakon jeste bio usvojen da na snazi bude od 1 januara 2013.godine i onaj nedostatak, koji se desio tu u tehničkom smislu je bio da je zakon bio usvojen a pre toga nije bio određen utrošak, odnosno koliko će taj zakon koštati.

Mi smo bili obavezni pre svega da napravimo dopunsku komisiju, koja je sve aplikante bila dužna da proveriti i da one koji ispunjavaju uslove, naravno, pored toga promeni sa liste privremenih penzija, koji oni sada trenutno jesu, da stavi u ovu posebnu kategoriju slepih, koja bi dobila benificije, koje su malo veće od benificija koje trenutno dibijaju kao korisnici privremenih penzija.

U svakom slučaju, što se tiče aplikanata u 2013.godini u toku ove godine, odnosno budžet kada bude počeo da funkcionise u punoj meri, mi ćemo sve one koji su potvrđeni kao korisnici od 2013. godinu isplatiti retroaktivno za 2013. godinu, a svi aplikanti i svi oni koji ispunjavaju uslove, koji budu aplicirali u ovoj godini imaju pravo da dobiju svoje benificije od momenta aplikacije u toku 2014. godine.

Tako da ćemo taj zakon sprovesti tačno u tehničkom delu, koji se tiče i takođe kao što rekoh, vrlo je bitno da ljudi koji apliciraju, ispunjavaju uslove odnosno da njihovo pravo bude zagarantovano. Hvala!

KRYETARI: Deputete, ke pyetje shitesë?

RITA HAJZERAJ-BEQAJ: Faleminderit ministër, në përgjigje, por zbatimi i ligjit, me qenë se është dashur që të zbatohet që nga janari i vitit 2013, është obligim kushtetues i cili zbatohet që nga nënshkrimi i presidentes kështu që çdo ministri e ka obligim që këto ligje t'i zbatojë.

Pastaj, ju thatë që do t'i japim ato para në mënyrë retroaktive për të gjithë personat e verbër. Unë e di që në rishikimin e buxhetit të vitit të kaluar i kemi pasur 1 590 000 euro që janë dedikuar, pikërisht për këta persona që retroaktivisht t'ju japim paratë, mirëpo nuk janë marrë, janë ndarë për një kategori krejt tjetër, që nuk jemi kundër, por pse nuk janë përfshirë këta persona, personat e verbër në ato para që janë ndarë enkas për mënyrën retroaktive të shpërndarjes së parave ndaj këtyre?

Dhe dua ta di afatin kohor përafërsisht se kur do t'i ndani retroaktivisht këto para? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, vazhdoje!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsedniče!

Rekao sam malo pre da nije bio utvrđen utrošak zakona, kao prvo, komisija je tek radila svoj posao i nismo mogli tek tako paušalno ni da odredimo koliko će biti sam taj kosto, koliko će biti utrošak tog zakona. Treba da znate da svi mi u institucijama smo dužni da se pridržavamo tog pravila fiskalnog menadžmenta, odnosno pravila očuvanja fiskalnog zakona, gde jednostavno ne možete neki zakon da implementirate, ukoliko ne znate koliko će on koštati.

I za sve ovo sem tim disiplinama koje sam pomenuo, mi jednostavno nismo tehnički mogli da stignemo da zakon bude implementiran, a nismo mogli delimično da ga sprovedemo. Znači, pošto zakon nije mogao u celini da bude sproveden, nismo mogli delimično da sprovedemo, tako da je ovaj sad izazov da u toku ove godine isplatimo sve, ponavljam još jednom, koji su aplicirali u 2013.-toj za retroaktivnu a ove u 2014.-toj će njihova prava početi u ovoj godini.

Što se tiče vremenskog perioda, ja znam da ćemo sigurno u martu, sigurno u martu, sigurno znati u kom momentu ćemo moći da isplatimo sve te ljude, koji imaju pravo zakonom da dobiju ovu privilegiju. Hvala puno!

KRYETARI: Deputeti Xhafer Tahiri, pyetje për ministrin Nenad Rashiq. Deputet, e ke fjalën.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar ministër,

Unë e kam pothuajse të njëjtën pyetje edhe për kryeministrin, por meqenëse kryeministri nuk është këtu, sepse si duket për të më e rëndësishme është fotografia me Daçiqin, sot në Bruksel, sesa çështja e varfërisë në Kosovë.

Pyetja ime për ministrin është kështu:

Varfëria është një nga çështjet sociale më akute sot në Republikën e Kosovës. Në këto katër vjet varfëria në Kosovë ka ardhur gjithnjë duke u rritur, sidomos varfëria e skajshme. Familje të tëra në Kosovës sot jetojnë në varfëri e shumë prej tyre jetojnë në varfëri të skajshme.

Shumë familje në fakt do të binin në këtë kategori sikur të mos ishte solidariteti i diasporës sonë, të cilët vazhdojnë t'i mbështesin familjet e tyre në Kosovë. Nga varfëria, më të goditurat janë sidomos dy kategori në Kosovë, të rinjtë dhe gratë. Pyetja ime konkrete për ministrin është:

Sa është shkalla e varfërisë në mesin e të rinjve dhe grave? Po ashtu, cilat masa po i ndërmerr Ministria juaj për t'i ndihmuar të dalin nga varfëria këto dy kategori, shumë të rëndësishme të shoqërisë sonë?

Ju lutem na njoftoni me shifra konkrete! Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

Dame i gospodo narodni poslanici,

Poštovani poslaniče,

Pokušaću da budem što precizniji. Prema najnovijim izvštaju siromaštva u konsumu Agencije za... Kosova i Svetske Banke u 2011.godini, siromaštvo na Kosovu nastavlja da bude visok procenat.

29%, odnosno 29,3% stanovništvo živi ispod linije siromaštva od 1,71 evra, ekvivalentno po odrasloj osobi dnevno, dok 10,7% i dalje živi u ekstremnom siromaštvu sa manje od 1,2 evra po odrasloj osobi.

Na osnovu zakona i propisa koji regulišu šemu penzione pomoći, Ministarstvo za rad preko mreže centara za socijalni rad u svojoj šemi, to je informacija od decembra u 2013.-toj godini, ima 29 688 porodica u kategoriji I, u prvoj kategoriji je 17 543 domaćinstava, u kategoriji II je 12 145 000 domaćinstava.

Članovi porodice: 66 382 su žene i 61 000 su muškarci. Od ukupnog 29 688 nosioca socijalne pomoći 30,4% su žene, 69% muškarci. Od ukupno 123 000 članova porodice, koliko su u socijalnoj šemi, 64 800 ili 52,45% su deca uzrasta od 0-18 godina.

Pored toga porodični smeštaj za decu bez roditeljskog starenja, koji mi takođe omogućavamo, daje beneficiju za porodični smeštaj za decu a koja se smeste kod bliskih srodnika i splaćuje se oko 600 dece mesečno, koji imaju 75 evra benefita.

Po takođe porodični smeštaj za nezbrinutu decu bez roditelja, koji su smešteni u alternativnim porodicama, koje nemaju nikakve rodbinske veze sa decom, je smešteno 80 dece i hranitelje porodica koji imaju 150 evra mesečno.

Šema za decu porodica koji imaju decu sa trajnim ograničenim sposobnostima imamo oko 3 000 dece, odnosno tačno 3 019-toro dece, koje na mesečnom nivou financiramo sa po 100 evra.

Socijalne zaštite, programi koriste na Kosovu prema procenama pokrivaju više od 300 000 osoba, što podrazumeva da oko 15% stanovništva ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ke pyetje shitesë, deputet?

XHAFER TAHIRI: Faleminderit për përgjigjen, zoti ministër!

Në fakt, këto shifra që ju sapo na i dhatë këtu janë alarmante, por më alarmante është fakti, sepse ju nuk ishit në gjendje të na njoftoni me të paktën një politikë konkrete, me të cilën mbështetni në mënyrë konkrete të rinjtë dhe gratë për të dalë nga varfëria.

Sipas një analize të buxhetit të ndarë, faktikisht për vitin 2014, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës, për të rinjtë, praktikisht në Kosovë dëshmohet se kjo qeveri ndan vetëm 1 euro e 20 centë në vit për mbështetje të një të riu. Në fakt, një analizë e tillë nuk është bërë dhe nuk bëhet për gratë.

Me këtë mbështetje, është e pamundur që një i ri apo një grua të arrijë të mbijetojë një ditë të vetme e lëre më një vit, por është e pamundur lëre më që këto dy kategori të dalin nga varfëria. Pyetja ime është:

Në informatat tuaja, si mund të jetojë një i ri me 1,20 euro në vit dhe si mund të jetojë një grua, ju lutem na njoftoni për këtë shpikje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ministër, shkurt!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala još jednom, predsedniče!

Ono što treba da znate je vrlo konkretno.

Ministarstvo za rad po socijalnim šemama godišnje plaća oko 200 miliona za sve te korisnike. Ja sam rekao i naveo sam vam 300 000 ljudi direktno ima benefita od Ministarstva za rad. Dali treba više? Verovano, treba znatno više. I koliko god da je, uvek treba više, ja razumem to. Ali, dali imamo politike? Ja sam baš hteo o ovom dokumentu,

pošto ste vi pitali, šta konkretno kažete šifre, kažete brojke, ja sam konkretne brojke i dao.

Ako hoćete bolju neku informaciju, stvarno dobrodošli ste kod nas u ministarstvo i sve što vas bude interesovalo oko politika, to ćemo vam predstaviti transparentno, kao što smo radili i do sada. Shvatamo svi da je srž problema socijalnih nezaposlenost.

Ali i pored toga isti izveštaj koji ja čitam danas bio je 2008.godine od Svetske banke. Tad smo imali ekstremno siromaštvo 14-15%, danas je 10,2%. Ne kažem da je to veliki rezultat ministarstva, treba biti još manji, ali ako smo se pomakli sa tog nivoa, ako smo malo spustili, ja mislim da te socijalne politike funkcionišu. A uvek, sigurno treba više da stignemo da zaposlenost bude veća, odnosno da nezaposlenost bude manja mi ćemo sigurno imati jedan procenat, jedan broj porodica koje će živeti u ekstremnom siromaštvu. Hvala!

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje pyetje për minsitrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Pyetja e parë ka të bëjë rreth çështjes, punëtorët shëndetësorë disa herë kanë pasur ankesa për jo barazinë në gradim dhe sistem të pagave, punëtorët shëndetësorë me kualifikim të njëjtë, me detyra të njëjta të punës nuk paguhen njësoj nga Ministria e Shëndetësisë. Andaj Ministria e Shëndetësisë, më 19.6.2012 ka themeluar ekipin e punës për draftimin e draft-udhëzimit administrativ për përcaktimin e kompetencave profesionale, përshkrimin e detyrave të punës dhe gradimin në sistemin e pagave për infermierë, mami dhe fizioterapeutë. Ky ekip i punës udhëhoqej nga profesoresha e nderuar, Natyra Karahoda edhe e kreu punën rreth këtij udhëzimi administrativ, në vitin 2013, domethënë para gjashtë muajsh, por për fat të keq ky udhëzim administrativ ka mbetur në sirtarët e Ministrisë i pa nënshkruar dhe i pazbatuar edhe pse vazhdon ende pabarazia në gradimin e sistemit të pagave në këta sektorë.

Pyetja është, cila është arsyeja e mosnënshkrimit dhe zbatimit të udhëzimit administrativ për përcaktimin e kompetencave profesionale, detyrave dhe gradimin në sistemin e pagave për infermierë, mami dhe fizioterapeutë? Faleminderit!

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I nderuar zoti deputet,

Asnjë udhëzim administrativ të jeni të bindur nuk qëndron në sirtar pa një arsye dhe ai nuk qëndron në sirtar, por është në proces të punës ndaj elaborimit të vazhdueshëm. Vetë

fakti se kemi themeluar grup të punës, që mendoj se edhe ju keni qenë njëri prej anëtarëve të atij grupi të punës, ka qenë reflektimi i seriozitetit të çështjes.

Pasi që është punuar drafti ai është dorëzuar në Ministri dhe ne e kemi proceduar në procedurën normale ligjore të konsultimeve me ministrinë e linjës dhe gjatë atij procesi kemi pasur ankesa dhe vërejtje të shumta, komente dhe sugjerime për plotësimin e këtij udhëzimi.

Në ndërkohë krahas këtij procesi në Ministrinë e Administratës Publike, nga Ministria e Administratës Publike është bërë parashpresa se ata janë duke hartuar projektligjin që rregullon çështjen e gradimit, përkatësisht të koeficienteve në gjithë sektorin publik në vend. Dhe, nevoja për harmonizimin e udhëzimit tonë me këtë projektligj dhe punën që bëhet rreth këtij projektligji ka bërë kryesisht, kjo ka qenë arsyeja kryesore, ka bërë që ky udhëzim administrativ për momentin është duke pritur harmonizimin me grupin e punës që është kah punon në Ministrinë e Administratës Publike.

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër për sqarimin. Kjo situatë dhe kjo gjendje e kësaj pabarazie në koeficientin e pagave vazhdon prej vitit 2004 – 2005. Unë besoj që edhe Ministria e Administratës Publike po edhe Ministria e Shëndetësisë është dashur ta ketë parasysh që nuk është profesionale as etike që me të njëjtin profesion, me të njëjtat përshkrim të detyrave të punës, punëtorët shëndetësorë paguhen ndryshe në Gjakovë dhe ndryshe në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Bile, këta në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë kanë volume më të madh të punëve, ndërsa me koeficientin e pagesës edhe atje në sektorin terciar janë përshkruar më ulët dhe të paguar... prandaj nuk do të ishte mirë që kjo të ishte një shpjegim apo arsyetim.

Besoj që grupi punues punën e ka kryer në aspektin profesional duke i falënderuar ekipit të punës që ka qenë aty dhe po ma merr mendja që është dashur të fillojë zbatimin e tij. Nuk besoj e do të ishte e udhës që këta punëtorë shëndetësorë me anë të protestave t'i zgjedhin problemet e tyre.

KRYETARI: Ministër, urdhëro përgjigju në pyetje.

MINISTRI FERID AGANI: I nderuar zoti deputet!

Unë thashë edhe një herë se si reflektim ndaj asaj që po e përshkruani dhe Ministria e ka iniciuar atë procedurë dhe është përpiluar ai draft-udhëzim. Të them të drejtën ai draft-udhëzim ashtu si i tillë siç ka ardhur nga grupi i punës, në masë të madhe nuk i ka reflektuar ato probleme të cilat është dashur t'i kryejë si grup punues, ka pasur shumë mungesa, ka pasur ankesa të shumta dhe kur e kemi diskutuar atë draft edhe në institucionet shëndetësore, ka pasur shumë vërejtje që e ka imponuar nevojën që të punohet prapë.

Ne do ta shqyrtojmë këtë çështje bashkë me grupin punues dhe me siguri që në pajtim me grupin e Njesisë së Administratës Publike që është kah punon ligjin përkatës, do të

gjejmë zgjidhje që do t'i inkorporojmë në tekstin ligjor, sepse pa e rregulluar këtë çështje në rrafshin global është vështirë që të bëhen zgjidhje fragmentare.

KRYETARI: Deputeti Bekim Haxhiu, pyetje për ministrin Ferid Agani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Faleminderit ministër edhe për përgjigjen e fundit, është mirë kur punohet dhe ka hapësirë për të vlerësuar atë.

Pyetja e dytë ka të bëjë, gjatë vitit 2013 dhe në veçanti gjatë muajve të fundit ka pasur shumë zhvillime rreth AKPM-së apo Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale dhe të gjithë menduam se AKPM po i kthehet misionit të saj për garantim të cilësisë së produkteve medicinale dhe po fillon të bëhet efikas në zbatimin e ligjshmërisë. Inspektorati Farmaceutik i udhëhequr nga kryeinspektori Basri Rexha u vu në dispozicion të vendosjes së ligjshmërisë në këtë fushë. Derisa të gjithë shpresuam se po fillon vendosja e rregullit në sektorin farmaceutik dhe ruajtjen e shëndetit publik të qytetarëve, pasoi shkarkimi i serishëm i kryeinspektorit Basri Rexha, i cili është vënë në ballë të këtyre proceseve muajve të fundit për vendosjen e ligjshmërisë në sektorin farmaceutik dhe garantim të cilësisë së produkteve medicinale.

Pyetja konkrete ministër është: Cila është arsyeja e suspendimit nga detyra e kryeinspektorit të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale, Basri Rexha?

KRYETARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit!

Keni të drejtë plotësisht dhe është fakt se në 5 muajt e fundit, pas ndryshimeve të cilat janë bërë në kreun e Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale dhe marrjes së detyrës nga ushtruesi i detyrës, Arianit Jakupi, kemi pasur ndryshime shumë pozitive në punën e kësaj Agjencie, me rezultate shumë konkrete në të gjitha segmentet e punës së Agjencisë, si në laboratorin për kontrollin e cilësisë së barnave deri te Inspektorati Farmaceutik.

Është shumë e saktë se një kontribut të jashtëzakonshëm në procesin e ndryshimeve pozitive në këtë Agjenci e ka dhënë ushtruesi i detyrës së kryeinspektorit në atë kohë, zoti Basri Rexha dhe duhet të theksojmë se zoti Basri Rexha ka qenë emëruar si ushtrues i detyrës së kryeinspektorit në këtë agjenci nga ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të kësaj Agjencie, zoti Arianit Jakupi, pra si shprehje e besimit të plotë në kapacitetet profesionale dhe përkushtimin për të kontribuar në procese pozitive.

Pra, prej datës 13 nëntor 2013 zoti Rexha ka qenë ushtrues i detyrës të kryeinspektorit dhe ai ka punuar edhe sipas vlerësimit të zotit Jakupit, me intensitet të lartë për të kryer inspektimet e nevojshme të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës.

Për fat të keq, edhe pas ndërhyrjes edhe personale në tentim që të gjejmë zgjidhje për disa probleme në komunikimin zyrtar ndërmjet ushtruesit të detyrës së kryeinspektorit dhe të kryeshefit të Agjencisë, si dhe stafit të Agjencisë Kosovare për Produkte Medicinale, nuk kemi arritur që të gjejmë një zgjidhje adekuate.

Konkretisht po ju lexoj se kryeinspektori, ushtruesi i detyrës së kryeinspektorit, zoti Rexha, për shkak të shkeljeve të shumta të procedurave disiplinore, në kuadër të drejtave dhe përgjegjësi të veta, është shkarkuar nga detyra, me të vërtetë është pezulluar, më konkretisht, ai në pajtim me procedurat disiplinore në Shërbimin civil të përcaktuara në Rregulloren 042/2011, konkretisht është bërë pezullimi parandalues nga AKPM-ja në kohëzgjatje prej 3 muajve, në funksion të kryerjes së hetimeve të duhura.

Konkretisht bëhet fjalë për ngjarjen e datës 31 janar 2014, kur ushtruese e detyrës së kryeinspektores së Inspektoriatit Farmaceutik ka deklaruar se gjatë mbledhjes së mëngjesit me këtë datë, në rastin e ndarjes së detyrave të punës dhe kërkesës për dorëzimin e raportit të kërkuar nga Njësia për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit të Policisë së Kosovës lidhur me bastisjet e datës 6 nëntor 2013 për qarkulluesit me shumicë për produkte dhe pajisje medicinale...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Deputet, ke pyetje shtesë?

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, ministër!

Pyetja ishte në dy rreshta dhe shumë konkrete, cila është arsyeja e shkarkimit të Basri Rexhës. Faleminderit që po na i lexon udhëzimet administrative dhe raportet e mëngjesit të Agjencisë, por nuk po na interesojnë raportet e mëngjesit çka kanë folur ata në mëngjes, por na intereson arsyeja e saktë e shkarkimit të Basri Rexhës, kryeinspektorit farmaceutik, njeriut i cili filloi të vendosë rregull në këtë sektor. Dhe ju e dini shumë mirë, ministër që Basri Rexha edhe në vitin 2013 ishte suspenduar nga Ilir Dushi, atëherë drejtor i AKPM-së për arsye se kishte hetuar rastin e importit të insulinës dhe të albumineve pa licencë të blera nga Ministria e Shëndetësisë dhe pastaj pas shkarkimit dhe suspendimit të Ilir Dushit, Basri Rexha është kthyer në detyrë.

Basri Rexha vazhdoi të punojë dhe me rezultatet e punës së Basri Rexhës, i nderuar ministër, jeni mburr në Komisionin për Shëndetësi.

Tani pyetja konkrete është, cilin rast ishte duke e hetuar Basri Rexha që është shkarkuar sërish?

KRYETARI: Ministër, vazhdo!

MINISTRI FERID AGANI: Pra, konkretisht zoti deputet, që mos të mbes në mungesë kohe, shkarkimi ose pezullimi i tij parandalues për tre muaj, është bërë në bazë, e thashë edhe një herë, shkeljeve të shumta të procedurave disiplinore të cilat i ka pasur në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të veta.

Konkretisht, shkelje e detyrave të punës të dhëna nga kryeshefi ekzekutiv, një.

Dy, shkelje e Ligjit për shërbimin civil, neni 67, paragrafi 1.2, nën paragrafi 1.2.1, neni 69, 1.3 dhe paragrafi 2.

Shkelje e Kodit të Mirësjelljes dhe Rregullores për procedurat disiplinore 01/2006, neni 10 dhe neni 12.

Shkelje në përdorimin e veturës zyrtare të konstatuara më 19 nëntor 2013, 2 dhjetor 2013, 14 dhjetor 2013.

Ankesat nga zyrtarët e AKPM-së.

Nën 5, ankesa të shumta gojore, ankesa e datës 15 janar, vendimet e Bordit të ankesave lidhur me anulimin e vendimeve arbitrare të ushtruesi i detyrës së kryeinspektorit.

Vërejtja me shkrim e datës 16 nëntor nga kryeshefi ekzekutiv.

Peticionet për largimin e tij nga AKPM të vitit 2013 dhe 2014, të nënshkruara nga 30 zyrtarë të AKPM.

Gjithashtu edhe vërejtjet dhe pezullimi tremujor i vitit 2013.

Pra, mendoj se ka pasur fakte dhe argumente të shumta që ky vendim të merret nga ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të AKPM.

KRYETARI: I kemi përfunduar pyetjet.

(Ndërhyrje)

Pritni një herë ta kryej fjalën. Ju nuk e dini as çka dua të them. Thashë, pyetjet për ministrat që janë këtu kanë përfunduar. A doni t'i bëni pyetjet pa prezencën e ministrave që janë këtu? Mirë, deri ta harxhojmë kohën unë s'kam problem për këtë, po pritni pak, bëhuni më të durueshëm.

Vazhdojmë prej pyetjes së parë, sipas radhës.

Deputeti Xhafer Tahiri, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi.

XHAFER TAHIRI: Faleminderit, zoti kryetar!

Duke qenë se kjo pyetje është parashtruar më 27 janar 2014 dhe që nga ajo datë unë nuk kam pranuar as përgjigje me shkrim, por as prezencë të kryeministrit në seancë për t'u përgjigjur, unë kërkoj që ta lexoj pyetjen dhe kjo pyetje të publikohet në Buletinin e Kuvendit të Kosovës.

Atëherë, pyetja është: Varfëria është një nga çështjet sociale, po e them prapë, më akute në Republikën e Kosovës. Edhe një herë edhe nga shifrat të cilat na i prezantoi sot këtu ministri Rashiq, shifrat për varfërinë në Kosovë janë alarmante, posaçërisht fakti që edhe nga përgjigja e ministrit ne nuk pamë se kjo Qeveri identifikon në mënyrë specifike se sa është shkalla e varfërisë tek të rinjtë dhe te gratë.

Prandaj pyetja ime konkrete për kryeministrin e Republikës së Kosovës është: Cilat janë programet, politikat e projektet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014 që kanë për qëllim në mënyrë specifike zvogëlimin e varfërisë në Kosovë dhe cili pritet të jetë efekti i këtyre masave?

Pra, për sa do të zvogëlohet varfëria e familjeve kosovare gjatë vitit 2014?

Një gjë është dëshmuar si rritje konstante në këto vite të kësaj qeverisjeje, rritja e pasurisë së pushtetarëve dhe rritja e varfërisë në Kosovë.

Pra cilat janë projektet e Qeverisë me këtë rast që në mënyrë specifike targetojnë ndihmë konkrete për daljen nga varfëria për gratë dhe për të rinjtë në Republikën e Kosovës? Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Agim Çeku.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Këta ministrat dhe kryeministri po bëjnë keq që s'po i marrin aeroplanët dhe të vijnë të na përgjigjen në pyetje, por ne nuk do të zemërohemi dhe do të parashetrojmë pyetjet dhe pastaj Sekretaria do t'ua përcjellë.

Për ministrin Çeku, i kam përmbledhur shqetësimet e veteranëve, të invalidëve, pjesëtarëve dhe të internuarve të UÇK-së që shqetësimet e tyre janë brengosëse për zgjidhjen e statusit të tyre.

Trajtimi që aktualisht ata kanë është e padenjë për shoqërinë tonë dhe për institucionet e Republikës së Kosovës, duke parë gjendjen e kësaj pjese të shoqërisë sonë, e cila është më kontribuuesja për krijimin e këtij realitet, më imponohet kjo pyetje dhe e kam formuluar në muajin e kaluar.

Meqenëse ministri është zgjedhur kryetar i Komisionit për verifikimin dhe njohjen e statusit të veteranëve të invalidëve, pjesëtarëve dhe të internuarve të UÇK-së dhe tani kemi vërejtje në azhurnimin e punës së këtij komisionit, është në interes për opinionin e gjerë dhe për Kuvendin e Kosovës, ta njoftojë për sfidat që ka komisioni dhe afatet kohore kur do të përfundojë procesin e verifikimit.

Kjo është pyetja që besoj se do t'i përcillet dhe ai do të na përgjigjet në një seancë të ardhshme.

E kam edhe një pyetje tjetër, sigurisht që...

KRYETARI: Unë ta jap fjalën! Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi, tash po shkojmë me rend.

KYMETE BYTYÇI: Faleminderit, kryetar!

Unë edhe pasi s'është ministri këtu këtë pyetje e kam pasur më 29.1.2014, mirëpo tash do ta parashtroj edhe pse s'është ministri këtu, besoj që ai do ta dëgjojë dhe do të na japë përgjigje kur të vjen në seancën e radhës, por sot do ta parashtroj pyetjen.

Unë për hir të pjesëtarëve të policisë do ta parashtroj pyetjen. Policia e Kosovës si segment kryesor për ruajtjen e rendit dhe sigurisë së qytetarëve të vendit janë duke u përballur me kushte jo të favorshme për kryerjen e detyrave të punës, si uniformat nuk i kanë të kualitetit të mirë, pagesa për ndërrimin e natës është shumë e ulët e tjera, andaj kërkoj nga ministri që të më njoftoj se a janë marrë masat për përmirësimin e kushteve për Policinë e Kosovës? Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Deputeti Halit Krasniqi, pyetje për ministrin Fadil Ismajli.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Pakënaqësitë e qytetarëve për administrimin e shpenzimeve të energjisë elektrike janë të shpeshta dhe të shumta në numër. Nuk do të duhej të dyshoj në arsyeshmërinë e tyre. Shumë nga ekspertët e njehsorëve elektrikë shprehin dyshimet në cilësinë e tyre.

Unë dëshiroj që ministrit t'i përcillet kjo pyetje e formuluar kështu, siç do ta lexoj tash.

Cilat kanë qenë angazhimet e ministrit për vlerësimin e shqetësimeve të konsumatorëve të energjisë elektrike dhe a ka plane për t'i propozuar ZRE-s ndryshimin e kësaj gjendje, sidomos ndryshimin e kohës së tarifave të natës dhe të ditës, sepse koha e tarifës së lirë prej orës 22 deri në orën 6 të mëngjesit nuk bëhen shpenzime për arsye të shumta që i njohim të gjithë qytetarët për shkakun e mungesës së ujit dhe të rrymës që nuk janë gjithnjë në dispozicion të qytetarëve dhe nuk mund t'i shfrytëzojnë gjithnjë dhe natyrisht që aparatet e amvisërisë i shfrytëzojmë në kohë të tjera kur natyrisht që faturohet rryma me tarifa të shtrenjta.

Dhe mendoj që ky propozim, kjo ide e ky koncept do të shtrohet në ministri nga ekspertët e saj dhe do të bëhet një lehtësim në shpenzimet e qytetarëve të energjisë elektrike. Faleminderit!

KRYETARI: Veç t'ju njoftoj deputetë që pyetjet që lexohen këtu paraprakisht u janë dërguar ministrave, kështu që ata i kanë marrë pyetjet. Deputeti Daut Haradinaj, pyetje për ministrin Çeku.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Meqë ministri nuk është këtu unë do ta bëj pyetjen, kohëve të fundit duke u përfolur shumë për pjesëtarët e UDB-së siç tha edhe Florin Krasniqi që janë edhe në institucione dhe janë bërë edhe shumë aktivë nëpër media, unë desha ta pyes tash kryetarin e

Komisionit për verifikimin e kategorive të dala nga lufta se pjesëtarët e UDB-së të cilët kanë marrë pjesë në luftë, a do të gëzojnë statusin e veteranit të luftës dhe nëse po, a do të jetë pjesë e ligjit kjo? Faleminderit, kryetar!

KRYETARI: Ndoshta ministri ka dëgjuar dhe të përgjigjet. Fjalën e ka deputeti Agim Kuleta, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Nuk dëshiron. Mirë! Deputetja Alma Lama, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Deputete, do ta parashtrosh pyetjen?

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Ekziston një listë e organizatave terroriste të shpallura nga OKB-ja dhe po kështu një tjetër listë shumë më e zgjeruar nga Bashkimi Evropian.

Shtetet e ndryshme kanë gjithashtu listat e tyre për organizatat që i konsiderojnë terroriste dhe në bazë të tyre ndiqen edhe veprimet konkrete kundër tyre.

Pyetja për ministrin e Brendshëm, zotin Bajram Rexhepi, është kjo: A ka shteti i Kosovës një listë të tillë, nëse jo, pse duke pasur parasysh edhe rreziqet e mëdha që mund t'i vijnë Kosovës si një shtet i pakonsoliduar edhe në aspektin e sigurisë? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Xhevahire Izmaku, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. A do ta parashtrosh pyetjen? Jo. Vazhdojmë. Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje zëvendëskryeministrin Kuçi. A do ta parashtrosh pyetjen, Albulena? Urdhëro.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar!

Unë e parashtrova pyetjen edhe në seancën e kaluar, po e parashtroj edhe kësaj radhe me shpresën që ministri do të japë përgjigje. Pra, ka të bëjë me organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë. Pra, është paraparë që zgjedhjet të mbahen më 16 mars dhe deklaratat e Serbisë janë që do t'i organizojë edhe në territorin e Republikës së Kosovës, andaj pyetja ime ka qenë që me çfarë baze ligjore kjo Qeveri lejon organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, meqë dihet tashmë që shtetet kur ta njohin njëra-tjetrën, ndodh edhe realizimi i të drejtës së votës për qytetarët që e kanë dyshtetësinë dhe kjo nuk ka ndodhur dhe është e papranueshme dhe është cenim i sovranitetit dhe integritetit territorial, lejimi i zgjedhjeve nga Serbia në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Albana Gashi, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Albana, dëshiron ta lexosh pyetjen?

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryetar!

Këtë pyetje unë e kam nga seanca e kaluar, mirëpo meqë që dy seanca rresht ministri nuk është prezent në sallë, unë po e parashtroj pyetjen:

Gjatë protestave të cilat u organizuan nga studentët e Universitetit të Prishtinës kundër abuzimeve, korrupsionit në këtë institucion, kemi parë një numër të madh të forcave të rendit të cilët përveç se janë futur në hapësirat e Universitetit, kanë përdorur edhe dhunë kundër studentëve protestues.

Për të mbrojtur korrupsionin dhe krimin në Universitetin e Prishtinës, Bajram Rexhepi ka vënë policinë kundër studentëve duke shkelur kështu dy ligje, atë për arsimin e lartë ku cenohet paprekshmëria nga organet e rendit në këtë institucion si dhe Ligjin për Policinë e Kosovës, ku zyrtari policor ka për detyrë t'i refuzojë urdhrat të cilët janë të paligjshëm dhe të raportojë për këtë menjëherë në pajtim me aktet nënligjore. Në këtë rast janë shkelur këto dy ligje, mirëpo kjo nuk është e tëra, ditën e fundit të protestës janë arrestuar, në fakt janë rrëmbyer qytetarë nga policë civilë dhe janë bartur për në stacionet policore me vetura policie. Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës rrëmbimi është vepër penale e cila dënohet deri në 10 vjet burgim.

Pyetja ime për ministrin është: a duhet të japë përgjegjësi dikush për këto veprime? Faleminderit!

KRYETARI: Deputetja Alma Lama, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Deputete, e do fjalën? S'është këtu. Deputeti Salih Morina, pyetje për ministrin Besim Beqaj. Në rregull, e përfunduam edhe pikën e dytë të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës. Kush ka për rend dite? Fjalën e ka deputeti Arben Gashi, për rendin e ditës.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike propozoj që pika 11 e rendit të ditës 11- *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti*, të hiqet nga rendi i ditës.

Arsyetimi për heqjen nga rendi i ditës të kësaj pike është sepse me këtë ligj nuk përfshihet periudha e vitit '90-'99, ku është organizuar sistemi paralel dhe ku njerëzit kanë dhënë kontributin dhe kanë ruajtur identitetin- qytetarë të Kosovës dhe kanë ruajtur po ashtu identitetin institucional dhe kanë krijuar kushte nën kushtet e terrorit duke punuar.

Po ashtu problem thelbësor sa i përket këtij ligji është edhe mohimi i të drejtës kushtetuese dhe i drejtës sipas Kartës Evropiane për Liritë dhe të Drejtat Themelore të Njeriut, i drejtës në pronë, sepse me këtë ligj thuhet që përfitojnë nga skema pensionale e financiar nga shteti të gjithë personat të cilët kanë arritur që të punojnë për 15 vjet. Ata që kanë punuar 14 vjet e 363 ditë nuk përfitojnë nga skema pensionale, prandaj sipas vlerësimit tonë kjo është në kundërshtim me të drejtën kushtetuese, të drejtën e pronës, sepse kontributi pensional konsiderohet si pronë. Edhe nëse ke punuar 2 ditë ai është kontribut i yti personal dhe ky kontribut duhet të kthehet dhe edhe ai që ka punuar 15 vjet.

Është e vërtetë se kjo duhet të përshkallëzohet për shkallën e kontributit që është dhënë, mirëpo nuk mund të eliminohen për 15 vjet të gjithë ata që kanë punuar.

Prandaj duke u bazuar në këto dy pika themelore që janë, mohimi i një periudhe prej dhjetëvjeçare e kontributit në ndërtimin e institucioneve dhe shtetit të Kosovës duke bërë

rezistencë presionit serb dhe në të njëjtën kohë mohimi për 15 vjet të kontributit pensional, Lidhja Demokratike e Kosovës propozon që ky ligj, Ligji për skemat pensionale të financuara nga shteti të kthehet në Komisionin Funksional dhe të trajtohen këto...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Për rend të ditës fjalët nuk janë shumë të gjata. Mirë, regjia zgjatja fjalën, po ta keni parasysh nuk e ke 10 minuta fjalën. Urdhëro, Arben.

ARBEN GASHI: Atëherë, si përfundim Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike propozon që ky ligj të kthehet në Komisionin Funksional dhe Komisioni Funksional t'i përfshijë këto dy tema dhe në të njëjtën kohë nëse kjo çështje nuk hiqet nga rendi i ditës, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës kur të vjen në shqyrtim kjo çështje e rendit të ditës nuk do të marrë pjesë në seancë. Faleminderit!

KRYTARI: Ministër, e ke fjalën.

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsjedniče! Znae da zakon je već na žalost nekih, od septembra prošle godine, znači godinu i po dana je u Parlamentu i stvarno ja mislim da pre svega imamo moralnu odgovornost prema penzionerima, prema građanima da zakon finalno obude usvojen.

Ja ću opet da ponovim ono što sam rekao još ranije. Zakon o penzijama je bio apsolutno harmonizovan sa svim relevantnim partnerima bilo domaćim bilo međunarodnim. Ponovim još jednom da je Svetska banka bila tehnički da kažem tako stručnjak u ovom samom procesu a Međunarodni monetarni fond je bio sa te finansijskog aspekta onaj koji nam pomagao.

Što se tiče vaših konkretnih ovih primedbi videli ste i sami tamo u jednom od tačaka se piše da što se tiče staža pogotovo ljudi koji su na silu bili izbačeni sa posla u godinama 90'tim da će biti regulisano jednim pravnim pod zakonskim aktom za koji ja mogu da vam obećajam da će biti obavljen u što kraćem mogućem roku a pored toga mislim da način oko 15 godina staža će samim tim ovim stažom koji će biti priznat u tim godinama 90-tim omogućiti da se oni pređu u onu drugu bolju kategoriju i da dobijaju konkretne beneficije.

Već sam ranije pričao da ukoliko ne usvojimo zakon mi imamo jedan strašno veliki izazov a to su bilateralni odnosi. Potsećam još jednom da sa Švajcarskom smo intenzivno počeli u toku ove godine da, potsećam diaspora u Švajcarskoj jeste velika i da nam treba jedan osnov baza jedna, jedna od uslova koju su nam postavili nama je bilo da moramo da imamo zakon o penzijama.

Drugi aspekt, ja mislim da najviše štetimo penzinerima...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Mirë, edhe dy minuta, vazhdojani!

MINISTAR NENAD RAŠIĆ: ...što znači da ukoliko ne budemo imali zakon svi bilateralni sporazumi koji bi mogli da napravimo, da rešimo, neće biti mogući.

Pod dva, kategorizacija koja je predviđena da uspostavimo jednom penzionere odnosno da ih kategorizujemo njih na osnovu njihovog oborazovanja, njihovog iskusstva, njihovog radnog staža nećemo biti u stanju da to radimo ukoliko nemamo zakon.

Pod tri, generalno mislim da će zakon ući u jednu modifikaciju koja stvarno neće doneti nikome dobro i mislim da, ja molim u stvari da zakon stvarno najozbiljno uvojimo zbog toga što mislim da je jedan neopohodna faza koju mi moramo da pokažemo kao sposobne institucije da se izbore sa ovakvom vrstu problema.

Zakon inače od 2007. godine faktički je u izradi. Ja vas molim da imate to na umu kada budete usvajali ovaj zakon današnji i ona obaveza koja ostaje nama je da što pre, čak piše u roku od godinu dana, mogu da vam kažem da ćemo čak šta više ovako od 6 meseci sve ove primedbe koje vi imate, pogotovo za priznavanje staža biti regulisan.

Znači našu posvećenost je apsolutna. Samo moramo taj korak da napravimo jer imamo mnogo negativnih stvar ukoliko zakon ne bude usvojen, a ukoliko bude usvojen počinjemo jedan pravi odnos prema penzionerima gde možemo da ih stimulišemo, afirmišemo a takođe da ispoštujemo ono što su oni učinili za Kosovo.
Hvala!

KRYETARI: Unë po ju njoftoj kush ka të drejtë për fjalë tash se ne e kemi një mocion.

Deputetëve nuk ua jap fjalën, vetëm në emër të grupeve, nëse ka dhe vetëm nga një.

(Ndërhyrje)

Po ti e bëre mocionin, nuk e di çka ke ta sqarosh ministrin, ministri e di çka po thotë. Urdhëro, replikë, Arben Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike qëndron fuqishëm prapa vendimit se nuk mohohet një periudhë dhjetëvjeçare, e cila ka qenë periudhë jashtëzakonisht e rëndësishme për qytetarët e Kosovës dhe kjo nuk mund të mohohet dhe duhet të përfshihet në këtë ligj.

Në rast se nuk përshihet në këtë ligj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike do të marrë dy veprime.

E para, do të braktisë këtë seancë në momentin kur vjen kjo pikë në shqyrtim dhe e dyta do të propozojë, do të marrë nismën legjislative për ta trajtuar këtë periudhë.

Dhe po ashtu në të njëjtën kohë ju paralajmëron se ky ligj në vendosjen e minimumit prej 15 vjetësh është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, është në kundërshtim me Ligjin kundër diskriminimit dhe është në kundërshtim me Protokollin e Konventës Evropiane për Liritë dhe Drejtat e Njeriut, sepse mohon të drejtën në qasje në pronë, sepse mohohet kontributi për 15 vjet që konsiderohet pronë, e drejtë pronësore. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Unë të them të drejtën, në emër të grupit i bashkëngjitem këtij debati. Realisht, ligji ndodhet prej vitit 2007 dhe e dimë pozicionin e pensionistëve të cilët në mënyrë lineare marrin të ardhurat e njëjta pa marrë parasysh vitet e punës, pa marrë parasysh nivelin e shkollimit të tyre dhe kualifikimin në vendin ku kanë punuar më herët.

U përmendën një sërë problemesh tjera që dalin në mungesën e këtij ligji dhe kontratat ndërqeveritare që e pengojnë, domethënë marrëveshjet ndërqeveritare Lidhjen e Pensionistëve që punojnë jashtë vendit tonë dhe ky problem po na përcjell qysh nga mandatet e kaluara, prandaj është ligji i domosdoshëm për ta nisur një proces.

Unë e di se u bëhet një diskriminim atyre që kanë punuar për këto vite, që e përmendi kolegu që e solli dhe këtë çështje këtu në diskutim, por ka mundësi tjera dhe ligjet e tjera ku edhe në program shihen ku për shembull do të pranohen këto vite.

Ky ligj duhet të votohet. Dhe e përsëris, komisioni ka punuar gjatë në këtë ligj. Lidhja Demokratike i ka pasur përfaqësuesit e vet dhe këtë çështje nuk e ka ngritur gjatë tërë kësaj kohe në komision.

KRYETARI: Mirë! A keni amendamentuar ju Lidhja Demokratike? A janë amendamentet këtu? Mirë, vazhdojmë. Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Përveç çështjes së punonjësve gjatë viteve të ‘90-ta, ky ligj ka edhe shumë probleme të tjera.

Ne i kemi një varg vërejtjesh, prandaj dhe pajtohem që ky ligj t’i kthehet prapë komisionit për arsye se në thelb nuk e siguron atë të cilën pretendon ta sigurojë, sepse ky ligj në këtë formë që është konceptuar është më tepër lëmoshë se sa një ligj, i cili siguron një jetë me dinjitet.

KRYETARI: Ju njoftoj, vetëm në emër të grupeve keni të drejtë të flitni. Daut Haradinaj, në emër të Aleancës, e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Po ashtu, edhe Aleanca mendon që ky ligj duhet t'i kthehet edhe një herë komisionit. Është ligj që i ka përfshirë shumë kategori. Është e vërtetë që ajo me të cilën ne tash jemi duke u shqetësuar, dhe pajtohem me zotin Gashin kur tha se duhet të trajtohet edhe kategoria e mësimdhënësve para luftës, ose dhjetëvjeçari i tyre, për shkak se ata e meritojnë, dhe mendoj që ne si shoqëri ua kemi borxh një trajtim juridik, jo vetëm kompensim.

Si do që të jetë, unë mendoj që ky ligj t'i kthehet prapa komisionit, të riamendamentohet dhe të kthehet prapë në Kuvend.

KRYETARI: Në emër të SLS-së, kryetari Sasha Milosavleviq e ka fjalën.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!

I Poslanička grupa Samostalne liberalna stranka će podržati predlog gospodina Gašija, da se ovaj Zakon vrati Komisiji. Hvala!

KRYETARI: Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Duke marrë parasysh se në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kanë qenë të gjitha grupet parlamentare dhe ky ligj një kohë të gjatë është aty, në rast se duam që ta përkrahim edhe atë pjesë të shoqërisë, besoj që LDK-ja ka dalë me një amendament dhe mund ta miratojmë atë në Kuvend, mirëpo ligjit t'i jepet mundësia që të shkojë në lexim të dytë.

KRYETARI: Në emër të Grupit “6+”, kryetarja Myfera Shinik e ka fjalën.

MYFERA SHINIK:

Teşekkür ederim Sayın Başkan

Gerçi Sağlık Komisyonundan bu yasaya amandman verebilmek için uzun bir zamanımız vardı, ama görünen o ki bu Yasa Tasarısının tekrardan komisyona girtmesi gerektiğini inanıyoruz ve giderse daha başarılı, daha kaliteli bir yasa çıkacağına inanıyoruz.

Teşekkür ederim!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I kemi të pranishëm 76 deputetë. E kemi mocionin që ligjin t'ia kthejmë komisionit për rishqyrtim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 60 vota për, 11 kundër dhe 2 abstenime, ligji i kthehet për ripunim komisionit.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i propozim-programit të punës së Kuvendit për vitin 2014

Programi i punës së Kuvendit për vitin 2014 është hartuar në bazë të programit legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014, të planeve të punës së komisioneve parlamentare për vitin 2014 dhe Planit të Veprimit për negocimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Programi i punës për vitin 2014 paraqet një dokument bazë për aktivitetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës si organ ligjvënës, mbikëqyrës dhe përfaqësues.

E do fjalën kryetari i komisionit? Jo. Atëherë në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Në emër të Komisionit për Integritet, deputetja Vjosa Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Unë shumë shkurt, vetëm desha ta lus Administratën që të harmonizohet ky plan i punës edhe me planin e punës që e ka dërgua Komisioni për Integritet Evropian, sepse disa prej ligjeve që ne i kemi paraparë në monitorim nuk janë të përfshira. Po ashtu disa prej raportimeve që i kemi paraparë nuk janë të përfshira dhe po ashtu nga diskutimet që i patëm edhe dje, siç e dini, të përfshihen edhe 3-4 ligje të tjera të cilat nuk janë tani.

Mund t'i dërgoj edhe me shkrim në qoftë se ka nevojë. Besoj që kjo e lehtëson punën, sepse disa janë përfshirë, mirëpo diku 50% e tyre që janë paraparë në Komisionin për Integritet Evropian nuk figurojnë këtu. Faleminderit!

KRYETARI: Dhe, çka propozon, ta shtyjmë, apo kur të bëhen bashkë?

VJOSA OSMANI: Propozimi im është që ky plan i punës të mos miratohet pa i përfshirë të gjitha ato që i ka paraparë komisioni. Nuk e di, që qoftë se komisionet tjera kanë ndonjë vërejtje, mirëpo nga komisioni ynë nuk janë përfshirë të gjitha ligjet që janë paraparë të monitorohen, apo edhe të gjitha raportimet që i kemi dorëzuar në Kryesinë e Kuvendit.

KRYETARI: Nënkryetari Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kolegë deputetë,

Zonja e zotërinj,

Ky është një program që vjen në seancë dhe duhet të aprovohet këtu. Është diskutuar gjerë e gjatë edhe në Kryesinë e Kuvendit. Nuk dua t'i përsëris të gjitha arsyet dhe vërejtjet që kam pasur atje. Por, ashiqare, të gjitha zhvillimet legjislative që i kemi ne, edhe zhvillimet politike, edhe sezonin zgjedhor, na bëjnë ta studiojmë këtë program, e të mos e kalojmë formalisht.

Unë kam disa objeksione që i kam thënë, nuk dua t'i përsëris të gjitha. Po së pari, ne e kemi një program legjislativ të strukturuar në kohë që ne e dimë që nuk do të kalojë për shkak të kohës, të rrethanave.

E dyta, ne kemi ligje që propozohen në diskutime politike të përditshme, që do të bëhen shpejt, njëri prej tyre ishte sot këtu, ministri e tha. Ai nuk ekziston hiç në strategjinë legjislative që e kemi ne.

Ne kemi ligje që na detyrojnë për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, që thonë duhet të kalojnë bile në 2-3 muaj. Ne nuk i kemi hiç në këtë listë dhe po pushoj, nuk po bëjë vërejtje tjera, sepse janë mbi dhjetë sosh.

Meqë është kështu dhe meqë duhet të bëhemi më racionalë për punën që do ta bëjmë dhe duhet ta shfrytëzojmë kohën që ligjet e domosdoshme për Kosovën dhe për raportet integruese të Kosovës të jenë në pjesën e parë të këtij viti, kur eventualisht do të përfundojnë, unë mendoj që sot mund të merremi vesh të merren të gjitha këto elemente dhe të përpunohet kjo strategji e të kalojë në një mbledhje tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mendoj që deputetja Vjosa Osmani kishte të drejtë, por tash, pasi e kemi futur në rend të ditës, duhet një votim formal për ta shtyrë këtë dhe të plotësohet. A jeni dakord që të plotësohet? Kush është për? Faleminderit! Kundër nuk ka.

Vazhdojmë pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë

Në bazë të nenin 56 të rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtua projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, Blerand Stavileci, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Roli i statistikave në krijimin e politikave të mirëfillta, veçanërisht në rastin e ekonomive në tranzicion, ku ndryshimet janë të vazhdueshme, është i një rëndësie vendimtare dhe i një rëndësie të tillë është edhe në rastin e statistikave bujqësore ku informacionet luajnë rol shumë të rëndësishëm në procesin e bërjes së politikave në vendimmarrjes, si dhe në programimin, implementimin e monitorimin e programit vjetor.

Regjistrimi bujqësor në Kosovë nuk është bërë që nga viti 1960 dhe kjo ka krijuar vështirësi të mëdha te ne, veçanërisht në sigurimin e informacioneve të sakta dhe të besueshme për sektorin e bujqësisë.

Prandaj, hartimi i ligjit dhe krijimi i kornizës ligjore mbi parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me përmbajtjen dhe organizimin kanë qenë jetike për realizimin e regjistrimit të përgjithshëm bujqësor, i cili ka qenë i planifikuar të realizohet në nëntor të vitit të kaluar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe institucionet tjera të rëndësishme.

Si pasojë e mbajtjes së zgjedhjeve lokale në nëntor të vitit të kaluar, meqë kryetarët bashkë me dy zyrtarë të tjerë e kanë rolin kyç në komisionet komunale të regjistrimit, si dhe për shkak që fushata informative do të duhej të mbahej në të njëjtën kohë me fushatën politike dhe përçimi i mesazhit në opinion do të ishte shumë i vështirë në atë kohë, jemi detyruar ta shtyjme këtë regjistrim për ta siguruar një mbarëvajtje më të mirë të tij dhe, si rrjedhojë, tani është paraqitur nevoja ta amendamentojmë edhe ligjin për shkak të ndryshimit të periudhave kohore.

Pra, i tërë teksti i ligjit bazik për regjistrimin që ju e keni aprovuar vitin e kaluar mbetet i njëjtë, por ka ndryshim vetëm në data. Për shembull, mbledhja e të dhënave të regjistrimit të bujqësisë do të realizohet nga data 1 deri më 30 qershor 2014, shfrytëzimi i tokës për një vit bujqësor, sipas këtij ligji, llogaritet nga 31 tetor 2013 deri më 1 nëntor 2014. Pastaj, pas përfundimit të regjistrimit prej datës 1 deri më 20 korrik kryhet anketa pas regjistrimit, e cila bazohet në mostër përfaqësuese të ekonomive bujqësore deri në 1% të ekonomive bujqësore, derisa Agjencia e Statistikave, bazuar në këtë plotësim-ndryshim të ligjit duhet të shpallë rezultatet e përkohshme të regjistrimit deri më 28 shtator të këtij viti dhe rezultatet përfundimtare në formë elektronike dhe në letër pas 30 prillit 2015.

Gjithashtu, bazuar në plotësim-ndryshimin e ligjit, mandati i Komisionit të Regjistrimit të Bujqësisë përfundon më 30 shtator 2014 dhe pas kësaj date detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni duhet të transferohen tek Agjencia e Statistikave e Kosovës. Pra, kryesisht këto janë ndryshimet që janë bërë në ligjin bazik, e asgjë nuk është ndryshuar në tekst, përpos datave.

Metoda e regjistrimit që do të praktikohet, për informatën tuaj, do të jetë metoda tradicionale ‘derë më derë’ me anë të pyetësorëve të regjistrimit për ekonomitë bujqësore në zonat rurale.

Prandaj, duke pasur parasysh rrëndësin e tij, meqë nuk ka pasur ndryshime të tjera, ju ftoj që ta apromoni. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë, pas paraqitjes së projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Fjalën e merr kryetari i Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zoti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje ministër,

Komisioni e ka shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin e bujqësisë dhe Kuvendit i rekomandon që ta miratojë në parim dhe është i nevojshëm që ky projektligj për shkak se ato që i përmendi edhe ministri janë rrethana, të cilat kërkojnë që ta ndryshojmë dhe ta plotësojmë në këto ndryshime të datave.

Komisioni kërkon nga Kuvendi ta miratojë këtë projektligj dhe të amendamentojmë më tutje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash t'i dëgjojmë deklaratat e shefave, ose përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Për Partinë Demokratike të Kosovës, Ramiz Lladrovci e ka fjalën.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër L-127 për regjistrimin e bujqësisë.

Vlerësojmë se projektligji i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren e Kuvendit dhe i rekomandojmë Kuvendit për miratim. Kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit të këtij ndryshimi të datave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për LDK-në, deklaratën e jep deputeti Salih Morina.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë, meqë ka të bëjë pikërisht me shtyrjen e afatit, atë që e tha edhe ministri, dhe njëkohësisht kjo shtyrje bartet për vitin 2014. Por, ne si grup parlamentar kërkojmë që ministri këtë çështje dhe këtë regjistrim të bujqësisë paraprakisht ta kryejë gjatë vitit 2014, me të vetmin qëllim që të mos kemi shtyrje edhe për vite të tjera, sepse do të jetë në interes, në radhë të parë edhe të Ministrisë së Bujqësisë, por njëkohësisht kjo çështje është raportuar edhe në Raportin e Progresit, me të cilin kërkohet që edhe Kosova ta kryejë një obligim të tillë nëpërmjet këtij ligji.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike në parim e mbështet këtë projektligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të "Vetëvendosjes", flet Faton Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuara deputete,

Projektligjin të cilin e kemi përpara ndryshon nga i vjetri vetëm sa u përket neneve që lidhen me datat e regjistrimit. Në këtë kuptim, se si grup parlamentar e mbështetim.

Megjithatë, më lejoni që me këtë rast ta përmend nenin 6, i cili merret me të dhënat e mbledhura gjatë regjistrimit, e që nuk është pjesë e ndryshimit.

Sipas nenit 6, paragrafi 2.4, duhet të mblidhen të dhëna lidhur me blegtorinë sipas llojeve dhe kategorive. Ky nen nuk siguron informacione të duhura.

Numri i kafshëve ndryshon shumë shpejt për shkak të lindjeve të reja, therjeve, ngordhjeve dhe shitjeve prej një pronari te pronari tjetër.

Shikuar nga ky prizëm, ne do t'i kemi të dhënat, të cilat brenda një kohe të shkurtër nuk do të përkojnë me situatën reale në terren.

Ekspertët e kësaj fushe preferojnë që kjo pjesë e regjistrimit të kafshëve bujqësore duhet të lidhet ngushtë me sektorin e identifikim-regjistrimit të kafshëve në Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinarisë.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e ka një softuer me të cilin do të duhej të ishin të regjistruara të gjitha kafshët bujqësore në Kosovë, pra ato që njihen si kafshë me vath në vesh.

Detyra e agjencisë në fjalë është t'i regjistrojë kafshët e lindura, t'i çlajmërojë kafshët e therura, të ngordhura ose të shituar te pronarët e tjerë.

Ky sistem shumë i rëndësishëm i regjistrimit të blegtorisë nuk është duke funksionuar te ne, edhe pse janë shpenzuar shumë mjete për të.

Nëse nuk ndryshohet dhe plotësohet kjo pjesë e ligjit, ne nuk do të kemi të dhëna të cilat mund ta mbështetin ekonominë, por edhe planifikimin blegtoral, nevojat dhe politikat stimuluese për bujqësinë.

Pa këtë ndryshim, ligji do të jetë i mangët dhe nuk do t'i plotësojë nevojat për informacion në njërin prej sektorëve të rëndësishëm të blegtorisë.

Komisioni Evropian ka rekomanduar disa herë për një regjistrim të saktë të blegtorisë dhe gjurmëshmërisë të lëvizjeve në blegtori, sepse kjo, përveç tjerash, lidhet edhe lëvizjen e sëmundeve, kontrollin e tyre dhe një varg çështjesh të tjera që u theksuan më lart.

Ne do të angazhohemi që këtë çështje ta diskutojmë në komision, sepse bëhet fjalë për një ndryshim shumë të rëndësishëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, flet deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Duke e ditur rëndësinë e këtij projektligji, edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë dhe do ta përkrahim në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Koalicioni për Kosovë të Re, Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Projektligji përmban 5 nene, është çështje e ndërrimit të datave dhe ne e përkrahim. Meqenëse ministria e ka filluar veç regjistrimin e bujqësisë, është mirë që të gjithë ta përkrahin këtë ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+”, deputeti Rasim Demiri e ka fjalën.

RASIM DEMIRI: Hvala predsedavajući!

Parlamentarna grupa “6+” je razmotrila preporuku ovog Nacrta zakona o registovanju poljoprivrede, tako da podržavamo ovaj nacrt i daćemo svoj doprinos u daljem radu. Hvala!

KRYESUESI: Fjalën e merr deputeti Nijazi Idrizi.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Unë vetëm dëshiroj të shpreh dyshimin tim nëse ka mundësi që ky projektligj për arsyet e njohura që është shtyrë nga viti i kaluar, për shkak se kanë qenë zgjedhjet lokale, të shtyhet edhe këtë vit dhe a është menduar që edhe ky vit është vit elektorale dhe ka mundësi që të njëjtit aktorë të jenë të kyçur nga fushatë elektorale dhe, për mendimin tim, këtu është edhe dilema. Nëse janë arsyet e qëndrueshme ato që ky ligj vitin e kaluar u shty për arsye elektorale, edhe këtë vit ky ligj ka mundësi të shtyhet për të njëjtat arsye.

Fakti tjetër është, me sa e kam parë unë, nuk janë bërë përgatitjet e duhura, përveç që janë themeluar komisionet, punë tjetër në këtë drejtim nuk është bërë. Unë për vete dyshoj që ky ligj ka mundësi këtë vit të zbatohet dhe regjistrimi kaq i nevojshëm për bujqësi të kryhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë që duan ta marrin fjalën. I thërras deputetët të ulen dhe të hyjnë në sallë se do të votojmë.

Zotërinj deputetë dhe regjia, bëhemi gati ta votojmë projektligjin. Në sallë janë të pranishëm 62 deputetë. Votojmë tash!

Votoni të gjithë! Edhe një herë votim! Votoni të gjithë se duhen 61 deklarime, votoni për, kundër, abstenoni, por votoni të gjithë. Edhe një herë! Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, dy abstenime dhe asnjë kundër, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrimin e bujqësisë.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror

Në bazë të nenin 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Infrastrukturës, zotëri Fehmi Mujota, që ta paraqesë projektligjin para Kuvendit. Zotëri ministër, urdhëro!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: I nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Sot para jush e paraqes Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

Projektligji parasheh themelimin e Agjencisë të shërbimeve të navigacionit ajror si agjenci shtetërore në pajtim me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Para dhënies me koncesion të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, shërbimet e navigacionit ajror kanë qenë pjesë përbërëse e aeroportit.

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka mbajtur si përgjegjësi të shtetit ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror si një fushë strategjike dhe të rëndësishme së veçantë dhe për këtë arsye këto shërbime nuk janë dhënë me koncesion.

Ofrimi i këtyre shërbimeve prej koncesionimit të aeroportit e këndej bëhen nga ndërmarrja publike “Adem Jashari”, që është e ndarë nga operimet e kryera nga partneri privat.

Nëpërmjet miratimit të këtij projektligji, ofruesi i shërbimeve të navigacionit do të shndërrohet në agjenci të shtetit me status të qartë juridik dhe me mundësi më të mëdha për zhvillimin dhe rritjen e spektrit të shërbimeve të ofruara.

Miratimi i Ligjit për themelimin e Agjencisë së shërbimeve të navigacionit ajror është identifikuar si sfidë dhe veprim prioritar në agjendën tonë të integriteteve evropiane.

Ky prioritet rrjedh edhe nga Raporti i Progresit të vitit 2013 për Republikën e Kosovës, që edhe këtë vit është vlerësuar si një arritje e mirë e vendit tonë në fushën e aviacionit civil.

Projektligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Ligjin për aviacionin civil, konventën e aviacionit civil ndërkombëtar dhe kuadrin ligjor të BE-së në fushën e navigimit ajror.

Si detyrim që kemi sipas marrëveshjes për hapësirën e përbashkët evropiane të aviacionit, hartimi i këtij projektligji është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian dhe ekspertë ndërkombëtarë që na kanë përkrahur në këtë proces.

Projektligji gjithashtu reflekton edhe përgjegjësitë e NATO-s në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

Themelimi i Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror ka edhe implikime financiare.

Sipas projektligjit, agjencia do të financohet nga të hyrat e gjeneruara nga shërbimet e navigacionit ajror, që u ofrojnë aeroplanëve që fluturojnë në hapësirën tonë ajrore. Është qëllim yni që kjo agjenci të jetë e vetëfinancuar 100% prej shërbimeve që do të ofrojë.

Tash për tash, shërbimet ofrohen për aeroplanët që aterrojnë dhe ngrihen nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës duke shfrytëzuar vetëm hapësirën e ulët ajrore.

Këto të hyra nuk mjaftojnë për vetëqëndrueshmëri financiare të agjencisë. Prandaj, është me interes jetik hapja e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës mbi 9 kilometra për mbikalimet komerciale.

Hapja e hapësirës së lartë ajrore do të gjeneronte të hyra shtesë për t'i mbuluar shpenzimet operative të agjencisë dhe për të investuar në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve teknologjike dhe njerëzore.

Siç jeni në dijeni, tash e disa vite jemi duke punuar me partnerët tanë të NATO-s për hapjen e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës për mbikalime.

Me delegim nga Këshilli i NATO-s sipas kompetencës që ka, te 'Hungaro-Kontrolli' i Hungarisë do të fillojë edhe ofrimi i përkohshëm i shërbimeve në hapësirën tonë të lartë ajrore në çerekun e dytë të këtij viti.

Miratimi i projektligjit krijon një bazë të mirë ligjore për zhvillimin e mëtutjeshëm të agjencisë sonë të shërbimeve të navigacionit ajror, në mënyrë që pas përfundimit të periudhës kalimtare t'i marrë të gjitha përgjegjësitë dhe në hapësirën e lartë, siç e ka në hapësirën e ulët ajrore.

Sipas projektligjit të propozuar, Agjencia e shërbimeve të navigacionit ajror do t'i raportojë Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe do të jetë nën mbikëqyrjen rregullore të Autoritetit të Aviacionit Civil.

Miratimi i këtij projektligji nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka rëndësi të veçantë edhe në forcimin e sovranitetit të shtetit, rritjen e nivelit të shërbimeve në përputhje me

standardet më të larta të sigurisë, si dhe do të jetë një hap i rëndësishëm përpara në agjendën tonë të integriteteve evropiane.

Ne e mirëpresim gjithë kontributin e Komisionit Funkcional, të të gjithë deputetëve dhe të gjithë profesionistëve të interesuar që në leximin e dytë të kontribuojnë që ligji të jetë edhe më funksional, edhe më i përmbajtjesor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E hap deputetin për diskutim në parim të këtij projektligji. Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Zenun Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni Funkcional për Zhvillim ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur më 28 janar, e ka shqyrtuar këtë projektligj.

Rekomandimi i komisionit është që të miratohet në parim Projektligji për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

E shfrytëzoj rastin ta falënderoj ministrin për informacionet shtesë që janë të nevojshme për deputetët me rastin e prezantimit të këtij projektligji.

Siç e përmendi ministri, e kemi pasur në trajtim, po ashtu e kemi pasur të theksuar po ashtu edhe në Raportin e Progresit nevojën e themelimit të kësaj agjencie.

Është një hap përpara për të gjitha çështjet që lidhen me navigacionin në përgjithësi, e në veçanti me navigacionin ajror. Por, mund të thuhet po ashtu se ky projektligj është prioritet dhe del si prioritet edhe nga negociatat e Qeverisë me Komisionin Evropian për MSA-në.

Dje, në një takim të përbashkët që e kemi pasur, po ashtu e kemi theksuar nevojën që me prioritet të trajtohen këto projektligje, e po ashtu edhe ky projektligj.

Unë i ftoj deputetët e interesuar që ta japin kontributin e tyre në komision në lexim të dytë, në mënyrë që sa më shpejtë ta përmbushim detyrën tonë, ta aprovojmë në seancën plenare. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash i kemi deklaratat e shefave të grupeve, ose të grupeve parlamentare. Për PDK-në, Sala Berisha-Shala e ka fjalën.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit zoti kryesues!

Përshëndetje ministër,

Të nderuar kolegë deputetë dhe ju të pranishëm,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka analizuar Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

Nevoja për miratimin e këtij ligji është e domosdoshme, duke marrë parasysh zhvillimin e sektorit të aviacionit civil dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e tregut të aviacioni civil.

Duke pasur parasysh konventën për aviacionin civil ndërkombëtar të dhjetorit të vitit '44 dhe marrëveshjen për themelimin e hapësirës së përbashkët evropiane të aviacionit, njëri ndër qëllimet e këtij ligji është edhe kjo, dhe për ta përmirësuar edhe më tej ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror, në mënyrë që të rritet efikasiteti, të përdoren më mirë teknologjitë e reja, të përshpejtohen përpjekjet për modernizim dhe t'u përgjigjet me efektivitet nevojave të publikut që udhëton, duke e rritur njëkohësisht sigurinë, sigurimin dhe efikasitetin e sistemit të transportit ajror të Republikës së Kosovës.

Ky ligj zbatohet për çdo avion që qarkullon në trafikun e përgjithshëm ajror në territorin dhe në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës, ose hapësirën tjetër ajrore për të cilën Republika e Kosovës e ka përgjegjësinë e ofrimit të shërbimeve të kontrollit të navigacionit ajror.

Grupi ynë Parlamentar e mbështet në parim këtë ligj, por ajo që dëshiroj të cek, që ka të bëjë me nenin 6, te emërimi dhe shkarkimi i drejtorit të kësaj agjencie, njëra ndër kriteret së paku për mua konsideroj që është e panevojshme, ku thuhet se "të flasë rrjedhshëm gjuhën angleze, kriteret për caktimin e një drejtori të kësaj agjencie dhe kriter për caktimin e zëvendësdrejtorëve të agjencisë". Ky mendoj që është një lloj paragjykimi. Unë e shtroj pyetjen: A duhet të jetë drejtori ai që konkurren në këtë pozitë qytetari i Kosovës dhe pse është e nevojshme të thuhet ta flasë rrjedhshëm gjuhën angleze? A duhet ta flasë rrjedhshëm edhe gjuhën shqipe, apo në qoftë se s'është kriter, s'do me thanë që duhet të jetë qytetar i Kosovës, por mund të konkurrojë edhe ndokush tjetër që i plotëson kriteret tjera profesionale. A duhet ta flasë rrjedhshëm edhe ai gjuhën shqipe?

Unë mendoj që të futet një kriter i tillë në ligj nuk është e arsyeshme. Ato kriteret mund të jenë ndoshta kriteret të konkursit dhe është e kuptueshme - cilido person që e ka një diplomë universitare dhe pasuniversitare natyrisht që e flet edhe gjuhën angleze, por ndoshta duhet të jetë kriter ta shkruajë gjuhën angleze.

Përndryshe, ne si Grup Parlamentar e mbështetim në parim, kurse kontributin tonë do ta japim në Komisionin FunkSIONAL gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e LDK-së, Lutfi Zarku e ka fjalën.

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Tash po bëhen dy vjet që e kemi pasur në shqyrtim të parë projektligjin, të cilin aktualisht po e shqyrtojmë. Ka kaluar në të gjitha procedurat dhe si komision jemi munduar ta amendantojmë ligjin dhe t'i bëjmë përmirësimet e nevojshme, por më vonë Qeveria e ka tërhequr.

Prapë, në realitet nuk shohim disa ndryshime esenciale që janë bërë në projektligj. Ne do t'i përsëritim vërejtjet tona, ato që i kemi përsëritur edhe në kohën e kaluar, natyrisht me shpresën dhe me besimin se në komision do ta amendamentojmë prapë projektligjin dhe do të vijmë deri te një projektligj siç duhet.

Mbetet dilema jonë sa i përket statusit të agjencisë: a duhet të jetë në kuadër të ministrisë, apo në kuadër të Qeverisë me asnjë dispozitë nuk përcaktohet ky status i agjencisë. Në anën tjetër, kemi dilema sa i përket statusit në lidhje me emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, të cilët natyrisht propozohen nga ministri, e që duhet të ishin të një pjesë e ministrisë, kurse emërohen nga Qeveria. Nuk e kemi të qartë pse kjo procedurë për emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, pse nuk është sikur të të gjitha agjencitë tjera që i kemi sipas ligjeve aktuale në fuqi.

Sa u përket drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, besoj se kemi dispozita të panevojshme, ku përshkruhen të gjitha kompetencat dhe natyrisht po shkruhen kushtet e përzgjedhjes. Kjo më së miri do të rregullohej nëpërmjet udhëzimeve të ndryshme administrative, e ligji të mos rëndohej me këto detaje.

Në anën tjetër, po ashtu është edhe kompensimi, i cili në mënyrë indirekte përcakton të themi disa minimume sa u përket pagave të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve. Po ashtu, është e paqartë pse duhet të jetë një mandat i plotë, kurse mandati i dytë të jetë vetëm dy vjet. Në shumicën e rasteve kemi një 1+1 mandat të plotë, por nuk kemi, së paku në tjera raste, kur kemi mandat të plotë, plus mandatin tjetër, më pak se gjysma e mandatit.

Në anën tjetër, te kompetencat e zëvendësdrejtorit e kemi një shqetësim se shumicën e rasteve i marrin të gjitha kompetencat e drejtorit, kështu që na duket se drejtori do të mbetet vetëm si kontroll i zëvendësdrejtorit kurse zëvendësdrejtori t'i ketë të gjitha kompetencat në menaxhimin e agjencisë.

Janë edhe disa çështje që kanë të bëjnë me personalin. Duhet të jemi të saktë sa i përket angazhimit të personelit të agjencisë me anë të kontraktimit të shërbimeve. Nëse një punëtor, ose është shërbyes civil, apo është punëtor i agjencisë, ose është i kontraktuar, por nuk mund të themi të kemi dilema sa i përket asaj se personeli i agjencisë a është kontraktues i jashtëm, apo është punëtor i agjencisë.

Delegimi i detyrave dhe kompetencave te kontraktorët e kualifikuar nga drejtori besojmë se duhet të rregullohet, se nuk mendoj që duhet të delegohen kompetencat e caktuara të drejtorit te kontraktorët e jashtëm. Dhe, në fund, po ashtu duhet të rregullohet çështja e të hyrave dhe financimit të agjencisë.

Megjithatë, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta votojë projektligjin, duke e parë si të nevojshme që shërbimet aktuale që ofrohen nga Departamenti i Operimeve në kuadër të ndërmarrjes publike "Adem Jashari" të kalojnë, apo të themelohet si agjenci e posaçme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, shefi i këtij grupi Visar Ymri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetët të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e dëgjova edhe ministrin, i cili tha që ligji është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Mendoj se kjo duhet të qartësohet, sepse këtu përpara e kam tekstin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës, e cila në nenin 130, kur flet për autoritetin civil të aviacionit thotë që, përveç tjerash, është ‘ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror sikur është përcaktuar me ligj’, dhe tash e kemi këtu një ligj përpara që e krijon një agjenci, e cila po ashtu është ofrues i shërbimit të navigacionit ajror.

Pra, është në përputhje me Kushtetutën, apo jo? Duhet ta qartësojmë këtë për shkak se kjo mendoj se është një shkelje, e nëse është shkelje mjaft serioze, sepse autoriteti ekzistues është kategori kushtetuese dhe ne nuk mund tash me ligj ta krijojmë në agjenci, e cila do t’i merrte kompetencat e autoritetit, meqenëse është kategori kushtetuese. Kjo është çështja një.

Çështja dy është që, edhe në ligj thuhet, edhe në memorandumin shpjegues, edhe në fjalën e ministrit, që qëllimi i krijimit të kësaj agjencie është zhvillimi i këtij shërbimi, i cili është shërbim i domosdoshëm, natyrisht për Kosovën. Dhe, në këtë drejtim, konsideroj që do të duhej një përgjigje nga ministri se cili është plani i zhvillimit, pra kah do të shkojë kjo agjenci dhe pse nuk ka mundur një gjë e tillë të bëhet me qendrën ekzistuese, meqë e kemi pasur një kompani publike, e cila i ka ofruar këto shërbime.

Pra, pse është dashur, pse duhet të avancohet në agjenci, dhe në çfarë mënyre kjo do t’i shërbente këtij zhvillimi, i cili po pajtohem të gjithë se është shumë i rëndësishëm për Kosovën.

Dhe, çështja e tretë që lidhet pak me atë që e tha ministri, pra me hapjen e hapësirës së lartë ajrore të Kosovës dhe me menaxhimin që do t’i bëjë kjo, ne e dimë që është një marrëveshje tash ndërmjet NATO-s dhe Hungarisë, që Hungaria që Hungaria ta ketë përgjegjësinë e kontrollit të kësaj hapësire ajrore për Kosovën. Do ta kisha pyetur ministrin, meqenëse jemi duke folur për të njëjtën çështje, nëse është në dijeni, a e ka parë kontratën e nënshkruar, a ka kontratë të nënshkruar me agjencinë hungareze për këtë çështje dhe sa është afati i kontratës?

Sepse, është e rëndësishme ta dimë se kur do të kemi gjasa që këto kompetenca t’u kalojnë autoriteteve të Kosovës, apo të bëhet në bashkëpunim me Shqipërinë dhe, në anën tjetër, çfarë përfitimi do të ketë Kosova nga kjo kontratë, nëse ka ndonjë përfitim financiar, sepse e dimë që këtu po flasim për përfitime goxha të mëdha financiare. Duke pasur parasysh qarkullimin transit që bëhet nëpërmjet ose përmbi territorin e Kosovës, këto të hyra do të duhej të ishin pjesë e të hyrave publike të agjencisë që po themelohet, ose të autoriteteve tjera në Kosovë, për të cilat janë të domosdoshme pastaj për ta zhvilluar këtë agjenci.

Sepse, sipas informatave që i kemi, zhvillimi ose rritja e kapaciteteve, qoftë të ndërmarrjes publike aktuale, ose të agjencisë që do të krijohet për ta kontrolluar edhe këtë hapësirë ajrore, nuk është se kërkon kushedi çfarë investimi të madh të papërballueshëm për Kosovën, e as nuk është që është e pamundshme që të arrijë në nivelin e ekspertizës dhe përgatitjes së kuadrove për një çështje të tillë, por është thjesht çështje politike dhe nga kjo çështje politike, ne do ta dimë se sa po përfiton Kosova me këtë, të them ashtu, aranzhim të përkohshëm që është bërë në emër të Kosovës, por pa pjesëmarrjen e saj.

Pra, është e domosdoshme që para se të flasim për agjencinë, ta dimë njëherë se cilat do të jetë e ardhmja e kësaj agjencie dhe cili është plani i Qeverisë dhe cilat janë potencialet e zhvillimit të këtij sektori në Kosovë, por natyrisht për përfitimet e Kosovës.

Vota e “Vetëvendosjes” në këtë rast do të jetë abstenuese për shkak se vërtet jemi të interesuar që ta qartësojmë çështjen e ndërveprimit me Kushtetutën dhe me autoritetin e aviacionit civil, që është kategori kushtetuese.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të AAK-së, deputetja Time Kadrija e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe do ta përkrahë në parim. Vërejtjet dhe sugjerimet do t’i adresojmë në Komisionin Parlamentar gjatë amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Koalicioni për Kosovën e Re, shefja e Grupit Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Përshëndetje për ministrat,

Duke marrë parasysh se ministri e prezantoi Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimin e navigacionit ajror, me keqardhje themi se ky projektligj është dashur të kalojë ndoshta herën e parë kur ka kaluar në Kuvendin e Kosovës dhe në Komisionin Parlamentar atëherë u tërhoq nga Qeveria. Arsyet kanë qenë të njohura, çështja e drejtorit, mirëpo esenca është që ne ta kemi këtë ligj për arsye të shfrytëzimit të hapësirës së lartë ajrore.

Esenca është diku tjetër, ndërsa çështja e vendosjes së drejtorëve siç u theksua edhe nga LDK-ja duhet ndoshta të rregullohet gjatë amendamentimit të projektligjit.

Koalicioni për Kosovë të Re e ka shqyrtuar projektligjin. Duke marrë parasysh se ne e kemi pasur edhe një herë këtë projektligj dhe si pengesë e mosrealizimit të këtij projektligji apo mosmiratimit të këtij projektligji e kemi Raportin e Progresit, i cili e thekson dhe njëkohësisht ky projektligj është edhe në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, besojmë që gjatë amendamentimit të projektligjit brenda Komisionit Parlamentar ne do t’ia japim mundësinë që të bëjmë disa ndryshime, ku do të thjeshtësohet ndoshta edhe përzgjedhja e drejtorëve dhe disa lëshime tjera, mirëpo në

parim Koalicioni për Kosovë të Re i jep përkrahje dhe shpresojmë, ministër, që shumë shpejt ky ligj të kalojë edhe në leximin e dytë brenda Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6 +”, Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Başkan.

6+ Parlamentar gurubu da Havacılık Ulaşım Ajansının kurulmasını öngören Yasa Tasarısını inceledi ve Kosova açısından bunun düzenlenmesinin gerektiği kanısındayız. Bu Yasa Tasarısını desteklemekteyiz. Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hashim Deshishku e ka fjalën.

HASHIM DESHISHKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Ligji për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit i takon spektrit të ligjeve, nëpërmjet të cilave bëhet kompletimi i institucioneve me përgjegjësi për funksionimin e shtetit dhe për sigurinë e qytetarëve.

Pra, si i tillë, ai duhet të miratohet dhe të krijohen kushtet për themelimin e kësaj agjencie të rëndësishme, si për vendin, por edhe për funksionimin e hapësirës së lirë ajrore. Mirëpo, ka disa mangësi, të cilat më shumë reflektojnë në funksionimin e agjencisë, sesa në rëndësinë dhe në kompetencat e saj.

Fillimisht, mua më duhet t’i bëj disa pyetje, të cilat kanë të bëjnë me disa parakushte për miratimin dhe zbatimin e këtij ligji:

1. A janë riformuluar 4 nene, për të cilat ka vërejtjeje Ministria e Integritetit, e që kanë të bëjnë me përputhshmërinë me legjislacionin evropian dhe
2. A janë siguruar paratë për funksionimin e Agjencisë, meqenëse deri në vitin 2016 asaj i duhen 21,7 milionë, kurse 6,4 milionë euro në vitin 2014.

Ndërkaq në tabelat buxhetore nuk kam mundur të gjej se diku janë të rezervuara këto para. Ndërkaq vërejtjeje kam edhe rreth disa formulimeve dhe zgjedhjeve konkrete që ofron projektligji. Neni 2 precizon se ligji zbatohet për çdo avion që qarkullon në territorin e hapësirën ajrore të Kosovës, ndërkaq në nenet e tjera apo te përkufizimet askund nuk flitet se deri ku shtrihet hapësira ajrore e Kosovës. domethënë ne nuk e dimë ende nëpërmjet këtij ligji se cila është hapësira ajrore e Kosovës dhe deri në cilin vend përkufizohet.

Ne nenin 6 rregullohet mënyra e përzgjedhjes së drejtorit. Pika e dytë e këtij neni thotë se Komisioni Ndërmnistror i udhëheq krejt procedurat, derisa emërimin e drejtorit e bën kryeministri. Fillimisht, pse ky emërim nuk bëhet me vendim të Qeverisë, por me vendim individual të kryeministrit.

E dyta, në Komisionin Ndërmnistror nuk vërehet se ka shumë punë për seleksionimin, përkatësisht për përzgjedhjen e kandidatëve që i plotësojnë kushtet për emërim. Ai e

kompleton dokumentacionin dhe ai ia dorëzon kryeministrit, kurse ai e bën përzgjedhjen. Njësoj vlen edhe për zëvendës drejtorin, për të cilin parashihet e njëjta procedurë e emërimit.

Nën d - kompensimi. Pika 3 e po këtij ligji insiston që paga e drejtorit të agjencisë të mos jetë më e ulët se paga e drejtorit të Kontrollit Ajror të Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari”. Pse paga e këtij duhet të lidhet me atë të një drejtorit të një subjekti tjetër, i cili përgjegjësitë i ka më të vogla se ato që i ka Agjencia për navigacion. Unë insisto që paga e drejtorit të lidhet me përgjegjësi, me performansën dhe potencialin financiar të agjencisë.

Nën e, mandati i drejtorit në këtë ligj - duhet që ai të lajmërohet për një periudhë pesëvjeçare, mirëpo do të mund t’i zgjatet mandati edhe për një periudhë shtesë, por jo më shumë se dy vjet. Pra, gati edhe një gjysmë mandati. Zgjatja e mandatit të drejtorit - pse duhet të ketë mandat shtesë. Madje, sipas ligjit, as nuk dihet se në cilat rrethana atij i zgjatet mandati. Kjo është e palogjikshme dhe e panevojshme. Propozoj që atij t’i ofrohet mundësia për rizgjedhje edhe për një mandat. Ndërkaq në rrethana emergjente, mund të zgjidhet ushtrues i detyrës, por jo më gjatë se 6 muaj.

Neni 12 - thuhet se të hyrat e agjencisë përbëhen nga taksat e shfrytëzuesit dhe nga donacionet. Pra, askund nuk përmendet financimi nga buxheti. Ndërsa Ministria e Financave i identifikon implikimet e mëdha buxhetore. Kjo çështje duhet të sqarohet, madje edhe të parashihet mundësia e intervenimit me para, nëse agjencia nuk arrin të sigurojë buxhet të mjaftueshëm nëpërmjet burimeve të cekura më lartë.

Neni 24 - aspektet e punësimit dhe ato sociale - ndër të tjera thuhet se çfarëdo veprimi i personelit të agjencisë, siç janë grevat dhe praktikat asimiluese që mund ta rrezikojnë jetën, sigurinë personale apo shëndetin e personave, janë të ndaluara. Krejt është në rregull kur është në pyetje funksionimi i agjencisë dhe siguria për njerëzit. Mirëpo, punëtorëve nuk mund t’u mohohet një e drejtë e garantuar, ajo për greva, prandaj propozoj që të bëhet një riformulim kur lejohet mundësia për grevë, mirëpo paraprakisht organizatori i saj, në këtë rast sindikata, duhet të garantojë se gjatë kohës së grevës nuk do të rrezikohet funksionimi i agjencisë, kurse greva do të mbahet në ambientet ku nuk pengohet procesi i punës. Faleminderit!

KRYESUESI: Ministër, e do fjalën? Urdhëro!

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Unë do të përpiqem të jap disa sqarime të shkurtra, që besoj se do të mund t’i ndihmojnë deputetët e Komisionit Funkcional, në rend të parë, por edhe të gjithë profesionistët që dëshirojnë të kyçen, ta japin kontribut që ky ligj të jetë sa më i zbatueshëm dhe sa më funksional.

Disa nga elementet e diskutimit që u ngritën këtu: e para dua të sigurojmë që ligji është në përputhje me Kushtetutën dhe do t'i rregullojë çështjet praktike të zbatimit të këtyre çështjeve që i rregullon përbrenda.

E dyta, hapësira e lartë ajrore, të nderuar deputetë, kam nevojë t'i sqaroj disa gjëra, është kompetencë e NATO-s dhe është mirë që është kompetencë e saj deri tani. Hapësira e lartë ajrore është në diskutim që disa muaj dhe ndoshta me vite, se kur duhet të kalojë në menaxhim të një institucioni tjetër, që do t'i përgatiste institucionet e Kosovës për ta marrë kontrollin e plotë ajror, dhe ka pasur një diskutim bukur të gjerë dhe sipas informacioneve që ne mund t'i kemi, që nuk është e thënë t'i kemi të gjitha ato, që janë kompetencë e Këshillit të NATO-s, ka pasur konkurrim për ta bërë këtë shërbim edhe nga vendet e rajonit dhe nga vendet fqinja, dhe natyrisht që në një konkurrencë të tillë është përzgjedhur varianti më i mirë për Kosovën, ai është që të jetë kontrolluese e hapësirës së lartë ajrore për një kohë kalimtare, një vend që është anëtar i NATO-s dhe anëtar i BE-së dhe jo vend fqinj, që nuk ka kompetenca dhe kapacitete për të ushtruar këtë kontroll në Kosovë.

Mendoj se kjo është mirë dhe autoritetet e Kosovës këtë përgjegjësi do ta marrin pas një afati kalimtar, përkatësisht në përgatitjen e plotë profesionale.

Çështjet tjera që janë më tepër ndoshta teknike, por që mund t'ju ndihmojnë juve në amendamentim, nëse flitni pse duhet ta njohin njerëzit gjuhën angleze në këtë shërbim, keni parasysh se bëhet fjalë për një shërbim të sigurisë së lartë dhe natyrisht që avionët që vijnë në Aeroportin e Prishtinës do t'i ishte mirë t'i kishin pilotët shqiptarë, por në fakt nuk janë, prandaj duhet të jetë komunikim i rrjedhshëm në anglisht, është standard ndërkombëtar dhe duhet t'i përmbahemi kësaj pune.

Çështjet tjera që kanë të bëjnë me atë pse nuk definohet tërësia e Kosovës, se ku do të operojnë avionët e hapësirës së lartë ajrore, kjo është çështje e rregulluar me Kushtetutë. Tërësia tokësore dhe ajrore e Kosovës respektohen dhe kjo është ajo që dua të them.

Prandaj, edhe një herë po them, këto çështje që i keni ngrehur dhe çështjet e tjera që mund t'i ngrehni në debatin mëtutjeshëm në Komisionin Funksional janë shumë të mirëpritura nga ne dhe presim që ligji të jetë funksional dhe i zbatueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Visar Ymeri, replikë? Urdhëro, shkurt!

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Për çështjen e Kushtetutës, unë e lexova tekstin që e thotë neni i saj dhe mendoj që kjo përgjigjja e ministrit nuk është e mjaftueshme. Të thuhet vetëm se 'është në përputhje', ky është një interpretim arbitrar. Të paktën një argument të na japë si është në përputhje, sepse unë nuk po konstatoj, po pyes, e pyeta edhe herën e parë. Dhe sa i përket hapësirës ajrore, konsideroj që me gjithë ato që i tha, nuk po pajtohem, por të mos hyjmë në debat, pyeta ta di nëse e di Qeveria e Kosovës se çfarë përfitimi do të ketë Kosova nga ky menaxhim që do t'ia bëjë Hungaria kësaj hapësire, sepse e dimë që aty ka taksa.

Pra, a do të kemi përfitime dhe, e dyta - sa është afati? Çka është përkohshmëria, sepse këtu po flasim për sovranitet, ministër. Pra, ta dimë që në këtë hapësirë ajrore deri kur Kosova nuk do ta ketë sovranitetin dhe do ta ketë një shtet tjetër ushtrimin e së drejtës sovrane përmbi të?

MINISTRI FEHMI MUJOTA: Unë besoj se isha i qartë, por megjithatë po e përsëris edhe një herë, po e them që ligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me sovranitetin e Kosovës.

E dyta, ajo që është e rëndësishme - afati kalimtar varet ndoshta nga shpejtësia e aftësimit të njerëzve tanë për ta marrë këtë kontroll, por ajo mund të jetë ndoshta deri në 5 vjet, nëse kuadrot tona nuk janë të përgatitura për ta marrë kontrollin, por është mirë që varet nga kapacitetet tona dhe të hyrat për Kosovën shtohen, sepse të gjitha fluturimet komerciale në hapësirën e lartë ajrore mbi 9 kilometra do të kenë gjenerim të të hyrave për Buxhetin e Kosovës, përkatësisht për këtë shërbim dhe unë e thashë edhe në fjalën time hyrëse që ne pretendojmë që 100% të jetë i vetëfinancuar kjo agjenci.

KRYESUESI: Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, kryesues!

Po mendoj që për shkak të korrektësisë, meqenëse pas fjalës së ministri pati prapë deputetë për herë të dytë që e morën fjalën, në çdo rast komisioni e ka mundësinë të ketë, përveç tjerash, edhe dëgjim publik, ku e kemi pasur ministrin dhe përfaqësues të këtij shërbimi, por edhe të tjerë të interesuar, që t'i bëjnë publike të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë projektligj. Po ashtu, edhe çështja e Kushtetutës, është komisioni, i cili herë pas here na jap vërejtje, nëse jemi në kundërshtim me Kushtetutën.

Unë mendoj që është koha ta votojmë dhe ta japim kontributin në komision, në grupe punuese dhe të shkojmë më tutje, meqenëse ky projektligj, po e them edhe një herë, po ashtu edhe një kërkesë tjetër nga dialogu për MSA-në, dhe duhet ta përshpejtojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë të paraqitur për diskutim nuk ka, por më lejoni t'i them dy-tri fjalë instruktive për këtë mënyrë të diskutimit të ligjeve dhe të projektligjeve.

Klisheja, grupi ynë parlamentar, që e thotë secili e ka studiuar, kjo është një klishe. Nga diskutimet edhe këtu, edhe kësaj radhe, edhe herëve tjera, u pa që nuk është ashtu. Dhe, unë po jua lexoj përfundimin për këtë ligj, nuk dua të hyj në ligj, të departamentit të buxhetit. Po ta kishin lexuar deputetët, edhe grupet, do ta bisedonin pak më arsyeshëm, më ndryshe këtë përfundim: tregohet sa duhet shuma, sa është implikimi buxhetor, tregohet që kjo ka të bëjë me shumë që nuk ekziston, sepse në projektet buxhetore prej '14-'16 nuk ka asnjë cent për këtë punë dhe në fund buxheti vetë thotë: Në rast se ky projektligj kalon, e ka këtë kosto shtesë. 'Në rast se', me një pikëpyetje.

Buxheti është prapë pjesë e Qeverisë, nuk është prej diku tjetër. Por, unë po e ndal diskutimin këtu, po kaloj në tjetrin. Meqë ky është një ligj që kërkohet në procesin e

stabilizim-asociimit, dhe unë e di që kërkohet, meqenëse të gjitha grupet thonë ‘po krahagjerë do ta votojmë, se po kërkohet’, atëherë bëjini fjalët vepra zotërinj të grupeve. Sa herë po duhet të ju thërras të vini këtu për ta votuar këtë ligj? Po, ju atëherë fjalët e veprat i keni dy kanale. Merreni vetë, regjistrojeni, këqyreni substancën. Për ta dhënë një deklaratë politike në Kuvend duhet bërë substancë, votë. Atëherë regjistrohuni vetë, shiheni sa jeni, shiheni të cilave grupeve jeni dhe ju lutem shumë të mos ia bëjmë në stilin ‘fjalët e mëdha, puna qysh të vjen’. Ky është Kuvend, këtu vendoset sot.

Atëherë kemi deklarata tjera, përkushtimi është tjetër, disiplina parlamentare është tjetër. Ju lutem, ma jep numrin! A është gati regjia që ta votojë Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror?

Tash në bankat e Parlamentit janë të pranishëm 73 deputetë. Votojmë tash!

Konstatoj se me 60 vota janë për, 9 abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent

Vetëm para kësaj, ta bëjmë një kontratë të fjalës: a doni t’ju jap pushim e të ktheheni me kohë, apo doni të vazhdojmë. Shefat e grupeve, a doni vazhdim? LDK, çfarë doni ju? Se ju edhe ashtu më të disiplinuarit jeni brenda. A doni pushim, apo të vazhdojmë? Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit për komplimentin nënkryetar!

Grupi Parlamentar i LDK-së mendon se është më rationale nëse e marrim pushimin tash edhe kthehemi me kohë, sepse deputetë të veçantë po ikin dhe pastaj nuk po kemi kuorum për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: PDK-ja, e marrim pushimin drekës, apo vazhdojmë edhe pak? Ilmi Reçica e ka fjalën.

ILMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Realisht, po më duket që udhëheqja e kësaj seance është pak e njëanshme dhe këtë e vlerësojnë të tjerët. Dëgjomë, më fal, unë po flas! Nuk është që Ju ose deputeti Gashi ta vlerësoni se kush është i disiplinuar ose kush nuk është. Po shihet që ka mungesë të deputetëve të të gjitha grupeve dhe unë propozoj që të shkojmë në pushim të drekës.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë e ftoj regjinë - ju lutem prania e deputetëve, regjistrohuni kush është brenda tash për informatë! Dhe ma sillni listën këtu, unë e deponoj dhe nuk dua të komentoj asgjë. A doni ta vazhdojmë, tash është pyetja, a apo të shkojmë për drekë. Unë për këtë ju pyeta. “Vetëvendosje”, zoti Ymeri!

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Edhe ne jemi dakord që ta marrim pauzën e drekës tash, e të kthehemi me kohë përsëri.

KRYESUESI: Suzan Novobërdaliu, urdhëro!

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, nënkryetar!
Edhe ne propozojmë që të shkojmë në pauzë.

KRYESUESI: “6+”, ka mendim tjetër? Mufera Shinik, urdhëro!

MUFERA SHINIK: Njësoj kryesues, veç është respekt të shkohet me rend. Ne jemi për pauzë deri në orën 14:00, veç 120 deputetë të jenë këtu.

KRYESUESI: 120! Aleanca? SLS-ja? Sasha, doni pushim?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: I mismo za pauzu.

KRYESUESI: Faleminderit! Në orën 15:00 vazhdon seanca.

* **

Vazhdimi i mbledhjes plenare, pas pauzës
Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z.Sabri Hamiti.

KRYESUESI: Kolegë deputetë,
Besoj që mund të vijojmë punën.

Para se të vijojmë, më lejoni që të ritheksoj, se para se të shkonim në pushim unë e bëra, nga pozita e udhëheqësit të seancës, një ndërhyrje që e quajta instruktive, që me fjalë të tjera i binte - thirrje, që të jemi më të disiplinuar në kuptimin institucional, së paku të përpiqemi që të sillemi përafërsisht ashtu si deklarojmë.

Për të mos zgjatur shumë, evidenca mbas kësaj thotë kështu, pra kur u regjistruam si ishim: PDK-ja kishte 13 deputetë; LDK-ja 20; “Vetëvendosja” 8; AAK-ja 6; Grupi “6+” 6; KKP-ja 4; SLS-ja 3; dhe të tjerët ishin deputetë pa grup.

Kjo nuk është evidencë, kështu që nuk do shpjegim dhe nuk ka nevojë për interpretim, sepse faktet janë kokëforta dhe s’interpretohen.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit të paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, e ke fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!
Të nderuar deputetë,

Ligji në fuqi për kujdesin shëndetësor emergjent 02/L-50 i datës 23 shkurt 2006 nuk ka arritur që të zbatohet në tërësi, sepse zgjidhjet ligjore të cilat i përcakton ky ligj nuk kanë qenë pjesë e kornizës gjithëpërfshirëse ligjore për formimin e sistemit shëndetësor.

Kjo ka imponuar nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji në mënyrë që dokumenti i ri ligjor të jetë në pajtim me nevojat e qytetarëve për shërbime cilësore, të koordinuara dhe të shpejta emergjente, të cilat realisht mund të zbatohen dhe të jenë në pajtim me mundësitë financiare të vendit.

Ky synim është në pajtim të plotë edhe me objektivat e Këshillit Ndërmnistror për Integritet Evropian, që si objektiv prioritar në procesin e anëtarësimit të Kosovës në BE, ka paraparë fuqizimin, avancimin dhe zbatimin e legjislacionit për shërbime emergjente mjekësore, duke pasur parasysh dokumentet e dialogut për procesin e stabilizimit dhe asocimit, si dhe raportet e progresit që nga viti 2011.

Me projektligjin që sot gjendet para jush për miratim, përcaktohen kushtet, organizimi dhe mënyra e funksionimit të shërbimit mjekësor emergjent në kuadër të modelit të shërbimeve të integruara shëndetësore, që paraqesin thelbin e reformës së sistemit shëndetësor të vendit.

Shërbimi mjekësor emergjent organizohet me këtë projektligj si fushë e veçantë e veprimtarisë shëndetësore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve emergjente pa ndërprerje për qytetarët, të cilëve për shkak të sëmundjes apo lëndimit u është rrezikuar drejtpërsëdrejti jeta, organi i caktuar, apo pjesë të caktuara të trupit, respektivisht shkurtimit të kohës optimale nga ndodhja e rastit emergjent deri në fillimin e procesit të trajtimit përfundimtar.

Shërbimet mjekësore emergjente në bazë të këtij projektligji, do të zbatohen në mjediset paraspitalore dhe spitalore. Ato do të ofrohen në sektorin publik, privat dhe publiko-privat, në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor: parësor, dytësor dhe tretësor, në pajtim me Ligjin për shëndetësi.

Projektligji rregullon parimet e shërbimeve mjekësore emergjente si standarde dizajnuese, strukturën e reagimit të integruar, qasjen ekipore, përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, caktimin e prioritetëve, ndarjen e resurseve sipas nevojës, sigurimin e kompetencës së koordinuar, protokollit dhe trajtimit të integruar, kosto-efektivitetin, mbikëqyrjen mjekësore, matjen dhe raportimin e indikatorëve të performancës, grumbullimin elektronik të të dhënave, gatishmërinë për fatkeqësi dhe reagimin e gjithëmbarshtëm, planifikimin e vazhdueshëm, sigurinë e reaguesve dhe të pacientëve, si dhe angazhimin dhe përfshirjen e komunitetit në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Projektligji në veçanti adreson organizimin dhe administrimin e shërbimit profesional traumatologjik, si shërbim jetik që zbatohet në kuadër dhe nën udhëheqjen e Klinikës Emergjente dhe Traumatologjike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, në të tri nivelet e definuara të reagimit ndaj traumës.

Projektligji i ka 44 nene, me të cilat përveç organizimit dhe administrimit të shërbimeve dhe parimeve të tij udhëzuese, rregullon edhe funksionimin e shërbimit traumatologjik, si shërbim profesional të linjës, detyrat e shërbimit të mjekësisë emergjente, aftësimin e vazhdueshëm të kuadrit profesional, mjetet e transportit dhe pajisjet teknike, dokumentacionin unik, këshillin profesional të shërbimeve mjekësore emergjente, financimin, mbikëqyrjen e tij, si dhe dispozitat ndëshkimore në rast të moszbatimit të ligjit.

Miratimi i Ligjit për kujdesin shëndetësor emergjent është i domosdoshëm për t'i përcaktuar kushtet e zhvillimit, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor emergjent në Republikën e Kosovës, si pjesë e sistemit të reformuar të shëndetësisë, të cilin po e ndërtojmë dhe si kusht të patjetërsueshëm për ofrimin e ndihmës emergjente në minutat e artë, në mjedise paraspitalore dhe spitalore, duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të pacientëve, zgjatjen dhe ngritjen e kualitetit të jetës, zvogëlimin e shkallës së invaliditetit, përmirësimin e aftësisë individuale për punë dhe uljen e kostos së shërbimeve shëndetësore dhe sociale në funksion të dobisë së përgjithshme shoqërore.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë e miratimit të këtij projektligji, unë ju ftoj që ta mbështetni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Tash e hap debatin për diskutim në parim të këtij projektligji. Fjalën e merr i pari kryetari i Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2014, shqyrtoi në parim Projektligjin për shërbim mjekësor emergjent.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit vlerësoi se projektligji plotëson kushtet e parapara me nenin 54 Rregullores së Kuvendit dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryetar i Komisionit, zoti Damka. Tash shefat ose përfaqësuesit e grupimeve politike në Kuvend. Për Partinë Demokratike të Kosovës, fjalën e merr zonja Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për shërbimin mjekësor emergjent organizohet si fushë e veçantë e veprimtarisë shëndetësore dhe deri më tani sistemi shëndetësor i shërbimeve emergjente nuk ka një rrjet të konsoliduar të këtyre shërbimeve.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent dhe përkundër disa vërejtjeve që i kemi në hartimin e tij, ne do ta votojmë në parim këtë projektligj, por do të punojmë shumë në komision gjatë fazës së amendamentimit, në mënyrë që projektligji të jetë i zbatueshëm në praktikë.

Disa nga këto vërejtje janë:

- Në nenin 2 të këtij projektligji, ku flitet për fushën e zbatimit, thuhet: “Shërbimi mjekësor emergjent zbatohet në rrafshin spitalor dhe paraspitalor”, do të duhej të ishte: “Shërbimi mjekësor emergjent zbatohet në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor: parësor, dytësor dhe tretësor.”, ashtu siç e ceku edhe ministri tash;

- Më vonë, në nenin 5 thuhet: “Shërbimi mjekësor emergjent organizohet në kuadër të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrës së Mjekësisë Urgjente, Spitalit të Përgjithshëm dhe Klinikës Emergjente Traumatologjike”.

Pra, neni 2 dhe 5 duhet të harmonizohen, sepse bien ndesh njëri me tjetrin. Gjithashtu, nuk është sqaruar se deri në krijimin e qendrave të mjekësisë urgjente, si do të funksionojnë këto shërbime, kur dihet se Qendra e Mjekësisë Urgjente deri më tani funksionon vetëm në Prishtinë jo edhe në qytetet tjera.

Prandaj, ka nevojë të sqarohet edhe kushtet e krijimit të këtyre qendrave, çfarë do të merret për bazë, a do të formohen këto qendra në bazë të numrit të banorëve dhe nëse po, si do të organizohen këto shërbime në vendet ku nuk do të ketë qendra të mjekësisë urgjente?

Gjithashtu, fjala “KET” (Klinika Emergjente Traumatologjike), e cila gjendet në nenin 23, 24 dhe 25, mungon te përkufizimet e projektligjit.

Pra, edhe një herë them se duke pasur parasysh faktin që shërbimi mjekësor emergjent është fushë e veçantë e organizimit shëndetësor, në projektligj ka mjaft paqartësi dhe mosharmonizim të neneve, por besoj se gjatë punës në komision dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë do ta amendamentojmë këtë projektligj, që të jetë sa më funksional, sepse është shumë me rëndësi dhënia e ndihmës së parë në momentin e rrezikimit të jetës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Bahri Thaçi e ka fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Projektligjin për shërbimet mjekësore emergjente.

Ky ligj përcakton kushtet, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të shërbimeve mjekësore emergjente në Republikën e Kosovës, qoftë në kohë paqe apo në gjendje të jashtëzakonshme. Investimet në këtë shërbim, në shikim të parë, nuk gjenerojnë të ardhura, por janë shërbime që shpëtojnë jetë dhe këto shërbime të ofruara në mënyrë profesionale shpëtojnë shumë njerëz nga invaliditeti i përhershëm, që në mënyrë indirekte gjenerojnë shumë të ardhura, sepse imagjinoi sa do t'i kushtonte familjes dhe shoqërisë kujdesi për një person që ka mbetur invalid për shkak të mos ofrimit adekuat të ndihmës mjekësore emergjente.

Ky projektligj obligon ndërlidhje vertikale dhe horizontale të shërbimeve emergjente, qartë përcakton detyrat dhe obligimet e niveleve të ndryshme shëndetësore në Republikën e Kosovës. Pra, detyrat dhe obligimet në nivelin parësor, dytësor dhe tretësor shëndetësor për ofrimin e shërbimeve emergjente shëndetësore. Andaj, Grupi Parlamentar i LDK-së nëpërmjet përfaqësuesve në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, do të angazhohet gjatë amendamentimit të këtij ligji që të kemi një ligj funksional për një resor kaq të ndjeshëm dhe kaq të nevojshëm për popullatën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Faton Topalli, për Grupin e “Vetëvendosjes”.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Jo rrallë përcaktuese për jetën dhe vdekjen e njeriut është shërbimi efikas emergjent. Nuk ka dyshim që në listën e gjatë të problemeve të shumta të shëndetësisë është edhe mungesa e një shërbimi kualitativ emergjent, të organizuar mirë, të koordinuar mirë në rrafshin komunal dhe në rrafshin nacional.

Ky problem, si një sfidë e madhe për sistemin shëndetësor në Kosovë, është adresuar ashtu siç tha edhe ministri, si në dialogun për procesin e stabilizim asocimit, ashtu edhe në Raportin e Progresit të vitit 2011. Një shërbim efikas emergjent me strukturë të organizuar, personel të kualifikuar dhe mjete të nevojshme teknike, mund të luajë një rol të rëndësishëm në uljen e vdekshmërisë dhe invaliditetit të shkaktuar nga gjendjet emergjente mjekësore.

Ligji që kemi para nesh synon mes tjerash, organizimin e shërbimit emergjent në nivel kombëtar dhe lokal, duke krijuar një koncept të përbashkët për shërbimin, standardet e intervenimit, informacionin, informimin, menaxhimin e deri tek kualifikimi i specializuar i punonjësve për shërbimin emergjent.

Ajo që na habit pak dhe na detyron të shtrojmë një pyetje për ministrin është te kostoja shtesë buxhetore për periudhën kohore 2014 - 2016. Kështu, për vitin 2014 është paraparë një kosto shtesë prej 15 500 eurosh, ndërsa në dy vjetët tjera një kosto shtesë prej përafërsisht 8 000 eurosh. Duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimit emergjent për jetën e njeriut, kushtet aktuale jo vetëm sa u përket shërbimeve emergjente, por edhe në përgjithësi në shëndetësi, shtrohet pyetja me të drejtë, a është ky vendi në të cilin Ministria e Shëndetësisë duhet të kursejë mjete?

Jo rrallë, intervenimi me vonesë, përveç që kushton me jetë, në shumë raste është faktor vendimtar nëse dikush do të mbetet invalid apo jo. Invaliditeti, përveç që ka një kosto të madhe të shërimit dhe rehabilitimit, krijon edhe shpenzime shtojcë për riaftësim, integrim dhe përkujdesje sociale gjatë gjithë jetës.

Për një shërbim të shpejtë dhe efektiv e vlen të investohen mjetet e nevojshme, sepse kostoja përfundimtare në rastin e investimeve është në afatgjatë më e ulët. Realizimi i objektivave të parapara me këtë ligj, mendoj që janë të rëndësishme, prandaj ne si grup parlamentar e përkrahim në parim këtë ligj.

Ndërsa, kishim dashur të dimë nga ministri për koston kaq të ulët, cilat janë arsyet pse janë paraparë shpenzimet kaq të ulëta, ndërkohë që fjala është për një shërbim i cili është shumë i rëndësishëm?

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të AAK-së, flet Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, sepse nga organizimi i mirëfilltë i këtij shërbimi varet edhe mirëqenia shëndetësore e popullatës. Me këtë projektligj përcaktohen kushtet, organizimi dhe mënyra e funksionimit të shërbimit shëndetësor emergjent, ofrohen shërbime për qytetarët, të cilëve për shkak të sëmundjes apo lëndimit u është rrezikuar drejtpërdrejt jeta.

Objektivi i parë që ka të bëjë me uljen e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së popullatës, është përmirësimi i shërbimeve mjekësore emergjente, në kushte të paqes dhe gjendje të jashtëzakonshme, ngritjen e kualitetit të shërbimeve mjekësore emergjente.

Shërbimi emergjent është paraqitur si sfidë edhe në Raportin e Progresit. Sistemi shëndetësor emergjent nuk e ka një rrjet të konsoliduar, të integruar të shërbimeve. Ky shërbim nuk gjeneron të ardhura, por shpëton jetë. Pra, më mirë investim në start të shëndetësisë, se sa investim mjaft i kushtueshëm në rehabilitimin e pacientëve që kanë pasur rrezik jete.

Me këtë ligj synohet të arrihet: ulja e vdekshmërisë, sëmundshmërisë, dhe invaliditetit të shkaktuar nga gjendjet emergjente, domosdoshmëri në ngritjen e resurseve humane, trajnimet dhe sigurimi i aparaturave dhe materialit tjetër shpenzues që nevojitet për këtë shërbim.

Shpresojmë se pas miratimit të realizohen të gjitha këto synime, që po parashihihen, sepse vërtet sot të gjithë punëtorët dhe mjekët që punojnë në qendrat emergjente në të gjitha nivelet, po ballafaqohen me vështirësi nga mungesa e barërave dhe materialit harxhues, por edhe mungesa e aparaturave të domosdoshme për efikasitetin në punë. Në ligj janë rregulluar si duhet të jenë të organizuara shërbimet emergjente në QKMF, spitalet rajonale dhe shërbimin mjekësor emergjent në kujdesin tretësor, triazhimi dhe trajtimi i

pacientëve, traumat në të gjitha nivelet duhet të trajtohen sipas protokolleve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, gjë që e bën më efikas këtë shërbim.

Me këtë rregullohet edhe sistemi i referimit, sepse deri sot ka qenë kaos dhe nuk ka ditur ku do të adresohen përgjegjësitë, qoftë nga pacientët apo nga personeli shëndetësor.

Ne si komision dhe unë si përfaqësuese e komisionit, do të mundohemi që gjatë amendamentimit të bëjmë më të mirën, sepse është një shërbim i cili në fakt shpëton jetë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, Jeton Svirca e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shërbimi emergjent mjekësor është pika e parë e kontaktit me shërbimin shëndetësor për shumicën e njerëzve gjatë emergjencave dhe lëndimeve të cilat rrezikojnë jetën dhe shëndetin e individit.

Në botë, shërbimet emergjente kanë zgjeruar detyrat dhe rolin e tyre, duke trajtuar emergjenca mjekësore dhe traumatologjike me aplikimin e teknologjisë klinike bashkëkohore. Zhvillimi i shpejt i teknologjisë mjekësore ka reformuar edhe sistemin e shërbimeve emergjente në botë përmes aplikimit të sistemeve multifunksionale të monitorimit të pacientit, duke mundur kështu menaxhimin e pacientëve në mjedis të pavolitshëm jashtë spitalor.

Natyrisht, kjo qasje kërkon mjete të konsiderueshme financiare. Parimisht, qëllimi kryesor i shërbimit emergjent është ulja e vdekshmërisë, sëmundshmërisë dhe paaftësisë së përkohshme apo të përhershme, si pasojë e gjendjeve emergjente mjekësore përmes ofrimit të ndihmës mjekësore cilësore, qasjeve universale në kohë reale, të gjithë personave që kanë nevojë për kujdesin emergjent.

Prandaj, Ligji për shërbimin mjekësor emergjent është i domosdoshëm për t'i përcaktuar kushtet e zhvillimit, organizimin dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor emergjent në Republikën e Kosovës si kusht i patjetërsueshëm për ofrimin e ndihmës emergjente në minutat e artë, në mjedise paraspitalore dhe spitalore duke synuar ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të pacientëve, zgjatjen dhe ngritjen e kualitetit të jetës, zvogëlimin e shkallës së invaliditetit, përmirësimin e aftësisë individuale për punë dhe uljen e kostos së shërbimeve shëndetësore dhe sociale në funksion të dobisë së përgjithshme shoqërore.

Andaj, Koalicioni për Kosovë të Re është pro miratimit të këtij ligji dhe kontributin e vet do ta japë edhe në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për grupin “6+”, shefja e Grupit, Mufera Shinik e ka fjalën.

MUFERA SHINIK: Acil Sađlık Hizmetleri Yasa Tasarısında bugün mevcut olan bu hizmet alımını yasal çerçevede düzenlenmesini dođru olduđunu görmekteyiz.

Bu Yasa Tasarısında acil sađlık hizmetlerinin sunulması öngöröldüđü gibi, aile hekimliliđi merkezlerinde, hastanelerde ve Traumatoloji kliniklerinde de sunulacaktır.

Hayat kurtarma ađısından önemli olan bu acil sađlık hizmetlerinin düzenli modern dünya standartlarında cihazlarla sunulması gerekliliđine inanmaktayız. Çünkü hastaya ilk müdahale dođru ve zamanında yapılması hayat kurtarmak demektir.

Bu yüzden bu Yasa Tasarısının önemli olduđunu gözönünde bulundurarak, “6+” Parlamenter Gurubu olarak bu Yasa Tasarısını desteklemekteyiz, ek önerilerimizi de fonksiyonal komisyona sunacađız.
Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve, tutje nuk ka. Kalojmë në diskutimet e deputetëve. Fjalën e ka Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar ministër,

Në parim këtë ligj unë e aprovoj dhe është një ligj i cili ka pasur nevojë ta kompletojë kompleksitetin e shërbimeve shëndetësore të Republikës së Kosovës, me disa vërejtje të cilat do të ishin të dobishme të shihen dhe mendoj që gjatë përpilimit të këtij ligji nuk ka pasur shumë impenjim, ndoshta edhe profesional, klinik dhe emergjent, gjatë përpilimit të këtij ligji të një personelit.

Kam vërejtje në përkthim, në disa definicione të cilat nganjëherë shkaktojnë huti dhe po ashtu, përzihen edhe kompetencat strukturale, juridike dhe shërbimeve shëndetësore.

Shërbimi emergjent shëndetësor mendoj në definicion, në preambulën e nenit të parë, duhet të jetë ekskluzivisht në shërbimin publik të Republikës së Kosovës, ndërsa nëse ju ofrohet spitaleve tjera, qoftë publike, private, publiko-private, është se nga si strukturë emergjente ajo bën edhe ofrimin e çdo rasti në institucionet, ku e ka më së afërmi, do të thotë, nëse është kuptuar në atë mënyrë.

Por jo, shërbim emergjent privat nuk mund të ketë, as publiko-privat nuk mund të ketë. Nuk mendoj që është praktikë e qëlluar, se ka shumë shtete që, jo shumë shtete, por po thuajse të gjitha shtetet progresive dhe të cilat cilësinë e shërbimit shëndetësor e kanë në nivel më të lartë.

Mandej, tek personeli, tek përcaktimi i personelit, ndoshta ka mundësi të përmirësohen disa çështje, disa praktika të disa shteteve, kryesisht janë Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Izraeli, komplet e mbulojnë këtë shërbim emergjent me “paramedik” dhe me një mjek të specializuar për menaxhimin e emergjencës mjekësore dhe po ashtu, këto institucione kanë emërtimin si shërbim emergjent dhe traumatologjik nacional.

Ne do të thotë duhet të mendojmë që ta ngritim në një shkallë të përgjegjësisë, për çfarë arsye, sepse kjo është porta e parë në shëndetësi, së bashku me shërbimin primar shëndetësor, për të prevenuar dhe për të transportuar, qoftë ose për të orientuar komplet sistemin e një traume që të jetë traumë e cila është e shkaktuar nga forma të ndryshme ose të jetë një urgjencë e shkaktuar nga format të pa lëndimet vetëm fizike, se këtu kuptohet nganjëherë që vetëm lëndimet fizike, janë edhe helmet e ndryshme, që mund të lëshohen nesër është sistem nacional emergjent.

Mandej, në këtë ligj nuk më ka ra të shoh komunikimin ndërinstitutional, do të thotë, organizimi me ligje të veçanta të tjera dhe nëpër sisteme edhe në ligjet që janë miratua ndoshta mund, ligjet tjera i kanë interpretuar, por kishte qenë mirë t'i interpretojë edhe ky ligj.

Në rastet e jashtëzakonshme, situata e këtij sistemi emergjent si organizohet dhe si komandohet, si bashkëpunohet me policinë, me zjarrfikësit, me ushtrinë dhe të gjitha këto tri sistemet ndihmëse që i përmenda edhe në kushte paqeje kanë të bëjnë me këtë sistem dhe edukimi i stafit policor, zjarrfikësve, tanimë Ushtria e Kosovës e ka të ushtruar për menaxhimin e këtyre problemeve, duhet të paraqiten në ligj dhe ne duhet t'i shohim gjatë amendamentimit, t'i kemi parasysh.

Një diçka tjetër e cila do të ishte shumë e mirë për vlerësimin periodik të sistemit emergjent në Kosovë, duke filluar nga sistemi alarmues dhe duke krijuar edhe sisteme emetuese të katastrofave të ndryshme, qoftë nga vërshimet, djegiet, tërmetet, helmimet, të bëhen periodike, ligjore, të domosdoshme për institucionet që edhe stafi merr njëlloj vlerësimi a është në gjendje t'i menaxhojë këto situata, së bashku me problemin multidisiplinar që fola pak më parë, por në këtë mënyrë edhe mund t'i shohë edhe kapacitetet e veta dhe t'i evidentojë edhe mangësitë të cilat gjatë kësaj pune do t'i ketë.

Në përgjithësi ky ligj është i nevojshëm për personelin, i cili është i involvuar. Kategorizimi i personelit duhet të shihet me një prioritet të lartë. Unë personalisht kam vërejtje shumë serioze në kompensimin material që i bëhet mjekëve në sistemet emergjente të Republikës së Kosovës, duke filluar nga Qendra Klinike Universitare e me radhë.

Ata kanë një ngarkesë të stërngarkuar përkundër kushteve të vështira, që punojnë dhe stimulimi i pagës nuk është humane që të lihen me një pagë të tillë, po duhet të shihen me një kategorizim tjetër, siç do ta shohim edhe në Ligjin për fondin e sigurimeve ose të nxirren që të mos jenë punonjës civilë dhe të kategorizohen me stërngarkim të punëve, sepse kërkesa e tyre është që të kenë një stimulim edhe financiar edhe kategorizim më të lartë për t'u paguar dhe po ashtu, edhe në spitalet regjionale dhe ambulancat, ku janë momentalisht duke shërbyer mjekët e shërbimit emergjent në Republikën e Kosovës.

Mendoj që përfundimisht do ta përkrah, do të mundohem të jem konstruktiv gjatë amendamentimit me vërejtje të cilat i pashtë dhe të cilat do të mundohemi që duke u bazuar në standardet që i kanë shtetet e zhvilluara dhe shtetet në zhvillim të jem konstruktiv gjatë amendamentimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr Nazane Breca.

NAZANE BRECA: I nderuar kryesues,
Ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky projektligj është i rëndësishëm sepse trajton një çështje shumë të rëndësishme, pra shërbimin emergjent dhe urgjent, mirëpo unë i kam disa vërejtje të cilat do t'i paraqes dhe besoj se do të merren parasysh edhe gjatë punimit në komision.

Së pari do të filloj me nenin 3 të përkufizimet, ku jepet një përkufizim paksa i hutuar në lidhje me mjekun e urgjencës, ndoshta, mjafton të thuhet vetëm që mjeku i urgjencës është mjek i licencuar dhe në këtë mënyrë do të përputhet me ligjin nr. 04/L-125 dhe pikat 1.11, 1.12 dhe 1.13. Pra, e kemi në ligjin bazë përkufizimin dhe ndoshta nuk ka nevojë për ta zgjeruar edhe për të shkaktuar huti.

Në pikën 1.7 kemi: “mjeku specialist i emergjencës nënkupton mjekun, i cili ka kryer specializimin nga mjekësia emergjente dhe është licencuar” thuhet “nga Ministria e Shëndetësisë”. Mirëpo, në ligjin nr. 04/L-125 në nenin 9 shumë mirë i përkufizon kompetencat publike të odave, kështu që këtu duhet të jetë që është i licencuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, sepse tash e kemi edhe këtë Ligjin e profesionistëve shëndetësorë dhe besoj që duhet të përputhet edhe me këtë ligj.

Në pikën 1.22 Qendra e Mjekësisë Urgjente nënkupton institucionin shëndetësor të kujdesit parësor, por kjo është pjesë e Qendrës kryesore të mjekësisë familjare, ndërsa në vendbanimet ku ka mbi 100 mijë banorë, atëherë ajo mund të jetë edhe Qendër e mjekësisë urgjente, por kjo është pjesë e Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare, andaj duhet të thuhet, jo institucion shëndetësor të kujdesit parësor, por pjesë e Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare.

Në nenin 5, thuhet: “Shërbimi i Mjekësisë Emergjente” por, duhet të shtohet edhe “urgjente”, “organizohet në këto tri pikat” dhe aty ku është “emergjent”, para saj duhet të shtohet fjala “urgjent”, sepse në kujdesin parësor shëndetësor kemi mjekësi urgjente, ndërsa në kujdesin dytësor dhe tretësor kemi mjekësi emergjente, pra, kemi qendrat urgjente dhe qendrat emergjente.

Në nenin 6, 15 dhe 17 prapë para fjalës “emergjent” duhet të thuhet “urgjent”, sepse kemi të bëjmë edhe me shërbimin urgjent edhe me shërbimin emergjent.

Në nenin 7, veprimtaria e shërbimit mjekësor emergjent parësor, pra tek pika 1 e nenit 7 duhet të jetë: “veprimtaria themelore e shërbimit mjekësor urgjent parësor përfshin” dhe mandej vazhdon më tutje.

Në nenin 23, ku kemi të bëjmë me aftësimin, pika 3 e këtij neni duhet të jetë: “edukimi i vazhdueshëm mjekësor”. Pra, sipas ligjit të ri duhet edhe këtu të përputhet me ligjin e ri, në vend të zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe duhet të thuhet, se programi pra,

organizohet prej Odës së Mjekëve të Kosovës, edhe këtu jo prej Ministrisë së Shëndetësisë.

Në nenin 24, prapë kemi: duhet të jetë në pikën 1, “edukimi i vazhdueshëm mjekësor, sipas ligjit të ri të infermierëve për punë në shërbimin mjekësor emergjent realizohet përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe sipas planit dhe programit të përcaktuar nga Oda e infermierëve dhe teknikëve të tjerë të Kosovës”.

Këto ishin disa vërejtje po gjithsesi, këto dhe vërejtjet tjera unë do t’i paraqes edhe gjatë punës në komision, që të dalë një ligj sa më i mirë për arsye se trajton një çështje shumë të rëndësishme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kjo fundi yt është shumë instruktiv, domethënë ky është diskutim në parim. Të gjitha diskutimet tjera nëse s’i bëni amendamente, mbeten dëshira të mira për ta kënaqur shpirtin, po s’bëhen ligj, prandaj keni kujdes kur amendamentohet. Aurora Bakalli e ka fjalën.

AURORA BAKALLI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Projektligji për shërbimin emergjent mjekësor do ta zëvendësojë Ligjin për kujdesin shëndetësor emergjent.

Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent do ta perceptoja personalisht si shumë të rëndësishëm, po që se do të parashihte investime shtesë apo buxhet të caktuar shtesë për këtë sektor.

Deklarata financiare e cila është e bashkëngjitur këtu, tregon se ka investime shtesë, mirëpo janë diku rreth 15 000 euro në vit, gjë që mendoj se është e pamjaftueshme për të rregulluar gjendjen se çfarë është në shërbimet emergjente, të cilat ofrohen në Kosovë.

Vetë Klinika e Shërbimeve Emergjente apo Qendra Emergjente në QKUK është sigurisht pjesa më e frekuentuar në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Mirëpo, kjo qendër punon në kushte shumë të rënda, duke filluar nga hapësira e cila gjithsesi nuk është as e mjaftueshme e as adekuate për një qendër emergjente terciare, për të mos përmendur pastaj aparaturën krejtësisht modeste, si dhe mungesën e madhe të barërave dhe materialit shpenzues, me të cilën përballen stafi që punon aty.

Prandaj, nëse nuk parashihet një fond shtesë për Qendrën Emergjente të QKUK-së, por edhe të niveleve tjera, atëherë e shoh të zorshme përmirësimin në këtë branshë shumë të rëndësishme të shëndetësisë, sidomos për popullatën.

Sa i përket vërejtjeve tjera, konsideroj se Qendra Emergjente apo Klinika Emergjente Traumatologjike, siç po emërtohet në këtë ligj, kishte qenë mirë t’i ketë edhe disa shtretër për qëndrim 24 orësh, sepse disa patologji, gjithnjë duke u bazuar në protokollet klinike, nevojitet monitorim diagnostiko 24-orësh, për t’u dhënë diagnoza e saktë. Në situatën

aktuale një gjë e tillë mungon, prandaj edhe për disa patologji mund të ndodhin lëshime eventuale në mungesë të monitorimit 24-orësh të pacientit.

Një gjë e tillë e propozoj edhe për shërbimet emergjente në spitalet rajonale dhe rekomandoj që të inkorporohet në këtë ligj.

Qendra Emergjente ka nevojë edhe për pajisje bashkëkohore diagnostiko dhe laboratorike. Aktualisht, ajo ka një laborator mjaft modest, në të cilin nuk kanë mundësi të punohen edhe disa prej analizave laboratorike të domosdoshme për sëmundjet akute të cilat kërkojnë trajtim emergjent.

Do të jap si shembull ‘troponinen’, e cila është e paraparë edhe me protokollet klinike për infarkt akut të zemrës, të cilat janë punuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe kjo analizë asnjëherë nuk është punuar as në laboratorin emergjent apo në laboratorin e biokimisë të QKUK-së, por është kërkuar vazhdimisht nga pacientët që të dërgojnë gjakun në laboratorët privatë për të marrë rezultatin e kësaj analize.

Në anën tjetër, pajtohem me parafolësin Muja, i cili kërkon një stimulim financiar shtesë për punëtorët shëndetësorë të Qendrës Emergjente, sepse këta përballen me një natyrë shumë të rëndë të punës e cila përpos tjerash është edhe me shumë stres.

Në anën tjetër, duke qenë një shërbim i cili parashihet që të kryhet vetëm në sektorin publik, nuk e kanë mundësinë që të inkuadrohen apo të bëjnë punë shtesë në sistemin privat shëndetësor.

Ndërsa, ndër vërejtjet tjera janë tek përkufizimet, në disa vende, siç është për shembull edhe pika 1.13, në vend të fjalës “emergjencë” është shkruar fjala “urgjencë”, ndërkohë që në variantin në gjuhën angleze, është e shkruar si “emergency” kështu që duhet të sqarohet se a është fjala për “emergjencë” apo “urgjencë”.

Vërejtje tjetër imja është termi “parahospitalor”. T’ju them të drejtën, ky term në ligjin tjetër të cilin e kemi, pra atë për sigurime shëndetësore, është ekuivalent me jashtë hospitalor, dhe po të mos e kisha lexuar në variantin anglisht, nuk do ta dija për çka është fjala. Fjala është për “outpatient” apo shërbime ambulatorie dhe si të tilla i përdorin gjithmonë në zhargonin e përditshëm, prandaj, propozoj që e tillë të jetë edhe në ligjin të cilin e kemi para vetes.

Këto janë disa nga vërejtjet e mia. Në parim, ne dy deputetët e Lëvizjes për Bashkim do ta votojmë për këtë projektligj. Faleminderit për vëmendjen!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Emilija Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem predsedavajući!

Poštovani kolege poslanci,

U potpunosti podržavan nacrt zakona o emergentnom zdravstvenoj službi, koja je u ovom momentu potrebna našem društvu, a ja ću akcenat dati na teritoriju opštine Prizren,

odnosno župska regija sa centrom u Rečanu, koja obuhvata 15 okolnih sela, odnosno više od 20 hiljade stanovnika.

Uzimajući u obzir geografsku lokaciju te teritorije, ali i veliku udaljenost od bolničkog centra u Prizrenu sa jednim familjarnim centrom medicine koji radi samo sa jednim doktorom opšte prakse i jednim stomatologom i to samo prvu smenu, od ponedeljka do petka, gde meštani ne smeju biti bolesni preko vikenda, jer je zatvoren centar, u kome gravitiraju seoske ambulante, gde takođe neredovni dolazak lekara dominantan već 14 godina posle rata.

Pa i sam ministar zdravlja gospodin Ferid Agani na licu mesta video tu problematiku. Ali i pored stanja političkog pritiska na lokalnu i centralnu vlast, taj zdravstveni centar jako loše funkcioniše. Takođe sa ovim problemom suočavaju se i meštani sela Restelice u opštini Dragaš, koji su više nego diskriminisani po pitanju pružanja medicinske pomoći za svaku vrstu usluge moraju putovati nekoliko kilometara da bi došli do bolnice ili ambulante u opštini Dragaš.

Svi smo svedoci Resetličke tragedije, koja je zbog nepristupačnosti terena odnela mnoge živote. S obzirom da je ovaj nacrt zakona obuhvata modernu medicinsku službu koja će biti opremljena sistemom koji među ostalom podrazumeva i vazдушnu ambulantu, potrebnu za nepristupačno područje, odnosno pružanje medicinske pomoći bolesnicima, koji su fizički ili psički nesposobni. Nama je upravo to i potrebna, da lekar u tim emergentnom službe može na licu mesta da obavi kontrolu, zatim dijagnostičke procedure, definiše i primenjuje terapiju prema protokolu i kordinira radom medicinskog osoblja, što nam upravo govori da je zadatak upravo te službe da pacijent u celokupnu medicinsku pomoć i tim se transportuje sa mesta intervencije u odgovarajuću zdravstvenu ustanovu. Takođe, ovaj nacrt zakona obuhvata i planira povećanje ljudskih resursa na lokalnom nivou, što će omogućiti tim mladim kadrovima da se zaposle u svojoj struci, te je jako važno podržati ovaj zakon u celosti. Zahvaljujem se predsedavajući!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Së pari do të nënvizoj diçka që ndoshta të pranishmit dhe gjithë atë që do të më dëgjojnë, nuk do të mund ta mirëkuptojnë këtë që do ta them tani.

Është një temë për të cilën nuk e ndjej veten të përgatitur teorikisht, por kam një empiri nga e cila mund të nënvizoj gjëra të dobishme për njerëzit kompetentë të kësaj fushe dhe gjatë rregullimit të këtij projektligji do ta rrumbullakësojmë një fushë shumë të veçantë dhe do të dalim me një ligj i cili do të jetë në funksion të shërbimeve emergjente.

Shërbimin mjekësor emergjent nuk do të dija ta përkufizoja në shërbimin parësor, dytësor dhe tretësor, sikur të mos më rastësiste jeta në një gjendje të cilën unë do të duhej ta mësoja nga empirikja para se të shfletoja diçka nga literatura shkencore.

Për asnjërin nga këto shërbime nuk kam njohuri të mjaftueshme dhe këto fusha jo se janë të veçanta, por edhe po të mos jetë fushë e veçantë, nuk ndjehem i përgatitur për të thënë diçka të dobishme për këtë temë, por ajo çka është e dobishme në këtë rast do të jetë shumë me rëndësi për të gjithë ata që më përcjellin me vëmendje dhe që janë kompetentë për t'i sintetizuar të gjitha shqetësimet të cilat shfaqen dhe ofrohen në trajtimin e kësaj teme.

Sa jam rastisur të jem në emergjencën e QKUK-së, jam bindur se as përafërsisht ambientet e kësaj ndërtese, personeli mjekësor në këtë ndërtesë në mjekë dhe teknikë, nuk i plotësojnë kërkesat dhe nevojat e vendit tonë.

Por, ajo që kam vërejtur, ky personel mjekësor nga mjekët dhe teknikët janë me vlerësimin tim maksimal shërbime titanike bëjnë dhe ofrojnë aty. Tani, unë për veten time nuk mund të vlerësoj kompetencën e tyre, por mund të vlerësoj qasjen, përkushtimin dhe angazhimin në një ambient që nuk mund ta marrësh me mend se vërtetë mund të bëhet një punë e atillë.

Të mëdhenj si njerëz më dukeshin dhe si profesionalistë, më dukej secili nga personeli në shërbimin emergjent të QKUK, mjekë dhe teknikë, sepse nga ai numër i të frekuentuarve nuk mund të krahasohet as përafërsisht as nga emergjenca e Spitalit shtetëror në Shkup, që më ka rastisur edhe atje, as nga shërbimet e emergjencës në Tiranë, që edhe atje më ka rastisur një gjendje të ndryshme. Përkundrazi, edhe atje kam parë përkushtim, por numër të të frekuentuarve, siç shoh në QKUK nuk mund të shohësh e të takosh askund.

Të mos flasim për shërbime emergjente që më ka rastisur në disa nga shërbimet emergjente në Gjermani. Dhe, ajo çka është e rëndësishme, në një aksident që kam pasur në fillimet e luftës dhe që pastaj më shtrinë të palëvizshëm për një dy javë në spital atje, më habit një diçka që në raste fatkeqësie në komunikacion nuk mund të të ofrojë ndihmë njeri dhe njeriu ynë çmendet nga dilema, janë njerëz këta apo jo?

Por, nga edukimi jonë i mëvonshëm mund të bindemi se ata janë njerëz dhe madje, njerëz të përgjegjshëm, sepse askush nuk të ofrohet për të ofruar ndihmë, pa e parë madje, madje, madje as policia, pa ardhur së pari shërbimi i zjarrfikësve dhe pastaj ndihma e shpejtë. Madje, madje edhe mjekët kur të vijnë aty, nuk afrohen pa ardhur shërbimi i zjarrfikësve që ta nxjerrin pacientin në hapësirën e hapur, për t'i ofruar ndihmë mjekët.

Këtu tani, unë për veten time, veten nuk e kam parë, për shembull, sepse kam qenë në gjendje pa vetëdije dhe veç kur e kam pa veten në spital, por nga përshkrimi që më bënin, unë mund të nxirrja dilemën, ky shërbimi policor që afrua aty, ishin të përgjegjshëm dhe ishin njerëz ata që s'i ofronin ndihmën e parë?

Këta të tjerët qytetarë, që ishin aty afër, ishin njerëz dhe ishin të përgjegjshëm. Për dilemën tonë, për gjykimin tonë ballkanas, mund edhe të vlerësohej negativisht, por për njeriun e edukuar në Gjermani, mund të konkludonim drejt, ata ishin njerëz të përgjegjshëm, sepse në 10-minutshin e parë nuk donin të ofronin një ndihmë të gabuar dhe të dëmtonin pacientin, njeriun e aksidentuar. Dhe, me këtë më imponohet një

konstatim që ne në këtë projektligj duhet të punojmë me përgjegjësi dhe të gjithë profesionalistët, për të cilët unë kam një respekt në të gjithë kolegët që punojmë në këtë projektligj, të ofrojnë një ligj i cili jo vetëm do të ofrojë shërbime, por do të ofrojë edhe edukim të qytetarët, pastaj do të ofrojë edhe shërbime emergjente të nivelit profesional, çfarë i duhen në raste të aksidenteve dhe në shërbime të emergjencës së parë.

Unë nuk do të shes mend më tepër, jo për këtë fushë edhe nuk kam, por dua t'i sensibilizoj të gjithë kolegët deputetë, të cilët janë të fushës në këtë komision që t'i qasen me përkushtim këtij projektligji dhe Kosovës t'ia ofrojnë një ligj i cili jo vetëm në aspektin e legjislacionit, por të konstatojnë edhe aspektin e hapësirave që duhet t'i përmbushë ky ligj, nevojat e shërbimit të parë emergjent.

Pra, QKUK-ja edhe po t'i lëshojë të gjithë hapësirën e katit të parë jo vetëm atë kënd që e ka tani Shërbimi Emergjent, nuk i plotëson nevojat e Kosovës që kërkohen të plotësohen nëpërmjet atij korridorit dhe gjithë atij personeli. Për mua janë heronj gjithë ata të Shërbimit Emergjent aty dhe për mua, siç konstatoj kolegu im më parë, nuk shpërblehen adekuat me pagën që ata duhet ta kenë, sepse këtu duhet të kemi qasje edhe nga njerëz kompetentë jo nga unë, unë vetëm sensibilizoj njerëz kompetentë që të gjitha nevojat e kësaj fushe të plotësohen me anë të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka Hatim Baxhaku.

HATIM BAXHAKU: Ju faleminderit, zoti nënkryetar!

Përsëritës ministrit e Shëndetësisë,

Të nderuar kolegë,

Edhe unë dua të jap një kontribut modest në lidhje me këtë ligj, meqenëse edhe profesioni im është mjek. Pas miratimit të Ligjit për shëndetësi, Ligjit për odat profesionale, disa ligje të tjera të cilat rregullojnë fushëveprimin në këtë lëmi, si dhe dy ligjeve të cilat sot janë në shqyrtim, dy projektligjeve në të vërtetë, Ligjit për shërbimin mjekësor emergjent dhe Ligjit për sigurimin shëndetësor, mendoj se në një mënyrë po rrumbullakohet korniza ligjore për të siguruar një shëndetësi dinjitoze si për pacientët ashtu edhe për punëtorët shëndetësorë të Kosovës.

Duhet që në fillim të theksohet se sistemi i organizimit të shërbimeve mjekësore urgjente në botë nuk është unik dhe përtej principeve bazike unike, ka laramani të mëdha në të gjithë vendet e botës, bile-bile edhe në regjione, kantone ose shtetet federale të shteteve të ndryshme të cilat kanë këtë konstruksion të ndërtimit, ekzistojnë dallime shumë të mëdha të organizimit të shërbimit shëndetësor. Prandaj, as ne këtu, as Ministria jonë nuk mund ta gjejë një formulë e cila do të ishte unike në botë, por gjithmonë shërbimet shëndetësore emergjente i përshtaten zhvillimit të shëndetësisë në përgjithësi e cila është edhe si rrjedhim i zhvillimit ekonomik të asaj shoqërie dhe varet nga doktrinat mjekësore të cilat i promovojnë shtetet e veçanta.

Në botë ekzistojnë dy praktika kryesore të organizimit të shërbimeve mjekësore emergjente, njëra është ajo anglo-amerikane e cila promovon modelin ose promovimin e ashtuquajtur "afritit të pacientit tek institucionet shëndetësore" dhe është modeli tjetër

franko-gjerman, domethënë, këto janë dy modele kryesore përndryshe ka shumë modele tjera, e cila promovon modelin e organizimit të shërbimit mjekësor emergjent në atë mënyrë që shërbimet shëndetësore të avancuara ia ofron pacientit, gjegjësisht i ofron në vendngjarje.

Të dy këto shërbime kanë përparësitë dhe mangësitë e veta, por mendoj se në kushtet tona, në kushtet kosovare duke pasur parasysh këtë nivel të infrastrukturës së shërbimeve shëndetësore, modeli i parë, pra ai anglo-amerikan është më i përshtatshmi dhe me të drejtë këtë model e promovon edhe ky projektligj.

Projektligji për shërbimet mjekësore emergjente, i cili sot na është dorëzuar për shqyrtim në krahësim me Ligjin i cili është në fuqi, ka përmirësime të shumta dhe është në praktikë edhe më i përputhshëm me standardet evropiane të kësaj fushe, prandaj si i tillë krijon një bazë të mirë për organizimin modern dhe efikas të Shërbimit Mjekësor Emergjent në përputhje me standardet evropiane.

Unë nuk dua t'i përsëris gjërat, të cilat i përmendën kolegët deputetë më parë, unë dua të ndalem vetëm të një pikë e kjo është në nenin 3, nën paragrafi 1.16. thuhet se ky sistem duhet të jetë i integruar dhe i ndërlidhur vertikalisht dhe horizontalisht. Dhe kjo është esenca e Shërbimit Shëndetësor Emergjent dhe pa të cilin nuk mund të sigurohet një shërbim emergjent efikas dhe t'i arrijë qëllimet e veta për të cilat krijohet.

Prandaj, gjatë përpunimit të mëtejshëm të këtij projektligji, lus grupin punues, po ashtu edhe kolegët deputetë që me amendamentet të cilat i bëjnë të qartësojnë mënyrën më të mirë se si do të bëhet ndërlidhja në mes të qendrave emergjente rajonale apo lokale, komunale dhe Qendrës Emergjente Nacionale, siç është Qendra Emergjente Traumatologjike.

Dhe, kjo duhet të bëhet nëpërmjet radiolidhjeve dhe lidhjeve direkt të cilat do të funksionojnë në çdo kohë dhe pa një ndërlidhje të këtillë nuk mund të sigurohet një shërbim efikas emergjent mjekësor, ashtu siç e meritojnë edhe qytetarët, por edhe punëtorët shëndetësorë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje për ministrat,

Të nderuar deputetë,

E përgëzoj ministrin edhe ekipin e tij për hartimin e këtij projektligji, ligj i cili avancohet me siguri cilësinë e ofrimit të shërbimeve emergjente në shtetin tonë. Shumicën e gjërave të cilat pata ndërmend t'i diskutoj, para folësit e mi veç i potencuan ,mirëpo isha ndalur në 2-3 gjëra që ndoshta janë praktike dhe dytësore, por në esencë janë përmbajtjesore për kah pikënisja dhe për kah përfundimi i shkurtimit të afatit kohor për trajtimin e atyre që kanë nevojë për ndihmë emergjente.

Fillimisht, ekipi që ka punuar këtë projektligj a është bazuar në dokumente strategjike të shtetit tonë që është sistemi për menaxhimin e integruar të emergjencave, planin e reagimit kombëtar, Ligjin për mbrojtjen nga zjarri, Ligjin për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe dora e njeriut dhe Ligjin për zjarrfikje. Kjo është e para se dëshira për të vepruar si ekip edhe në mënyrë të koordinuar të gjitha institucionet e shtetit tonë me rastin e fatkeqësive natyrore, apo fatkeqësive tjera, normalisht që intenca ta sjellin në mënyrë të koordinuar si e tha edhe një prej parafolësve për shembull Haliti që në vendin e ngjarjes të një rast ku ka pasur pasoja traumatologjike për një qytetar a shumë qytetarë duhet njëkohësisht të veprojnë ekipet policore, ekipi për zjarrfikje dhe ekipi mjekësor.

Te këto raste a do të jenë vetëm njësitë paramedikale ato që do të jenë të dirigjuara prej Qendrës Emergjente që janë të koordinuara për t'i ofruar ekipet deri te vend ngjarja apo do të varet ajo prej qendrave mjekësore dhe shtëpive të shëndetit për t' i orientuar ato ekipet, kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë është, ekipet paramedikale a do të jenë të përcaktuara për të vepruar vetëm te emergjencat traumatologjike që kanë për pasojë traumat dhe janë ato në gatishmëri vetëm për emergjencat traumatologjike apo edhe ekipet tjera të emergjencave që janë për emergjenca shëndetësore biologjike do të reagojnë, qoftë prej situatës apo prej kohës në diskonim apo prej ekipeve në disponim për të vepruar.

Kjo është e para edhe në start ndoshta është mirë për t'i rregulluar këto gjëra, sigurisht ministri i ka paraparë edhe ekipin që me udhëzime administrative këto të definohen dhe të orientohen në mënyrë që mos të krijohen dy ekipe dualiste për të cilën me siguri buxheti i shtetit tonë nuk do të mund t'i përballonte.

Çështje tjetër kisha dashur ta potencoj që ekipet që do të edukohen dhe trajnohen për këtë ofrim të ndihmave emergjente a do të jenë vetëm në drejtimin traumatologjik edhe a do të përfundojnë në Qendrën Emergjente apo deri në finale të shërimit të atij pacienti, do të jetë një sistem që është i veçantë prej sistemit tjerë shëndetësor dhe do të merret vetëm me sanimet edhe pasojat e rasteve traumatologjike të qytetarëve, gjë që të ketë intencën në atë drejtim është një kosto bukur e madhe e shtetit tonë që vështirë se e përballon edhe pse gjitha shtetet punojnë ndoshta në atë drejtim edhe qytetarët janë të interesuar për të vepruar në këtë drejtim.

Unë veç e kisha lutur ministrin që ekipi i tij i cili ka marrë pjesë në hartimin e atyre dokumenteve strategjike që i potencova më parë dhe kanë dhënë kontribut të arsyeshëm t'i kenë parasysh këto gjëra, po besoj edhe gjatë ekipeve, grupit punues që do të krijohet në kuadër të komisionit, disa prej këtyre elementeve do të shqyrtohen edhe njëherë edhe do të trajtohen. Ju përgëzoj ministër edhe keni bërë shumë punë të qëlluar.

KRYESUESI: Faleminderit! Haki Demolli e ka fjalën.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit! I nderuar kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës

Lidhur me draft ligjin për shërbimin mjekësor emergjent unë do t'i paraqes disa vërejtje dhe sugjerime të mija.

Sugjerimi i parë ka të bëjë me nenin 3 të këtij drafti në të cilin janë dhënë përkufizimet e shprehjeve të përdorura në këtë ligj. Konkreisht fjalën e kam për shprehjet e përkufizuara në pikën 1.11 deri pikën 1.13. në të cilat përkufizohet nocioni i “emergjencës” dhe “urgjencës” e që faktikisht në pikën 1.13. shkaktohet një konfuzion që vërtet të bën të paqartë se gjatë gjendjes urgjente a rrezikohet jeta e njeriut apo jo.

Të sqaroj, në pikën 1.11. të këtij neni, ndër të tjera, për emergjencën thuhet se është ndryshimi i përnjëhershëm i gjendjes shëndetësore gjatë të cilës rrezikohet jeta dhe dëmtohet seriozisht shëndeti i njeriut, kurse në pikën 1.12. përkufizohet: “urgjenca, si ndryshim i përnjëhershëm i gjendjes shëndetësore gjatë të cilës nuk rrezikohet jeta ose nuk dëmtohet seriozisht shëndeti i njeriut”, kurse në pikën 1.13. të nenit 3, përkufizohet gjendja e urgjencës si çdo lloj ngjarje të paparashikuar që rrezikon jetën.

Andaj, mirë është që të analizohen këto përkufizime dhe të bëhet përshtatja ndërmjet tyre. Kur jemi te përkufizimet duhet theksuar se në pikën 1.18. përkufizohet shprehja “reaguesi i parë” e që në vazhdim në draft ligj thuajse fare nuk haset kjo shprehje.

Nga përkufizimi i kësaj shprehje, pra shprehjes “reaguesi i parë” mund të thuhet se si e tillë nuk ka nevojë fare të trajtohet në këtë ligj, sepse nga sqarimet e dhëna shihet se “reaguesi i parë” i cili pasi që nuk është personel mjekësor, nuk është pjesë e Shërbimit Emergjent andaj edhe s'ka nevojë të përkufizohet fare.

Sugjerimi tjetër ka të bëjë me nenin 12 në të cilën trajtohet Shërbimi Traumatologjik duke theksuar tri nivele të ofrimit të këtyre shërbimeve, mirëpo vërejtja që mund t'i bëhet trajtimit të këtyre niveleve ka të bëjë me rangimin e tyre, i cili sipas këtij draftligji do të bëhet pas propozimit të Këshillit profesional, kurse unë mendoj se niveli i trajtimit të traumave është dashur të rregullohet me dispozitat e këtij draft ligji e jo me protokollin e theksuar në paragrafin 2, pika 1 të nenit 12.

Më tutje në nenin 26, paragrafi 1 flitet në mënyrë shumë të paqartë për një aftësim konform nenit 19, pika 1 dhe nenit 20, pika 1. por, kur lexohen këto dy nene atëherë shihet se në to nuk bëhet fjalë për kurrfarë aftësimi, andaj duhet analizuar këtë nen dhe shikuar se për çfarë aftësimi është fjala, ndoshta për aftësimet e trajtuara në nenet 23, 24 dhe 25 të këtij drafti.

Sugjerimi tjetër ka të bëjë me Këshillin profesional për Shërbimin Mjekësor Emergjent, funksionimi i të cilit sipas nenit 33, parashihet që të rregullohet me një akt nënligjor të nxjerr nga Ministria e Shëndetësisë. Duke pasur parasysh rëndësinë profesionale që duhet ta ketë ky këshill për shërbime emergjente, unë mendoj se pikërisht në dispozitat e këtij ligji do të duhej të përcaktohej: struktura, numri i anëtarëve, përzgjedhja apo emërimi i tyre, kriteret të cilat duhet t'i plotësojnë kandidatët për këtë këshill, mandati dhe mundësia e rizgjedhjes si dhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin dhe

financimin e këtij këshilli e assesi të mbetet që me akt nënligjor të rregullohet kjo çështje kaq e rëndësishme.

Në fund do të theksoja se draftligji ka nevojë edhe për një lekturë, respektivisht korrekturë gjuhësore, si dhe për disa përmirësime dhe harmonizime teknike. Kështu për shembull, te neni 3 paragrafi 1. pika 9 kemi fjalët në gjuhën shqipe, “mbështetje themelore të jetës”, kurse akronimi apo shkurtesa që është në kllapa është në gjuhën angleze “bls”. Pastaj, në nenin 12, paragrafi 2.1. përmendet propozimi i Këshillit profesional nga neni 34 i këtij ligji, kurse neni 34 ka të bëjë me financim, ndërsa këshilli trajtohet në nenin 33.

Andaj, numri 34, në nenin 12, duhet ndryshuar me numrin 33 në mënyrë që t’i referohemi saktësisht nenit i cili e trajton këshillin profesional. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Ministra,

Kolegë deputetë,

Njerëzit kompetentë që janë edhe në fushën e mjekësisë i paraqitën edhe në bazë të aspektit profesional edhe atë çka i duhet Kosovës në këtë fushë, unë mendoj që edhe si shtet i ri pa dashur ta quaj edhe si shtet në tranzicion nevojën që të kemi ligje sistematike që rregullojnë sektorë të caktuar, pavarësisht ideve nga vendet e tjera mendoj që duhet t’i përshtaten rrethanave dhe kushteve të cilat i ka Republika e Kosovës.

Sa i përket projektligjit unë mendoj që është i nevojshëm dhe jap përkrahjen në parim, por mendoj që duhet të korrigjohen disa aspekte të cilat a është implementueshëm dhe cilat amendamente duhet që të korrigjohen.

Mendimi im është te përkufizimet dhe që kanë të bëjnë edhe me strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe që është vështirë që të implementohen edhe në praktikë dhe këtë do dëshiroja ta dëgjoja edhe nga ministri se si e kanë dizajnuar apo cila është ideja e tyre për ambulancën ajrore dhe shërbimin e ambulancës ajrore.

E para edhe nga deklarata financiare që është paraqitur nga Ministria e Financave fare nuk është theksuar kjo çështje apo edhe në përmbajtjen e projektligjit nuk flitet se si do të ofrohet ky shërbim, domethënë për të sëmurit apo të lënduarit të cilëve u nevojitet kujdesi mjekësor emergjent.

E dyta, nuk tregohet edhe mënyra dhe koordinimi me ministrinë e tjera të linjës, por edhe me këto shërbime që ofrohen deri më tani dhe kush është kompetentë për hapësirën ajrore në Republikën e Kosovës. Dhe, kjo besoj që do të jetë vështirë e implementueshme edhe pse këtu ka elemente edhe atje te nenet dhe te përkufizimet e mëposhtme për përgatitjen e njerëzve dhe stafit përkatës dhe koha që duhet të përgatiten këta njerëz.

Andaj, zoti ministër kjo duhet mendoj që të korrigjohet apo të shpjegohet në formën ju si mendoni ta implementoni, përndryshe do të mbetet vetëm kështu amendament në letër dhe i pazbatuar në praktikë. Prandaj, nëse kjo ose nëse ju nuk keni mendim tjetër së paku mu po më intereson te financimet, të shkollimit të pilotëve dhe të blerjes së helikopterëve në këtë fushë, pavarësisht që keni apostrofuar edhe sektorin publiko-privat që mund të ketë një diçka në të ardhmen.

Kështu që sipas kushteve dhe rrethanave mendoj që Kosova nuk është e gatshme në aspektin financiar apo buxhetor dhe pse kjo nuk është thënë këtu, është mirë të thuhet, pavarësisht ideve dhe ridizajnit të dokumenteve tjerë strategjikë edhe përkatës, sepse ne kemi pasur tash kohëve të fundit në territore të caktuara për eliminimin e rriqrave dhe angazhimin e aeroplanëve apo helikopterëve dhe deri më tani nuk kemi ndonjë specifikë të veçantë se ku edhe si do të bëhet.

Prandaj, kjo si ide mendoj që është shumë më ambicioze, por mendoj që nuk e ka vendin tash në këtë projektligj nëse saktësisht nuk përkufizohet se si do jetë e implementueshme dhe a do të jetë e implementueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Folësi i fundit është deputeti Bekim Haxhiu, ndërkaq i thërras deputetët të hyjnë në sallë për votime.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë

Do të provoj të jem i shkurtër, pasi shumica e kolegëve i thanë disa nga vërejtjet e caktuara, mirëpo duke e pasur parasysh qëllimin e fushëveprimit të këtij ligji, i cili i përcakton kushtet e organizimit dhe mënyrën e funksionimit të shërbimit mjekësor emergjent në Republikën e Kosovës, te neni 2, ku precizohet organizimi i kësaj veprimtarie si fushë e veçantë e veprimtarisë shëndetësore, mendoj që nuk do të duhej të ishte si fushë e veçantë, mirëpo si pjesë e integruar e shërbimit dhe veprimtarisë shëndetësore për arsye se kjo pjesë apo kjo hallkë është hallka e parë e ofrimit të shërbimit mjekësor apo kujdesit emergjent.

Gjithashtu, te neni 2 precizohet se ky shërbim mjekësor emergjent ofrohet pandërprerë për qytetarët, të cilët për shkak të sëmundjes, apo lëndimit, u është rrezikuar drejtpërdrejt jeta, organi i caktuar apo pjesë të caktuara të trupit, respektivisht shkurtimit të kohës optimale nga ndodhja e rastit emergjent deri në fillimin e procesit të trajtimit përfundimtar.

Mendoj që ky precizim kaq i gjatë, kur rrezikohet drejtpërdrejt jeta apo organi i caktuar duhet të përmirësohet, të jetë shumë thjesht në raste kur kemi rrezikimin e shëndetit dhe të jetës. Nuk ka nevojë të specifikohen organe të caktuara për arsye se me rrezikimin e shëndetit parashihet që organet mund të jenë të dëmtuara, apo në këtë rast, kur e cekim se duhet të shkojnë deri në procesin përfundimtar të trajtimit, i nderuari ministër, besoj që ndoshta me ekspertët tuaj do të ishte mirë të mendojnë nëse do të ishte mirë që ky ligj në përgjithësi të jetë ligj për shërbimin emergjent mjekësor dhe kujdesin intensiv, për arsye

se në shumicën e rasteve ky trajtim, bazuar në diskutimin e kolegut të nderuar doktor Fatmir Xhelili, ka nevojë që të vazhdohet trajtimi përfundimtar dhe këto raste shpeshherë përfundojnë edhe në kujdesin intensiv.

Ndërsa kujdesin intensiv, për fat të keq, ne nuk e kemi në nivelin e duhur dhe kemi mungesë të kapaciteteve aty dhe është më se e nevojshme që të kemi ngritje të kapaciteteve, e duke i ngritur kapacitetet infrastrukturore në kujdesin intensiv të ngremë edhe kapacitet infrastrukturore apo ligjore në këtë segment. Dhe, vërejtja ime tjetër mendoj që do të ishte mirë të mendohej edhe për kujdesin emergjent në objekte sportive, apo gjatë aktiviteteve sportive, dhe gjithsesi dhe kulturore, për arsye se është e nevojshme që gjatë aktiviteteve sportive objektet e veçanta sportive të kenë dhoma të veçanta për trajtimin emergjent, ndërsa ky shërbim pastaj t'u ofrohet më tutje.

Mendoj që edhe licencimi i këtyre objekteve sportive duhet të bëhet pasi të jetë kompletuar edhe dhoma për ofrimin e shërbimit emergjent dhe në këtë formë të vazhdojmë edhe kah avancimi i këtij sektori.

Gjithsesi, ministër, ju përgëzoj për punën edhe për ofrimin e kësaj legjislature në seancën e sotme dhe besoj që do të vazhdojmë me kompletimin e legjislaturës së nevojshme. Përgëzime!

KRYESUESI: Ministri e ka kërkuar fjalën.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, të nderuar deputetë dhe grupe parlamentare për mbështetjen e projektligjit!

Vetëm disa informata, pa pretendime me pas përgjigje në detaje në secilën pyetje. Çdonjërin vërejtje e kam shënuar dhe me ekipin e ministrisë me siguri do të asistojmë edhe në punën e Komisionit Parlamentar në qoftë se e shoh të arsyeshme se ka nevojë për një bashkëpunim në këtë fazë.

Vetëm 3-4 pyetje kryesore si informata më tepër. Grupin e punës e ka udhëhequr drejtori i Klinikës Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Ai grup ka qenë i përbërë nga ekspertët, të cilët janë në vijën e parë të frontit të shërbimeve emergjente në vend dhe ka qenë grup interdisiplinar, i ka inkuadruar edhe ekspertët e fushave të tjera, pra të sektorëve tjerë të ndërlidhur.

Konkretisht neni 11 i projektligjit e siguron atë interdisiplinaritetin dhe koordinimin e punës, duke siguruar harmoni me sistemin e integruar të menaxhimit të emergjencave dhe planin e reagimit kombëtar. Pra, është insistuar në këtë.

Çështje e dytë që u ngrit - çështja e kostos së projektligjit, plotësisht pajtohem, e në dukje të parë duket ashtu, por projektligji ka pasur për qëllim që të organizojë dhe të përshkruajë sistemin e adiminstrimit të shërbimeve emergjente. Me atë që është e shkruar në tekst, Ministria e Financave nuk ka parë kosto shtesë të këtij projektligji, mirëpo ne paralelisht jemi duke punuar me Ministrinë e Financave për sigurimin e konstruksionit

financiar për qendrën e re emergjente traumatologjike, në vlerë prej 31 milionë euro për vitin që vjen.

Pra, jemi në proces të kësaj. Ndërsa, kur është në pyetje zbatueshmëria e ligjit dhe se a është ky ligj i zbatuar apo jo, unë shpresoj që pas një dy orëve, pasi ta diskutojmë edhe Ligjin për sigurimin shëndetësor, do ta kemi një realitet tjetër juridik, i cili shpresoj që pas një kohe të shkurtër të jetësohet edhe me miratimin e plotë të Ligjit të sigurimeve shëndetësore dhe në ato rrethana, me mbi 80 milionë euro të reja për sistemin shëndetësor, me siguri se edhe dispozitat e këtij ligji duken shumë më reale.

Ambulanca ajrore është përmendur, sepse po të mos përmendej nuk do të kishim pas bazë ligjore për ta siguruar nesër kur të kemi mjete të mjaftueshme financiare për financimin e këtij projektligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Do të kalojmë në votimin e projektligjit. Regjia dhe deputetët, ju lutem, bëhuni gati për votim. Votojmë tash!

Me 64 vota për, asnjë abstenim dhe asnjë kundër, pra njëzëri, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shërbimin mjekësor emergjent.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia sjellin raportin me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Është një moment i veçantë edhe për mua që para jush e kam nderin dhe kënaqësinë që ta paraqes Projektligjin për shëndetin mendor. Një dokument ligjor, për të cilin është biseduar në Kosovë qysh në vitin 2000/2001, por dokument ligjor për të cilin në atë kohë nuk janë pjekur kushtet për ta elaboruar, ndoshta do ta kishim elaboruar e ndoshta edhe do të ishte miratuar, por ka qenë shumë vështirë për ta zbatuar, duke pasur parasysh se ka munguar në masë të madhe infrastruktura, edhe kapitale në kuptimin e objekteve, por edhe njerëzore, në kuptimin e mundësive profesionale.

Siç e dini, shëndeti mendor është një lëmi ku ndeshen ndërmjet vete problematikat e disa fushave. Ndërmjet tyre veçohet ajo e të drejtave të njeriut dhe shëndetit mendor të personave që kanë nevojë për shërbime shëndetësore, ajo e personave që ofrojnë shërbimin në lëmin e shëndetit mendor e deri te çështjet e sigurisë së personave që

lëngojnë nga sëmundjet dhe çrregullimet serioze psikiatrike, si dhe profesionistëve shëndetësorë dhe të tjerë, të cilët i ofrojnë shërbimet e duhura.

Ndërlidhur me këtë, problematika e kësaj fushe është ndërdisiplinore dhe ndërsektoriale. Deri më tani, problematika juridike e ndërlidhur me shëndetin mendor ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, e aprovuar në vitin 2001, dhe rrjedhimisht gjatë tentimit për avancimin e shërbimeve në këtë lëmi dhe zgjidhjes së problemeve konkrete në praktikën e përditshme shumë herë juridike janë paraqitur sfidat e parregulluara në aspektin ligjor.

Mbështetur në këtë, ka qenë e domosdoshme që kjo lëmi e shëndetësisë dhe sektorëve të ndërlidhur të rregullohet me ligj të veçantë, të cilin sot e keni para jush, duke synuar arritjen e një standardi të rëndësishëm ndërkombëtar në këtë aspekt.

Ky ligj ka për qëllim vendosjen e rregullativave bazike në shëndetin mendor, mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore, mbrojtjen e koherencës familjare, si dhe lehtësimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore nga profesionistët shëndetësorë.

Me këtë projektligj përcaktohen procedurat dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor nëpërmjet politikave parandaluese, si dhe sigurimit të kujdesit të vazhdueshëm shëndetësor dhe mjedisit të përshtatshëm social për personat me çrregullime mendore.

Parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor, të përcaktuara me këtë projektligj, janë: trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime mendore në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit të tyre njerëzor, ofrimi i kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim mendor në një ambient sa më pak shtrëngues, kryesisht në nivel komunitar, për të shmangur në maksimum zhvendosjen nga mjedisi familjar dhe për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin e tyre social.

Krijimi i lehtësirave për këta persona dhe familjet e tyre me qëllim të përfshirjes së tyre në jetën shoqërore, ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga ekipe multidisciplinare që u përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit, ushtrimi i të drejtave të personave me çrregullime mendore në përputhje me aktet relevante ndërkombëtare. Dhe, me këtë ligj në veçanti rregullohen të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme kushtetuese për personat me çrregullime mendore, si konfidencialiteti, mbrojtja nga diskriminimi dhe trajtimet çnjerëzore, heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, trajtimi i vullnetshëm i të sëmurëve psikiatrikë, trajtimi i pavullnetshëm i të sëmurëve psikiatrikë, pra privimi nga liria për shkaqe të sëmundjes ose çrregullimit mendor deri te kufizimi i tyre fizik, si dhe të drejtat e personit që do t'i nënshtrohet trajtimit të pavullnetshëm.

Procedura për shtrimin e shërbimit të shëndetit mendor të specializuara me shtretër për personat që kanë nevojë për trajtim të pavullnetshëm, si dhe trajtimi i pavullnetshëm me vendim të gjykatës kompetente.

Në pajtim me Ligjin e shëndetësisë, shërbimet e shëndetit mendor organizohen dhe ofrohen në tri nivele: parësor, dytësor dhe tretësor shëndetësor. Me nenin 28 të projektligjit rregullohen shërbimet e shëndetit mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, ndërkaq me projektligj është i rregulluar edhe monitorimi i jashtëm i shërbimeve të shëndetit mendor, si dhe pjesëmarrja e organizatave jofitimprurëse në përkujdesjen e personave me këto sëmundje dhe çrregullime.

Projektligji ka shtatë krerë dhe 36 nene, me të cilat jam i bindur se do të kontribuohet shumë në lëmi tejet të ndjeshëm të shëndetësisë, e cila si e tillë dhe me rëndësi të veçantë është veçuar edhe në raportet e fundit të progresit të Komisionit Evropian dhe atë nëpër vite. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër! Kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale, zoti Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2014 e shqyrtoi në parim Projektligjin për shëndetin mendor dhe vendosi që ta paraqesë këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet në parim Projektligji për shëndetin mendor

Komisioni, pas shqyrtimit në parim, vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe rekomandon për miratim në parim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kemi edhe disa pika të rendit të ditës që do t'i shqyrtojmë sot. Është e drejta juaj të flitni sa të doni, unë s'po ju kufizoj, por ju kisha lutur të jeni më të koncentruar, sepse duhet t'i kryejmë.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zëvendëskryetar i Parlamentit!

Kolegë dhe kolege,

Në një shoqëri të dalë nga lufta, në një shoqëri në tranzicion, të varfër dhe me shumë probleme sociale, është e kuptueshme predispozita për shumë probleme të shëndetit mental. Gjithashtu, për shkak të trajtimit joadekuat të sindromës postraumatike të luftës dhe vetë përbërjes së popullatës të re, që është e predisponuar ndaj veseve të këqija, siç është alkoolizmi ose droga, ky ligj kujtoj se vjen në momentin e duhur, përkatësisht është pritur shumë më herët, sepse me Rregulloren e UNMIK-ut nuk ka qenë e mundur që t'i qasemi në mënyrë çfarë e kërkon popullata jonë trajtimit të shëndetit mental.

Pra, me këtë ligj do të definohen parimet e përgjithshme të kujdesit të shëndetit mendor, të drejtat e personave me çrregullime mendore, organizimi i këtyre shërbimeve në të gjitha nivelet.

Shërbimet e shëndetit mendor për fëmijët dhe adoleshentët, trajtimi, rehabilitimi, riintegrimi dhe risocializimi i personave me çrregullime mendore, si dhe do të përcaktohen mënyrat e ndërgjegjësimit të shoqërisë lidhur me personat me këto çrregullime, e që ne si shoqëri sikur i distancojmë këta njerëz.

Deri më tani kemi pasur probleme dhe mangësi të mëdha dhe besoj që ligji do ta përmirësojë këtë situatë, përkatësisht ne kemi kuadro dhe ndërtojmë kuadro që t'i qasemi dhe të mund ta zbatojmë në mënyrë adekuate këtë ligj.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar ligjin dhe i ka vërejtjet e caktuara, të cilat nëpërmjet anëtarëve të vet në Komisionin Funkcional do të përpiqet t'i përmirësojë aq sa është e mundur në këtë ligj.

Projektligji në fjalë ka forma dhe strukturën standarde të legjislacionit dhe u është përshtatur dispozitave të parapara në Bashkimin Evropian. Ne mendojmë se ky ligj është ndër ligjet e mirëseardhura për momentin dhe do të pasurohet edhe në Komisionin për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputetja Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar Projektligjin për shëndetin mendor dhe në parim do ta mbështesë, por i kemi disa vërejtje që janë më tepër ndoshta disa gabime teknike sesa përmbajtjesore.

Unë, të mos humb shumë kohë, kisha shkuar konkretisht ku i kemi vërejtjet, të cilat me siguri që do të merren parasysh mandej në komision gjatë amandamentimit. Kisha filluar prej nenit 3, të përkufizimit të miturit, adoleshentit, si kufi moshe merret mosha 14-vjeçare, ndërsa dihet se në shtetet e Perëndimit si moshë kufitare merret mosha 13-vjeçare e të miturit apo adoleshentit.

Mandej, në nenin 10 duhet të ketë kujdes që emërtimi të kujdesi, domethënë në cilat nivele ofrohet shëndeti mendor që të ketë një përputhshmëri me ligjin bazë, pra Ligjin Nr. 04 / L- 125, edhe le të jetë kujdesi parësor shëndetësor, kujdesi dytësor shëndetësor, kujdesi tretësor shëndetësor, e jo të jetë kujdesi shëndetësor parësor, e kështu me radhë.

Në nenin 15, pika 2 duhet të jetë kështu: Në të gjitha nivelet e shërbimeve të shëndetit mendor zbaton programe unike të trajtimit, të bazuara në të dhënat shkencore dhe protokolle të propozuara nga asociacionet profesionale të vendit dhe të miratuara nga odat e profesionistëve shëndetësorë, e jo nga Ministria e Shëndetësisë.

I njëjti problem është edhe në nenin 33, pra duhet të jetë nga odat e profesionistëve shëndetësorë. Këto janë ato vërejtjet pak a shumë që jepen nga Grupi ynë Parlamentar. Besoj që kontributin do të vazhdojmë të japim edhe në Komisionin Funksional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të “Vetëvendosjes”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Mungesa e Ligjit për shëndetin mendor është një indikator konkret për situatën në të cilën ndodhen qytetarët e Kosovës me çrregullime mendore.

Ky fakt flet shumë jo vetëm për nivelin e interesimit të shoqërisë për këtë kategori të qytetarëve, por edhe për pozitën në të cilën ndodhen ata. Për shkak të stigmatizimit dhe izolimit, në Kosovë nuk ka të dhëna të sakta për numrin e qytetarëve me çrregullime mendore.

Aty ku nuk ka shifra, aty ku të goditurit nuk janë të regjistruar, është e vetëkuptueshme që nuk trajtohen. Stigmatizimi dhe izolimi i qytetarëve me çrregullime mendore ndikon që këta të mos trajtohen fare nga institucionet profesionale, ndërsa edhe numri i vetë institucioneve që merren me këto çështje është i vogël. Në një vend ku nuk ka rregullim ligjor, ka anarki, ka keqpërdorim, keqtrajtim, abuzim dhe shkelje të të drejtave elementare të njeriut.

Shumë raporte nga terreni flasin për një gjendje të rëndë sa i përket trajtimit, i cili është i shumëfishtë nën atë që mund të quhet “dinjitet njerëzor”. Rastet që ne i shohim në rrugë janë pjesa më e vogël e problemit si tërësi. Në mungesë të ligjit ka qenë kryesisht Policia e cila është marrë me to, duke i tërhequr nga rruga dhe duke i dërguar në psikiatri. Edhe trajtimi institucional pa bazë ligjore, pa norma të përcaktuara, siç ka qenë deri më tani, nuk ka siguruar gjithnjë trajtim dinjitoz.

Projektligji për shëndetin mendor është një dokument shumë i rëndësishëm dhe kërkon miratim të shpejtë. Edhe pse edhe për implementimin e këtij ligji mungojnë kushtet e nevojshme, ligji së paku i përcakton normat ligjore dhe trajtimin e tyre, duke përcaktuar standardet e trajtimit dhe duke ua siguruar atyre të drejtat që u takojnë. Ligji si tërësi ka për qëllim organizimin e shërbimit, mjedisin social dhe preventivën për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” është për miratimin e ligjit në parim, ndërsa vërejtjet dhe sqarimet do t’i mund t’i bëjë edhe në komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Mungesa e këtij ligji ka qenë një mangësi legislative në sistemin shëndetësor, sepse me këtë është pamundësuar edhe puna e profesionistëve shëndetësorë dhe mostrajtimi adekuat i pacientëve me probleme mendore.

Trajtimi profesional dhe i dinjitetshëm i personave me aftësi të kufizuara është e drejtë e garantuar me të gjitha konventat ndërkombëtare. Pra, pa këtë ligj punëtorët shëndetësor ka qenë të rrezikuar dhe kanë punuar nën stres. Mungesa e ligjit ka bërë që nëpër rrugët e Kosovës, pra në hapësirat publike, kemi pasur persona që bredhin, e në fakt prishin rendin dhe qetësinë publike dhe shpesh qytetarët rrezikohen nga agresiviteti i personave me probleme mendore.

Me këtë ligj definohen parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor, të drejtat e personave me çrregullime mendore, organizimi i këtyre shërbimeve në të gjitha nivelet, shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë, trajtimi, rehabilitimi, riintegrimi dhe risocializimi.

Me këtë ligj rregullohen edhe shërbimet e shëndetit mendor në institucionet e posaçme psikiatrike, pra qëllimi dhe garantimi i të drejtave dhe përmirësimit të cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore, të drejtat janë të përcaktuara me ligj.

Shërbimet ofrohen në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor, edhe primar, sekondar dhe terciar. Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe duke e ditur rëndësinë e tij do ta votojë në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Koalicioni Kosova e Re, Jeton Svirca, e ka fjalën.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Ne e falënderojmë dhe përshëndetim ministrin për sjelljen e këtij projektligji, i cili e ka mbuluar edhe një boshllëk ligjor në këtë aspekt. Pra, me sjelljen e këtij projektligji po mbulohet edhe kjo fushë.

Në këtë ligj, gjatë leximit të tij, kemi vërejtur se janë përcaktuar qartë procedurat dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, janë siguruar kushtet për kryerjen e këtij shërbimi, sigurohet një mjedis social i përshtatshëm për personat me çrregullime mendore, si dhe përcaktohen politikat parandaluese për mbrojtjen dhe përparimin e shëndetit mendor të popullatës.

Me këtë ligj definohen parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimin e shëndetit mendor, të drejtat e personave me çrregullime mendore, organizimi i këtyre shërbimeve në të gjitha nivelet, shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë dhe adoleshentë, trajtimi, rehabilitimi, riintegrimi dhe risocializimi i personave me çrregullime mendore, si dhe përcaktohen mënyrat e ndërgjegjësimit të shoqërisë lidhur me këto çrregullime.

Po ashtu, me këtë ligj rregullohen edhe shërbimet e shëndetit mendor në institucionet e përmbartimit të vendimeve penale, si dhe në institucionet e posaçme psikike, mekanizmat e monitorimit të brendshëm dhe të jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor, si dhe sanksionimi i shkeljeve procedurale dhe ligjore.

Koalicioni për Kosovë të Re e përkrah këtë ligj, si dhe kontributin e tij komplet do ta japë në mbledhjet e Komisionit Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka shefja e Grupit “6+”, Mufera Shiniq e ka fjalën.

MUFERA SHINIQ: Faleminderit, kryesues!

Ruh Shëndeti Yasa Tasarısının amacı, bu hastalığa yakalanmış olanları korumak, gözetlemek, sosyal güvence sağlamak ve hayat şartlarını düzeltmektir.

Ruh shëndeti yerinde olmayan kişilere devlet tarafından gereken sosyal yardım yanında profesyonel ekipler tarafından sağlık hizmetinin de sunulması öngörülmektedir.

Rehabilitasyon, reentegrasyon, daha doğrusu topluma yeniden kazandırmak için gereken tüm hizmetlerin yapılması öngörülmüştür.

Bu Yasa Tasarısının daha iyi ve pratikte uygulanması için fonksional komisyona öneriler vererek, “6+” Parlamenter Gurubu olarak katkımızı sunacağız.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Për diskutim, sipas kësaj radhe: Ganimete Musliu, Haliti Krasniqi, Fatmir Xhelili. Mbajeni në mend, se po thoni që po i ndërroj. Nuk është e vërtetë kjo, me rend jua jap fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zëvendëskryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Fillimisht më lejoni që ta përshëndes ardhjen e këtij ligji dhe e përgëzoj ministrin dhe stafin për punën që kanë bërë në këtë projektligj.

Mendoj që ka qenë më se i nevojshëm për personat, të cilët janë të prekur në këtë kategori dhe gjithashtu mendoj që do të reflektoj pozitivisht në vetëdijesimin dhe aktivizimin e shoqërisë sa i përket shëndetit mendor.

Unë e kam shqyrtuar këtë projektligj dhe kam hasur disa vërejtje, ose thjesht do t'i bëj disa vërejtje. Megjithatë, unë kam komentuar këtu tek unë nen për nen, por megjithatë unë do t'i bëj vetëm disa vërejtje publike në këtë rast dhe për të gjitha rekomandimet dhe sugjerimet që do t'i kenë për këtë projektligj do të mundohem që bashkërisht me komisionin përkatës profesional të mundohemi që ky ligj të jetë sa më i adaptuar dhe të jetë sa më i përshtatshëm për këtë kategori.

Desha vetëm te neni 3, pika 1.4, ku thuhet që personi deri në moshën 14 vjeç, të shikohet ligji për familje dhe Kodi Penal dhe i-e mitur, që është personi i moshës 14 deri 18-vjeçare. Mendoj që ky dallim duhet të mënjanohet, përdërisa të gjithë personat nën moshën 18-vjeçare derisa ata e fitojnë... e veprimi para pjekurisë sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve janë fëmijë dhe i kanë të drejtat e njëjta.

Gjithashtu, tek neni 20.2, ku thuhet rastet për të cilat gjykohet se një person me çrregullime mendore duhet të trajtohet në mënyrë të pavullnetshme. Mendoj që këtu duhet të shtohet kur plotësohen të gjitha kërkesat që pasojnë, kështu që vetëm kur kërkesat e grumbulluara janë plotësuar është e mundur vendosja jo e vullnetshme.

Gjithashtu, kam edhe disa vërejtje te neni 26, pika 1 - kërkimet hulumtuese dhe shkencore ndaj personave me çrregullime mendore ndërmerren vetëm pasi të jetë marrë miratimi i informuar nga këta pacientë. Mendoj që duhet të dihet edhe çfarë ndodh me ata për të cilët është dhënë pëlqimi për kujdestari.

Janë këto disa vërejtje që unë po e shfrytëzoj rastin t'i them sot në seancë. Mirëpo, të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet që kam lidhur me këtë ligj do t'i adresoj në komisionin përkatës me mendimin e vetëm që ky ligj të jetë sa më i implementueshëm dhe i afërt me personat, të cilët kanë nevojë për vendimin ose thjesht për zbatueshmërinë e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Është një projektligj që hapësira jonë e legjislacionit e ndien mungesën e tij, por më së shumti mungesën e ndien personeli që punon në këtë fushë dhe njerëzit, të cilët ndoshta nuk e ndiejnë mungesën e këtij fare, por të gjithë ata që janë jashtë këtyre ambienteve ku e kanë mbështetjen e këtij ligji do të duhej të interesoheshin dhe të japin kontribut që ky ligj të jetë i kompletuar, të jetë gjithëpërfshirës dhe sa më në gjerësi t'i plotësojë nevojat e fushës përkatëse.

Politikat e përkujdesjes ndaj shëndetit mendor - Ky ligj do të duhej t'i ketë në fokus të parë dhe pastaj fokusi i dytë do të duhej të ishte edhe shpërblimi special i personelit në shërbimin shëndetësor, si dhe në fokus të ligjit, ndoshta është jashtë natyrës së tij, do të duhej të ishte edhe konceptimi i nevojave të hapësirave dhe ambienteve të përkujdesjes ndaj atyre që duhet të gëzojnë përkujdesje profesionale, sepse shumë herë, kur jam gjendur në një ambient ku ka njerëz, të cilët kanë nevojë për përkujdesje të këtij ligji dhe për përkujdesje shëndetësore dhe të gjithë ndoshta kemi kaluar aty nëpër atë ambient, jemi ndie keq, në aksin rrugor Duhël - Shtime, në hyrje të Shtimes. Secili prej nesh nuk është ndie mirë, dhe unë për veten time sa herë kam kaluar aty kam thënë do ta bëj temë në Parlament, por nga që ne, me këtë situatë që e kemi, edhe po flas për këtë kohë prej kur jam deputet, kur nuk kam qenë deputet sa herë jam ndie keq andej, por prej kur jam deputet sa herë që kam kaluar në këtë aks rrugor, pranë këtij institucioni...

KRYESUESI: Halit, për ligjin fol, jo përjetim personal! Për ligjin, të lutem shumë!

HALIT KRASNIQI: Gjithë komisionin, gjithë njerëzit kanë mundësi të kontribuojnë në ligj dua t'i sensibilizoj që në këto ambiente, sepse unë Prof. nuk jam, as mjek dhe shqyr Zotit nuk e kam dikë të afërt në këto institucione, por duke kaluar pranë tyre jam vetëdijësuar që qasja jonë nuk është në nivel ndaj këtyre.

Një herë së pari, por edhe personal, edhe ata nuk trajtohen. Madje-madje jo vetëm që nuk trajtohen dhe jo vetëm që nuk zvogëlohen shqetësimet e tyre, por në disa institucione, sikur në Shtime, bëhen burim i shqetësimeve të qytetarëve.

Unë për veten time kur kam kaluar aty për një kohë të gjatë s'kam mund të vijë në vete dhe prandaj duhet të mendojmë edhe për të siguruar ambiente dhe hapësirë për afrimin e nevojave dhe për plotësimin e gjithë atyre që quhen përkujdesje shëndetësore e profesionale për njerëzit me nevoja të veçanta dhe me të meta mentale.

Për veten time, jam shumë i vendosur dhe shumë i vetëdijshëm që ambientet ndoshta janë kushti kryesor, edhe për ata që janë aty brenda, edhe për të tjerët që janë përreth, sepse në hyrje të një vendbanimi, në hyrje të një komune, në hyrje të një qyteze dhe në një ambient kaq të frekuentuar të jenë njerëzit të kacavjerrë nëpër hekura aty, dhe të komunikojnë me publikun, pa probleme mendore, natyrisht se, në qoftë se rriturit do të kalojnë pa trauma, te fëmijët nuk kalojnë pa u traumatizuar.

Prandaj, njëri nga këto kushte që duhet t'i parashohë ligji do të duhej të ishte edhe ambienti ku trajtohen qytetarët, të cilët kanë nevoja për t'u afruar shërbime shëndetësore.

Prandaj, unë për veten time nuk e ndije veten kompetent. Desha vetëm ta ofroj këtë fakt që duhet ta kenë në konsideratë të gjithë ata që punojnë me këtë ligj dhe gjithë ata që janë në komisionin përkatës.

Unë për veten time e kam një fakt shumë relevant, që ministri i Shëndetësisë është specialist i kësaj fushe dhe jam shumë i bindur që ky projektligj është i kompletuar dhe ligji nuk do të kalojë në këtë Kuvend pa u plotësuar çdo boshllëk dhe çdo nevojë e fushës përkatëse.

Prandaj, edhe nuk e kam pa të nevojshme të shfletoj diçka më shumë dhe të përkushtohem më gjatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Prej kur pas lufte kem punuar së bashku në krijimin e një sistemi të ruajtjes së shëndetit mendor, unë jam i vetëdijshëm për kontributin tuaj personal për çdo pozicion që keni qenë, duke filluar prej pozicionit të psikiatrit deri te pozicioni i udhëheqjes për të kontribuar dhe participuar në këtë drejtim dhe për ta ngritur cilësinë e ruajtjes së shëndetit mendor në Kosovë.

Isha fokusuar vetëm te dy çështjet tipike në njëfarë mënyre, që edhe i përmendi parafolësi, te kujdesi shëndetësor dytësor edhe tretësor. Besoj që është koha e fundit edhe besoj, zoti ministër, që me këtë ligj do t'u mundësohet për ta shkarkuar klinikën tonë psikiatrike prej pacientëve që duhet trajtuar si problem i shëndetit dytësor dhe klinika jonë të kalojë në institucion i cili është i thirrur për t'u marrë me hulumtime shkencore dhe për t'u marrë me fazën përfundimtare të trajtimit të çrregullimeve, të cilat nuk mund të menaxhohen në institutet dhe repartet psikiatrike të shkallës së dytë.

Intenca jonë e përbashkët dhe frymëzimi ynë ka qenë gjithnjë që të krijojmë aso politika që pacienti të jetë në rrethin familjar, në mesin ku është rritur, ka vepruar dhe vepron.

Ju kisha lutur që me këtë ligj ta definoni a do të orientohe mi për të pasur spital psikiatrik tipik në formën klasike, si të gjitha shtetet tjera, por nganjëherë është edhe i domosdoshëm në njëfarë mënyre edhe një pjesë e spitalit psikiatrik apo Institucioni Psikiatrik në Shtime, se ato de fakto janë dy institucione, shumë qytetarë, por edhe kolegë këtu nuk e dinë. Ndoshta në njëfarë mënyre pa dashje është lënë pas dore, duke u orientua për politika që të gjithë ata pacientë apo klientë do t'i kthejmë në njëfarë mënyre në ambientin primar dhe të jetojnë pranë familjes, apo në shtëpia integruese. Në qoftë se jo dhe në qoftë se në bazë të indikatorëve të cilët janë matës në Kosovë edhe mund të maten, në qoftë se kemi nevojë për spital psikiatrik, atëherë të krijojmë politika të tilla që të investojmë më shumë, në mënyrë që ta ngremë cilësinë prej edukimit të kuadrove për të punuar me pacientë me çrregullime mendore deri te përmirësimi dhe kualiteti i të ardhurave të tyre në çdo periudhë kohore.

Në institucione të tilla kanë pasur jo benificione tjera, sa benificione financiare për t'i motivua njerëzit për të punuar në spitale psikiatrike. Ndoshta të është dhënë mundësia dhe e di që do t'i shfrytëzosh të gjitha kapacitetet që mënyrën optimale të gjendet zgjidhja që do na e kishte lehtësuar jetën, por edhe pacientëve tanë në të ardhmen, qoftë ata që jetojnë nëpër shtëpi integruese, qoftë ata që ndoshta detyrimisht duhet për një kohë të trajtohen në spital psikiatrik, mirëpo le të jetë kjo politikë më e qartë dhe të orientohe mi në investime në atë drejtim.

Tjetër është edhe çështja e institutit për shërbim prej varshmërive, posaçërisht prej drogës. Unë ju kisha lutur juve personalisht, do ta keni ndihmën e të gjithë deputetëve që të investojmë në sasi edhe të mjeteve financiare dhe të edukojmë kuadro për të punuar në atë drejtim. Është domosdoshmëri e kohës. Të mos manipuloj me numra, por janë duke u përfolur numra të përdoruesve të drogës prej 5 000 deri në 20 000. Ndoshta edhe organizatat joqeveritare për përfitime të tyre nganjëherë i ndryshojnë ato shifra, mirëpo problemi i drogës dhe problemi i varshmërisë prej drogës është evident në shtetin tonë.

Ndoshta investimet në institut që është i specializuar për trajtimin e tyre, çrregullimeve të këtyre klientëve është domosdoshmëri e kohës, ani pse ndoshta është njëfarë stigmatizimi edhe dëshira për t'i ikur atij stigmatizimi në njëfarë mënyre na ka bërë që të mos merremi drejtpërdrejt me të.

Dhe, e treta, po e përfundoj - mjekësia ligjore te shëndeti mendor, a do të jetë drejtpërdrejt në kuadër të suazave të shëndetit mendor, apo do të jetë institucion i bashkangjitur me institucionet e sigurisë edhe gjyqësisë? Besoj që duhet bërë një diferencim edhe në ndarje të tillë momentalisht është një përzgjidhje mund të them edhe e kompetencave, të pasojave të tyre, apo më mirë të thuhet e produkteve të punës së tyre, se nuk është e definuar mirë dhe kompetencat e saj po i merr në periudha të ndryshme kush është më i fortë politikisht, pa e përdorur mekanizmin juridik. Faleminderit!

KRYESUESI: Folësi i fundit është Shaip Muja.

SHAIP MUJA: I nderuar kryesues!

Nga parafolesit u plotësuan shumë vërejtje të cilat i kishim dhe na jepet mundësia po ashtu edhe në amendamente.

Përveç një adresimit në shërbimin primar të shëndetit mendor, mendoj që ka vend për t'u plotësuar, sepse është me rëndësi që të ceket a e kupton Ministria shërbimin primar publik, apo miks, sepse edhe privat ka primar, dhe si do të inkorporohet ajo, me të gjitha standardet e barabarta me publikun, apo në çfarë forme? Mendoj që në ligj duhet të zërë vend, sepse është njëra ndër portat kryesore të këtij shërbimi, për të mos thënë pjesa më plotësuese edhe e angazhimeve dhe e standardeve që i keni sjell në ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, urdhëro!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për mbështetjen që e dhatë për Ligjin për shëndetin mendor. I falënderoj të gjitha grupet parlamentare.

Për të ju informuar, ta keni një element më tepër - në lëmin e shëndetit mendor në Kosovën e pasluftës është bërë me siguri më shumë se në çdo lëmi tjetër të shëndetësisë kosovare.

Në qoftë se është ndryshuar një realitet në një lëmi të shëndetësisë, atëherë ky ka qenë shëndeti mendor.

Sistemi i shërbimeve të shëndetit mendor në komunitet, me qendrat e shëndetit mendor, me shtëpitë për integrim nuk ka ekzistuar përpara në Kosovë. Sot e kemi në realitet.

Unë ju kisha lutur po që se mundeni, në qendrat ku jeni, nga qendrat ku vini, në qendrat rajonale dhe qendrat e shëndetit mendor, 11 shtëpi për integrim t'i vizitoni dhe të shihni se bëhet fjalë për një standard evropian të trajtimit.

Ne i kemi ikur rrezikut të madh që në vitet e para të pasluftës të kemi spital psikiatrik dhe jemi shteti i vetëm në rajon që nuk ka spital psikiatrik, të cilin janë duke u munduar ta mbyllin të gjitha shtetet në rajon. Por, kjo nuk do të thotë se këtu është lule dritë çdo gjë. Kemi ende mungesë të kapaciteteve infrastrukturore, kemi nevojë për investime në Entin

Special në Shtime, patjetër për një kategori të veçantë të pacientëve me retardime të rënda mendore dhe me çrregullime tjera psikiatrike.

Prandaj, mbështetja juaj është e domosdoshme në këtë drejtim dhe shëndeti mendor me siguri se do të vazhdojë të jetë prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë edhe në periudhën e ardhshme kohore.

Instituti i sëmundjeve të varësisë do të fillojë sivjet të ndërtohet në Kosovë me mjetet e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa me mjetet e Bashkimit Evropian është kah përfundon Instituti i Psikiatrisë Ligjore si institucion shëndetësor, i cili do të jetë i menaxhuar nga Ministria e Shëndetësisë. E dini mirë që edhe Departamenti i borxheve ka dalë në kompetencën e Ministrisë së Shëndetësisë, prapë si një arritje e një standardi evropian.

Por, dua të theksoj se roli i Ministrisë së Drejtësisë në këtë proces do të jetë po ashtu i rëndësishëm dhe do të jetë një bashkëpunim konstruktiv në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Kolege deputete,

Regjia bëhu gati për ta votuar këtë projektligj. Ju lutem, votojmë tash!

I kemi 68 deputetë në sallë.

Konstatohet se me 64 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për shëndetin mendor.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia sjellin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zoti Nenad Rashiq, që para deputetëve ta paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine potpredsjedniče!

Dame i gospodo narodni poslanici,

Nacrt zakona o izmeni i dopuni zakona broj 03/Z-019 za osposobljavanje, kvalifikovanje i rekvalifikovanje i zapošljavanja osoba sa ograničenim sposobnostima za koje je sponzor Ministarstvo za rad i socijalne zaštite, a i moj uvodni govor ima za cilj da pruža neka potrebna objašnjenja u vezi pomenutog Nacrta zakona.

Pravo na rad i osposobljavanja bez diskriminacije je poznato pravo u svetu sa međunarodnom konvencijom rada i konvencijom ličnih sposobnosti, i jedno od fundamentalnih zaštita ljudskih prava.

Društveno... principa ljudskih prava je preduslov za pravilno funkcionisanje demokratskog sistema radnih odnosa. Ova pravo takođe su garantovana sa Ustavom Kosova i drugim pravnim aktima o sposobnosti.

Kao što znate, profesionalno osposobljavanje i rekvalifikacija i zapošljavanje osoba sa ograničenim sposobnostima na Kosovu regulisano je zakonom 03/Z-019 za profesionalno osposobljavanje i resposobljavanje, zapošljavanje osoba sa ograničenim sposobnostima, koji čini zakon usvojen datumom 17. decembra 2008. godine a stupio na snagu 1.2.2009. godine.

Sa ovim zakonom regulišu se i određuju prava, uslovi, oblici profesionalnog osposobljavanja i reosposobljavanja i zapošljavanje osoba sa ograničenim sposobnostima, i njihova integracija u otvorenim tržištu rada pod opštim i specifičnim zahtevima navedenim u regulisanim zakonima.

S hodno svim ovim pozitivnim efektima, neki članovi ovog zakona su naišli na poteškoća u njihovoj praktičnoj primeni, kao što su politike za promovisanje zapošljavanja, posebno zapošljavanje i obuku osoba sa ograničenim sposobnostima koji su i dalje na niskom nivou u poređenju sa potrebama ekonomskog razvoja.

Zapošljavanje je jedan ključni elemenat za socijalno uključivanje i ekonomske nezavisnosti svih građana, bez diskriminacije u samom zapošljavanju.

Zaposlenost i stopa učešća osoba sa ograničenim sposobnostima je veoma nizak u poređenju sa drugim, imajući u vidu da ova kategorija građana je najsiromašnija, s toga trebamo učiniti napore da sprečimo negativan uticaj siromaštva na njihov status.

Što više Vlada Kosova priznaje neophodnost u institucijama ovih reformi u cilju razvijanja jednog sveobuhvatnog sistema za ograničenu sposobnost, tako da zakonodavstvo na snazi ulazi u obzir prava osoba sa ograničenim sposobnostima.

Iz svih razloga i postojećih mogućnosti, Ministarstvo za rad i socijalnu zaštitu na osnovu svog mandata je izradilo gore pomenuti Nacrt zakona koji ima za cilj približavanje naše zakonodavne politike sa onima iz zakonodavstva iz Evropske unije, konvencijama o pravima osoba sa ograničenim sposobnostima i drugim međunarodnim instrumentima.

Ove izmene i dopune ovog zakona imaju za cilj poboljšanje socijalnog i ekonomskog statusa, da obezbedi jednake mogućnosti i zapošljavanje osobe sa ograničenim sposobnostima u društvu sa drugim ograncima, te će se takođe poboljšati postepeno i uz pomoći same osobe sa ograničenim sposobnostima, tako će poboljšanje dolazi kao rezultat rasta ekonomskog nivoa u zemlji i same svesti javnosti. Ona održava volju Vlade Kosova za podršku osoba sa ograničenim sposobnostima u zajednici u kojoj žive.

Glavna pitanja koja su adresirana u procesu izmena i dopuna ovog zakona su: stvaranje mogućnosti za profesionalno osobljavanje, reosposobljavanje i zapošljavanje osoba sa ograničenim sposobnostima, u skladu sa ponudom i traženjem na tržištu rada.

Stvaranje mogućnosti za jedno produktivno zapošljavanje, slobodno i pogodno za osobe sa ograničenim sposobnostima, sa ciljem da se ostvare prihodi i ekonomsko osnažuje ove osobe. Podizanje svesti osoba sa ograničenim sposobnostima i podizanje svesti šire javnosti o mogućnosti i potencijalima za profesionalno osposobljavanje, reosposobljavanje i zapošljavanje takvih osoba.

U cilju očuvanja i zaštite prava osoba sa ograničenim sposobnostima u samom zapošljavanju, odredbe Nacrta zakona zasnivaju se u skladu sa direktivom 2000/78 Evropske komisije da se uspostavi opšti okvir za jedan tretman pri zapošljavanju i radu osoba sa ograničenim sposobnostima, kao i takođe Međunarodne konvencije o pravima osoba sa ograničenim sposobnostima.

Imajući u vidu postojeće okolnosti na Kosovu, mi se trudimo da kroz izmene zakona 03/Z-19 da se stvori jasan, jedan pozitivan i održivo okruženje za zapošljavanje osoba sa ograničenim sposobnostima.

I sasvim na kraju, želeo bih da naglasim da je u pitanju za jedan mnogo značajan zakonski akt, koji će regulisati i utvrđivati pravo na zapošljavanje ove kategorije građana, takođe sa posebnim naglaskom na smanjenje nezaposlenosti za osobe sa ograničenim sposobnostima na Kosovu.

Molim vas da kroz diskusije postavite mnjenje pomenutog predloga zakona, kao i podržite ove izmene zakona, koji mislim da daje dodatne mogućnosti osobama sa ograničenim sposobnostima. Kao jedan od dodatak, videćete u zakonu, mi smo zakon upunili na način da kompanije, koje iz bilo kojih tehničkih razloga nisu u stanju zaposle 2%, ili svakog 50 radnika da bude iz ove kategorije građana, dali smo jednu alternativu gde će ta određena institucija ili kompanija moći za to da uplaćuju nadoknadu u jednom posebnom budžetu, koji će biti usvojen za stvaranje uslova za zapošljavanje ovih osoba. Hvala puno!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Glauk Konjufca.)

KRYESUESI: Tash e hapim diskutimin në parim për ligjin në fjalë. Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zoti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit nënkryetar!

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2014, e shqyrtoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe vendosi që të paraqesë këtë:

REKOMANDIM

Të miratohet në parim Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara në nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe rekomandon për miratim në parim.

KRYESUESI: Tash është radha e grupeve parlamentare. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra,

Të nderur kolegë,

Ligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka monitoruar dhe ka rekomanduar që ky ligj ka nevojë të plotësohet dhe të ndryshohet, sepse ligji ka mangësi dhe në shumicën e rasteve nuk është zbatuar për shkak të të metave në ligj.

Shumica e rekomandimeve të komisionit janë të përfshirë në këtë projektligj, por ajo që është më e rëndësishme, mendoj se është neni 12, paragrafi 3.

Sipas këtij neni, punëdhënësi që nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 të nenit 12, që domethënë nuk punëson një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 të punësuar, punëdhënësi obligohet që për nxitje të punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguajë në llogari të veçantë në vijën buxhetore të buxhetit të Kosovës pagën mujore në lartësinë e shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës për çdo person me aftësi të kufizuar që do të duhej të kishte punësuar, e që në ligjin në fuqi është se punëdhënësi që i përmbush këto detyrime do të paguajë vetëm 1% të shumës së pagës mujore.

Gjithashtu, te ndryshimi i nenit 3, te përkufizimet, është e rëndësishme sepse është shtua një paragraf i ri, i cili thotë: “Subvencionet - është ndihma financiare, e cila i jepet punëdhënësit për arsye të punësimit të personave me aftësi të kufizuara”. Por, më tutje në projektligj nuk ka ndonjë nen që do t’u afronte përkrahje apo benficione punëdhënësve, të cilët punësojnë persona me aftësi të kufizuara.

Mendojmë që punëdhësit të cilët po punësojnë persona me aftësi të kufizuara duhet të stimulohen dhe do të duhej që kjo çështje në këtë ligj të rregullohet me një ligj të veçantë.

Ne si grup parlamentar do ta votojmë në parim projektligjin dhe kontributin tonë do ta japim në Komisionin Funksional. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e LDK-së, Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit!

I nderuar nënkryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara ka qenë i monitoruar nga Komisioni i Shëndetësisë, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe janë dhënë disa rekomandime, disa prej të cilave janë përfshirë në këtë projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin.

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe në parim do ta miratojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin e “Vetëvendosjes”, deputeti Faton Topalli e ka fjalën.

FATON TOPALLI: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta është një përpjekje që në rrafshin normativ t’u përafrohet praktikave ndërkombëtare për t’i mbrojtur liritë dhe të drejtat themelore të qytetarëve me nevoja të veçanta.

Në thelb, ligji kërkon aftësimin, riaftësimin, krijimin e mundësive për punësim dhe fuqizimin ekonomik të qytetarëve të Kosovës me nevoja të veçanta.

Ligji në fjalë ka për qëllim edhe vetëdijësimin e qytetarëve të goditur, por edhe të opinionit si tërësi me mundësitë dhe potencialin për çështje të cilave u dedikohet ligji.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” pajtohet për miratim në parim të projektligjit. Ndryshimet në ligj shënojnë një përmirësim të infrastrukturës ligjore për personat me nevoja të veçanta.

Edhe pse ligji në fjalë në tërësi është shpresëdhënës dhe nga ana normative krijon përshtypjen e përpjekjes për ndryshime përmbajtjesore, në praktikë është vështirë i realizueshëm.

Qeveria e Kosovës ka sponsorizuar dhe po sponsorizon një varg ligjesh që në përmbajtje janë të mira, por nuk kanë krijuar bazën që ligjet e sponsorizuara të gjejnë zbatim në praktikë.

Në fakt, aftësimi dhe riaftësimi profesional është një objektiv që mund të realizohet, por punësimi i personave me nevoja të veçanta është një qëllim që në këto kushte mbetet më shumë dëshirë se sa qëllim që mund të realizohet.

Gjendja ekonomike në të cilën gjendet vendi ynë, e të cilën e ka sjellë kjo Qeveri lë pak mundësi, e sidomos duke pasur parasysh edhe mungesën e vullnetit politik që qytetarët me nevoja të veçanta të punësohen në sektorin shoqëror dhe privat. Madje, vetë pushteti nuk zbaton obligim ligjor që çdo i 50-ti i punësuar të jetë qytetar me nevoja të veçanta.

Që kjo situatë të ndryshojë dhe ligji të jetë i zbatueshëm duhet të ndërmerren masa konkrete që garantojnë zbatimin e ligjit, sidomos në pjesën që ka të bëjë me aftësimin profesional dhe vendet e garantuara të punës.

Qeveria e Kosovës duhet të krijojë kushte për themelimin e ndërmarrjeve publike në nivel komunal, të cilat do të merrnin përsipër një varg punësh, të cilat do të mundësonin që këta qytetarë t'i kryejnë këto punë.

Këto ndërmarrje, përveç që do të mund ta jepnin një kontribut për punësimin e tyre, do të ishin edhe institucione të cilat do të mundësohej njëkohësisht edhe kualifikimi praktik, profesional, respektivisht ngritja e kompetencave profesionale për punë të caktuara. Ndërmarrjet e tilla do të mund të vetëfinancoheshin nga puna që do të merrnin nga qeverisjet komunale, por edhe nga sektori privat.

Meqë ligji flet për praktika ndërkombëtare, kjo formë e sigurimit të vendeve të punës dhe kualifikimit të qytetarëve me nevoja të veçanta është një praktikë ndërkombëtare e suksesshme, e realizuar në shumë vende të Evropës Perëndimore.

Një mundësi tjetër është që zyrat e prokurimit gjatë tenderimit t'u japin përparësi atyre ndërmarrjeve, të cilat e kanë një numër të caktuar të punësuar të qytetarëve me nevoja të veçanta.

Pa masa konkrete në praktikë, pa vullnet politik për t'i ndërmarrë këto masa, ligji në fjalë do të mbetet në letër ashtu si shumë ligje të tjera të mira të vendit tonë që nuk zbatohen në praktikë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, Time Kadrriaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Sot komisioni ynë pati punë më së shumti se krejt ligjet qenë të profilit të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

E përshëndes ministrin që shumë shpejt e ka sjellë për plotësim-ndryshim këtë projektligj të rëndësishëm dhe që është bazuar në raportin e monitorimit të Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Rekomandimi i parë ka qenë pikërisht kjo që ky ligj, për shkak të mangësive të gjetura gjatë punës në terren, të vijë në seancën plenare për plotësim-ndryshim.

Ne si Grup Parlamentar do ta përkrahim dhe do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Koalicionin Kosova e Re, Suzan Novobërdaliu e ka fjalën.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Faleminderit ministër për sjelljen e këtij projektligji të rëndësishëm, Unë do të ndalem pak te neni 9, sepse më pëlqen ky ndryshim, të cilin e keni bërë në paragrafin 3. Mirëpo, në ligjin bazë, te paragrafi 2, ende qëndron që sektori privat, publik, organizatat joqeveritare, organet e administratës shtetërore ta punësojnë në çdo 50 punëtorë një person me aftësi të kufizuara.

Pikërisht me këtë paragraf të ligjit bazik, apo me këtë pikë nuk pajtohem, sepse keni sektor të ndryshme, të cilët punësojnë për shembull deri në 49 punëtorë dhe realisht i ikin pagesës, të cilën ju tani e keni paraparë, do të thotë pagës minimale të punësuar për një person. Do të thotë, mendoj se, edhe pse kam edhe informacione se në draftin e parë ju e keni pasur që në çdo 25 punëtorë të punësohet personi me aftësi të kufizuara, drafti juaj i parë ka qenë kështu, edhe pse ne në Parlament nuk na ka ardhur i njëjti, por në ndërkohë është ndryshuar dhe prapë është bërë i 50-ti.

Këtë e keni pasur në bashkëpunim me organizatat e personave me aftësi të kufizuara dhe tani propozoj që i njëjti të ndryshohet. Këtë do ta japim si propozim në komisionin përkatës, që çdo i 25-ti të jetë person me aftësi të kufizuara, nëse nuk punësohet do të thotë sektorët të kenë më shumë obligim të paguajnë thjeshtë sipas nenit 3. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e merr deputetja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

U bashkëngjitëm të gjithëve që e lavdëruan Ministrinë për Punë dhe Mirëqenie Sociale që na e sjell një variant të re të Ligjit për punësim, aftësim, riaftësim dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara.

Vërejtjet e mia kanë të bëjnë pikërisht me faktin që Komisioni për Punë dhe Mirëqenie Sociale e ka monitoruar këtë ligj dhe ka nxjerrë konkluzione, të cilat janë votuar edhe në Kuvendin e Kosovës.

Këto konkluzione sikur nuk janë marrë plotësisht, edhe pse dikush tha se janë marrë, por unë mendoj që nuk janë marrë plotësisht parasysh kur është nxjerrë ligji. Sigurisht, ndryshimi i ligjit ka filluar më herët dhe nuk është koordinuar mirë.

Për ta arsyetuar këtë nuk do të merrem me secilin rekomandim, por do t'i përmend vetëm tri raste.

Një ndër rekomandimet ka qenë jo sikur që ishte në ligjin e parë, çdo i 50-ti i punësuar të jetë person me aftësi të kufizuara dhe i aftësuar për punë, por çdo i 25-ti. Dhe, arsyetimi është se ne kemi shumë pak ndërmarrje të vogla që punësojnë 50 punëtorë dhe shumica mund të jenë deri 25. Ky ligj kështu është edhe në regjion.

Një vërejtje tjetër është llojllojshmëria e profesioneve që ofrohen në qendrat për rehabilitim, ose aftësim profesional. Konkluzion i monitorimit ka qenë se është e nevojshme më shumë profesione për aftësim dhe një konkurrencë ndryshe në tregun e punës. Gjithashtu duhet të hyjë edhe kjo.

Një pengesë që është parë gjatë monitorimit ka qenë pengesa e Inspektoratit të Punës për t'i dënuar ata që nuk punësojnë dhe duhet ta paguajnë gjobën, sepse ka munguar adresa ku t'i dërgojnë këto mjete.

Tani me ligji e ri thuhet se do të nxirret akti i veçantë nënligjor, i cili do ta mundësojë këtë. Ju lutem, ministër, ne e kemi pasur një mandat kur është nxjerrë ky ligj dhe pse nuk u nxor një akt nënligjor që edhe deri tani të mundësohet pagesa?

Unë mendoj që me amendamentimin e të gjitha konkluzioneve të votuara në Parlamentin e Kosovës, plotësohet më shumë ky ligj, e pra plotësohet edhe obligimi i Ministrisë që brenda një afati shumë të shkurtër, saktësisht ndoshta për 3 muaj, ju t'i nxjerrin aktet nënligjore që të dënohen ato ndërmarrje, të cilat nuk e kryejnë obligimin për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “6+” është paraqitur shefja e Grupit Myfera Shinić.

MYFERA SHINIĆ: Teşekkür ederim.

Bu Yasa Tasarısındaki ekleme ve tamamlamaları Kosovadaki gençlerimizin mesleki eğitim, eğitimi tamamlama ve engelli vatandaşlarımızın ve çalışmayan gençlerimize işbulma kurumları tarafınca altı aylığına düzenlenen kurslar, eğitim programları öngörülüyor.

Bu da çalışmayanlar için engelli vatandaşlarımızın istihdam, hem de ekonomi bağımsızlığını sağlayarak topluma entegre olmalarına yardımcı olmaktadır.

Bundandır bu Yasa Tasarısına ekleme ve tamamlamaların yapılmasını “6+” Parlamenter Gurubu olarak desteklemekteyiz.

Teşekkür ederim!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Kymete Bajraktari e ka fjalën.

KYMETE BAJRAKTARI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është një përpjekje për ta avancuar bazën ligjore.

Kjo përpjekje për ta avancuar ligjin në vetvete ngërthen krijimin e mundësive për punësimin e personave me aftësi të kufizuara në harmoni me kërkesën në tregun e punës, krijimin e mundësive për një punësim produktiv dhe ngritjen e vetëdijes të personave me aftësi të kufizuara dhe opinionit.

Ky projektligj përmban tri komisione: Komisionin Mjekësor, i cili është formuar dhe miratuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale; Komisionin për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe Komisionin për vlerësimin e aftësisë punuese. Uroj që këto komisione të formohen nga ekspertët e trajnuar, e jo sikur ka ndodhur në shkollat që vlerësimin e aftësive të kufizuar e kanë bërë mësimdhënësit, me gjithë formimin e ekipeve për vlerësim për aftësinë e kufizuar nga MASHT-i në vitet paraprake.

Cilat ministri do të jenë përgjegjëse për shërbimet e riaftësimit profesional? Nuk është e paraparë nga kush do të sigurohen këto shërbime, kur dihet se ky ligj ka ndikim financiar, i cili ka kosto shtesë për Buxhetin e Kosovës dhe nuk është planifikuar në kornizën buxhetore 2014-2016, edhe pse llogaritet se do të krijohen të hyra vetjake nga zbatimi i ligjit, të cilat konsiderohen të hyra të përgjithshme dhe do t'i takojnë Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Po supozojmë se zbatimi i këtij ligji do të krijojë të hyra vetjake, të cilat do të jenë në shërbim të kësaj kategorie. Unë dyshoj se ky ligj do të fillojë të zbatohet, sepse te ne është bërë modë moszbatimi i ligjeve, edhe atëherë kur kanë buxhet të ndarë për zbatim. Rast konkret e kemi Ligjin për personat e verbër.

Cilat janë masat sanksionuese, të cilat do të aplikohen për sektorin publik dhe privat për moszbatimin e ligjit?

Ligji hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. E pyetja ime është: Kur do të fillojë të zbatohet ky ligj në vitin 2014, 2015, apo 2016? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Agim Kuleta e ka fjalën.

AGIM KULTETA: Faleminderit, zoti kryesues!

Dua të flas më shkurt, duke qenë se më pas e kemi edhe një ligj shumë të rëndësishëm.

Sa i përket paragrafit 2 të nenit 12 të ligjit bazik, i cili thotë se çdo punëdhënës është i obliguar ta punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punëtorë, pajtohem me deputeten Novobërdaliu, sepse edhe ne konsiderojmë se duhet të ndryshohet dhe të bëhet ashtu siç ka qenë edhe synimi fillestar i këtij plotësim-ndryshimi. Pra, obligimi për punësimin e një personi me aftësi të kufizuara të jetë çdo i 25-ti. Këtu më duhet të denoncoj një pasaktësi në materialin shoqëruar të këtij projektligji, përkatësisht në listën

e përgjigjeve të dhëna nga grupet e interesit, midis të cilave është edhe organizata Handikos.

Në këtë listë thuhet se Handikos pajtohet me kuotën 1:50, gjë që është e pasaktë sepse pikërisht kjo organizatë në komunikime me ministrinë gjatë fazës së përgatitjes së projektligjit ka kërkuar që raporti të jetë 1:25.

Propozimi i dytë ka të bëjë me paragrafin 3 të nenit 12 të ligjit bazik. Në projektligj e kemi një ndryshim cilësor, kur kemi të bëjmë me lartësinë e pagesës së formë të kontributeve mujore nga punëdhënësi. Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve që bëhet nga paragrafi 1 dhe 2 të nenit 12, me ç'rast nga 1% e shumës së pagës minimale, sa ka qenë në ligjin bazik, është ngritur në një pagë minimale.

Mirëpo, konsideroj se këtu ka nevojë të definohet qartë destinacioni i këtyre të hyrave. Pra, ne konsiderojmë që të hyrat që derivojnë nga çështjet që kanë të bëjnë me këtë komunitet t'i dedikohen po këtij komuniteti, e të mos veprohet me logjikën e njëjtë siç është vepruar me taksën ekologjike.

Edhe në këtë projektligj do ta votojmë në parim dhe këto propozime do t'i dërgojmë në formë të amendamenteve në komisionin përkatës.

KRYESUESI: Faleminderit! Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më vjen mirë që komisioni dhe ministria tashmë veç kanë rekomanduar që ky projektligj i plotëson kushtet për plotësim-ndryshim, sepse unë edhe ashtu ia kam drejtuar Kryesisë së Kuvendit një kërkesë që të kemi debat parlamentar lidhur me gjendjen e personave me aftësi të kufizuara dhe që ka të bëjë pikërisht me mosimplementimin dhe zbatueshmërinë e ligjeve që kanë të bëjnë me këtë kategori.

Të nderuar, desha të them që prej miratimit të ligjit nga data 1 shkurt 2009, edhe pse nuk e di a e tha ministri, apo përkthimi erdhi që ky ligj është miratuar më 1 shkurt të vitit 2010, kur ka hyrë në fuqi, ky ligj nuk është respektuar dhe vazhdimisht ka qenë pjesë e diskutimit të gjetjes së mënyrave për zbatueshmëri praktike. Me vetë faktin e kthimit dhe plotësim-ndryshimin e këtij ligji, lë të kuptohet se ky ligj na faton dhe na jep argumente dhe nga vetë tregu i punës se personat me aftësi të kufizuara nuk janë konsideruar se pjesë produktive e tregut të punës.

Arsyet e plotësimit dhe kthimit të leximit të këtij ligji në Parlament na obligojnë, njëherësh na japin edhe një vërejtje që të jemi vigjilentë në zbatimin e këtij ligji.

Pas leximit të ndryshimeve të bëra nga komisioni, i cili ka bërë amendamentimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/L-019, unë jap disa rekomandime, disa veç u përmendën edhe nga parafolësit e mi, por mendoj që nuk është

ndoshta keq edhe nëse përsëriten, sepse jemi këtu për ta bërë më të mirën e mundshme për këtë kategori të njerëzve.

Neni 9, paragrafi 2, ku është “çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo 25 punëtorë”, është mirë të hiqet fjala “është” dhe të mbetet vetëm “çdo punëdhënës obligohet të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo 25 punëtorë”.

Neni 9, paragrafi 3, punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 2 i këtij neni obligohet që për nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara të paguajë në Buxhetin e Kosovës kontributet mujore në lartësi prej 20% të shumës së pagës minimale për çdo person me aftësi të kufizuara që duhet të kishte të punësuar.

Te ky paragraf të krijohet përfundimisht xhirollogaria e grumbullimit të mjeteve që do të sanksionojë për mospunësim të personave me aftësi të kufizuara me 20% sa është paraparë në këtë paragraf dhe këto mjete të shfrytëzohen për krijimin e kushteve të përshtatshme të punësimit për të verbrit, qasje e përshtatshme për personat me aftësi fizike si dhe interpretimi i gjuhës së shenjave, e kështu me radhë.

Njëkohësisht, mjete nga ky fond t’u jepen edhe shoqatave që ofrojnë shërbime specifike nëpërmjet kërkesës dhe nevojave të tyre, për çka jemi dëshmitarë të gjithë se shoqatat të cilat merren me këtë kategori njerëzish, ose me organizimin dhe trajtimin e çështjeve të personave me aftësi të kufizuara bëjnë një punë pothuajse kryekëput vullnetare. Prandaj, ia vlen që si shoqëri dhe si shtet t’i stimulojmë dhe t’i falënderojmë për kontributin e tyre që janë duke e dhënë në integrimin e këtyre njerëzve në shoqërinë tonë.

Gjithashtu vlen të theksohet se deri më tani, me sa kam informacione dhe kam mundur të vërej, është e vetmja Ministria për Kulturë, Rini e Sport, e cila ka shënuar një progres në plotësimin e këtij standardi për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Prandaj, edhe pse kjo nuk është e kënaqshme dhe e mjaftueshme, mendoj që institucionet e Republikës së Kosovës duhet të marrin si shembull dhe të punojnë në drejtimin që të gjitha institucionet, sidomos këto publike, ta plotësojnë këtë standard që kërkohet, sepse mendoj që duke respektuar dhe vlerësuar këtë kategori njerëzish e respektojmë shtetin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Halit Krasniqi, tre minuta! Me kujdes do të dëgjojmë Halit, dhe po votojmë.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Nuk do të ndalem te ndonjë pjesë e veçantë e projektligjit, por do të konkludoj edhe ato që i përmban projektligji, por edhe ato shqetësime që i dëgjova nga të tjerët parafolës këtu.

Ky ligj duhet të plotësohet edhe më shumë me legjislacionin e shteteve të BE-së dhe të përafrohet plotësisht me praktikën evropiane.

Nga praktikat evropiane jemi shumë larg, edhe në edukim, edhe në trajtimin e kësaj kategorie të shoqërisë sonë, dhe sidomos në sjellje dhe përkujdesje ndaj saj, si shtresë shumë specifike.

Njerëzit me aftësi të kufizuara, si dhe sjellja jonë ndaj tyre, janë edhe një test i ndërgjegjes sonë njerëzore. Ndërsa qasja jonë ndaj nevojave të tyre është barometri i edukimit tonë të përgjithshëm, edhe po të jemi në nivel të tyre me ndërgjegje dhe edukatë.

Njerëzit me nevoja të veçanta kanë nevojë të domosdoshme të trajtohen me ligj të kompletuar nga nevojat e tyre për edukim e deri te nevoja e patjetërsueshme, e padiskutueshme për punësim.

Unë mendoj që edhe të tjerët që dhanë kontribut këtu, edhe ky konkluzion dhe sintetizim i gjithë atyre nevojave që paraqet dhe i ngërthen kjo shtresë e shoqërisë sonë, për momentin edhe deri në leximin tjetër është e mjaftueshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Rezymenë e Halitit e dëgjuat. Bëhuni gati për votim. I kemi 65 deputetë. E votojmë ligjin!

Konstatohet se me 64 për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin dhe rekomandime.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimin shëndetësor

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës ia ka rekomanduar miratimin e tij në parim.

E ftoj ministrin e Shëndetësisë, zotin Ferid Agani, që para deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës të paraqesë dhe ta arsyetojë këtë projektligj.

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuari zoti Ministër,

Kam kënaqësi të veçantë që para jush ta paraqes për miratim Projektligjin për sigurimin shëndetësor, aktin e shumëpritur juridik, i cili do të mundësojë ndarjen përfundimtare të shëndetësisë kosovare nga funksionimi në rrethanat e nënfinancimit të rëndë, si dhe do të mundësojë avancimin e saj drejt sistemeve bashkëkohore evropiane nëpërmjet sigurimit të financimit të qëndrueshëm në të gjitha nivelet e funksionimit dhe në të gjitha format e pronësisë.

Projektligji i cili sot është para jush paraqet pjesë të rëndësishme të kornizës gjithëpërfshirëse legislative, e cila siguron zbatimin e suksesshëm të reformës të sistemit shëndetësor të vendit. Kjo kornizë reformuese legislative, pjesë e së cilës janë edhe Ligji i shëndetësisë, Ligji për odat e profesionistëve shëndetësorë, Ligji për produkte medicinale dhe pajisje mjekësore, që do të miratohet shpejt në Kuvend, dhe Ligji për kontrollin e duhanit, krahas ligjeve që u miratuan në dëgjimin e parë sot, është punuar në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë faktorët relevantë vendimmarrës vendorë dhe ndërkombëtarë dhe e ka mbështetjen e tyre.

Si pjesë esenciale e kësaj kornize reformuese legislative, Projektligji për sigurimin shëndetësor, për shkak të ndjeshmërisë së tij, kompleksitetit, si dhe ndikim substancial në ekonominë e vendit, e ka pasur rrugën më të gjatë të elaborimit dhe të miratimit, duke qenë edhe subjekt i diskutimeve intensive me Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, si pjesë e fazave të ndryshme të marrëveshjeve të Qeverisë së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Ky projektligj gjatë tre vjetëve të elaborimit ka kaluar nëpër disa faza të debatit gjithëpërfshirës publik, në të cilin kanë marrë pjesë shumë faktorë relevantë vendorë, përfshirë shumë organizata të shoqërisë civile. Njëkohësisht, projektligji ka qenë subjekt i diskutimeve të shumta në institucionet relevante ndërkombëtare, si dhe në veçanti me ekspertët e Bankës Botërore, organizatat botërore të shëndetësisë, si dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

Me kënaqësi mund t'ju siguroj se ekziston përkrahja e plotë për zgjidhjet e propozuara ligjore, të cilat shpresoj se do të ndihmohen në shtetin e Kosovës, që brenda periudhës sa më të shkurtër kohore të sigurojë njërin prej standardeve më të larta ndërkombëtare në shëndetësi, qasjen universale ndaj shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit pa asnjë diskriminim, si liri dhe e drejtë themelore e njeriut.

Projektligji është në pajtim të plotë me deklaratën e politikave prioritare afatmesme të Qeverisë së Kosovës 2014-2016, si dhe me Planin e Veprimit të Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit me Komisionin Evropian.

Me këtë projektligj, sigurimet shëndetësore në Republikën e Kosovës organizohen dhe zbatohen si sigurime shëndetësore të obligueshme dhe sigurime shëndetësore vullnetare. Sigurimi shëndetësor i obligueshëm është e drejtë dhe detyrim për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit. Sigurimi shëndetësor i obligueshëm përfshin shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor dhe ofrohet vetëm nga fondi i sigurimeve shëndetësore, që themelohet me këtë ligj.

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj rregullohet themelimi, organizimi, funksionimi dhe financimi i sistemit publik të sigurimeve shëndetësore, si dhe të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira në këtë sistem. Miratimi i Ligjit për sigurim shëndetësor do të mundësojë sigurimin e qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës dhe shërbimeve ndaj shërbimeve cilësore shëndetësore; realizimin e mbrojtjes financiare nga

varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor për qytetarët dhe banorët, me theks të veçantë në kategoritë e varfra, nivelin e garantuar të vëllimit dhe të cilësisë të shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët dhe banorët; themelimin, organizimin, funksionimin dhe financimin e sistemit publik të sigurimeve shëndetësore; organizimin, drejtimin dhe mbikëqyrjen e fondit të sigurimeve të sigurimeve shëndetësore; themelimin e organizatave private për sigurim shëndetësor vullnetar; të drejtat dhe obligimet e të gjitha palëve për sigurimin shëndetësor të obligueshëm; burimet e mjeteve për financimin e sektorit shëndetësor në vend dhe kontraktimin e shërbimeve shëndetësore nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë.

Miratimi i Ligjit për sigurime shëndetësore paraqet mundësi reale për përmirësimin përmbajtësor të gjendjes në sektorin shëndetësor, duke mos ndikuar në qëndrueshmërinë fiskale të vendit. Ky ligj do të mundësojë zbatimin e sistemit të kombinuar të financimit të shëndetësisë kosovare, duke mbindërtuar sistemin ekzistues të financimit të centralizuar nga buxheti, në skemën e pagesës së premiumeve të obligueshme të shërbimit shëndetësor nga burimet, të cilat në vitin e parë, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërmjet të tjerave, do të jenë si në vijim:

1. Të gjithë të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin publik, si dhe publiko-privat dhe privat, me ndërmarrjet që kanë qarkullim më të madh se 50 000 euro në vit, ose të cilat janë të regjistruara për tatimin në vlerë të shtuar, do të paguajnë 7% nga të ardhurat bruto, të ndarë në pjesë të barabarta ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, çdo njëri nga 3,5%.
2. Të punësuarit e tjerë në sektorin privat, pra në ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, si dhe qytetarët dhe banorët, të cilët nuk janë të regjistruar si të punësuar, por kanë të ardhura të tjera, do të paguajnë nga 3,5 euro për një anëtar të familjes për çdo muaj.
3. Për qytetarët dhe banorët e liruar nga çdo formë e bashkëfinancimit, sipas Ligjit për shëndetësi L-125- 2013, pagesa e premiumit të sigurimit të obligueshëm shëndetësor do të bëhet me transfere financiare nga buxheti i vendit.

Projektligji ka 7 krerë, me gjithsej 41 nene dhe mbulon një sferë, e cila nuk ka pasur akte rregullative deri më tani.

Të nderuara deputete dhe deputetë,

Siç jeni në dijeni, miratimi i këtij projektligji ka paraqitur sfidë shumëvjeçare për institucionet e vendit, si për Qeverinë, ashtu edhe për Kuvendin e Kosovës. Prandaj, miratimi i tij si dokument i mbështetur nga faktorët vendimmarrës vendorë dhe ndërkombëtarë dhe si pjesë esenciale e reformës gjithëpërfshirëse të sistemit shëndetësor të vendit do të paraqesë sukses të madh të përbashkët dhe si të tillë ju ftoj që ta votoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E kemi një numër të madh, të konsiderueshëm të deputetëve, që duan ta diskutojnë këtë ligj. Unë nuk mund t'jua kufizojë kohën. Është e

juaja që të vendosni a doni kohë të përcaktuar për diskutim, apo nuk doni? Nëse ju doni që të koncentrohet eventualisht diskutimi në më pak minuta se dhjetë, sepse, po nuk u vendos ndryshe, dhjetëshi funksionon. Ju lutem, në emër të PDK-së, kush do të flasë? Zotëri Reçica e ka fjalën!

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Unë besoj që është një disponim i përbashkët që së paku ta përgjysmojmë atë kohë në 5 minuta maksimumi. Unë mendoj kështu. Nuk dua t'u futem tash atyre të cilët e kanë marrë fjalën ose dëshirojnë ta marrin fjalën, por mendoj se 5 minuta janë të mjaftueshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: PDK-ja mendon se 5 mjaftojnë, LDK-ja çfarë mendon? Pajtohet që 5 minuta mjaftojnë. “Vetëvendosja”, zoti Ymeri?

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Konsideroj që për shkak se është ligj i rëndësishëm, do të ishte mirë që të paktën atyre që flasin në emër të grupit t'u jepen nga 10 minuta, t'i paraqesin qëndrimet e grupit, e pastaj deputetët të diskutojnë nga 5 minuta, sepse do të ketë përsëritje sigurisht.

KRYESUESI: E qartë! “Vetëvendosje” i do dhjetë minuta për grupe dhe 5 për të tjerët. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Isufi?

AHMET ISUFI: 5 minuta janë të mjaftueshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Koalicioni Kosova e Re, zonja Myzejene?

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, nënkryetar!

5 minuta janë të mjaftueshëm për të gjithë.

KRYESUESI: Grupi “6+”?

MUFERA SHINIK: Njësoj kryesues, 5 minuta janë mjaft.

KRYESUESI: SLS, 5 minuta?

Zotërinj dhe kolegë deputetë, shumica e deputetëve thonë që 5 minuta janë të mjaftueshëm për të mos u përsëritur. Natyrisht, mund edhe 3, 2, he sa të doni më pak, nuk ka problem. Si ta shihni punën. “Vetëvendosje” kërkon që të jetë 10 minuta. Unë them të tjerët thuaja se u morëm vesh. “Vetëvendosja”, kur t'i vijë radha, i ka 10 minuta. A pajtoheni? Po shefat e grupeve! Po mirë, në dashi 10, ju po i doni 5. Mirë, u morëm vesh! U krye! A po e ndanë mendimin prej grupit, ti?

Fjalën e ka kryetari i Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni për Shëndetësi Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 4 shkurt 2014, e shqyrtoi në parim Projektligjin për sigurimin shëndetësor dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R E K O M A N D I M

Të miratohet në parim Projektligji për sigurimin shëndetësor.

Komisioni pas shqyrtimit në parim të projektligjit vlerësoi se projektligji i plotëson kushtet e parapara të nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendin për miratim në parim.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të PDK-së, zonja Flora Brovina e ka fjalën.

FLORA BROVINA: Ligji për sigurimin shëndetësor është pjesë e reformave në shëndetësi, së bashku me Ligjin e shëndetësisë, të cilin tanimë e kemi aprovuar. Unë do t'i quaja dy ligje binjake, të domosdoshme për një situatë ndryshe në shëndetësi. Kujtoj se ky moment është shumë i rëndësishëm për sistemin shëndetësor - aprovimi i Ligjit të sigurimit shëndetësor.

Është hera e tretë që në Parlamentin e Kosovës, pra gjatë mandateve të kaluara, duke e pasur në konsiderim, sillet Ligji për sigurimin shëndetësor, por ligjet paraprake kanë pasur mangësi dhe nuk kanë qenë në koordinim me mundësitë financiare të Qeverisë sonë dhe natyrisht nuk kanë paraparë formimin e fondit të sigurimit shëndetësor, prandaj kanë qenë të pazbatueshme dhe kanë rënë prej sistemit ligjor.

Unë i gëzohem, edhe në emër të grupit, mundësisë që ne ta kemi sistemin e sigurimit shëndetësor dhe ky sistem nuk do ta prekë Buxhetin e Kosovës, ose pak do ta prekë, por nuk e destabilizon situatën financiare dhe njëherësh nuk është ligj shumë i kushtueshëm as për qytetarët e Kosovës.

Ky ligj përfshin sigurimin shëndetësor të kujdesit publik dhe njëherësh është një ligj i cili obligon qytetarët dhe është e drejtë obligative e qytetarëve që të marrin pjesë në përmirësimin e shëndetësisë, duke e dhënë kontributin e tyre dhe në formimin e fondit të sigurimeve shëndetësore.

Çështja e mungesës së fondit dhe e mjeteve të mjaftueshme për përmirësimin e gjendjes të shëndetësisë në Kosovës është theksuar edhe në Raportin e Progresit të vitit 2013 dhe unë besoj, edhe në emër të grupit, që me votimin e Ligjit të sigurimit shëndetësor dhe formimin e fondeve të sigurimeve shëndetësore, ne do ta kemi një shëndetësi në përmirësim e sipër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit të LDK-së, deputeti Bahri Thaçi e ka fjalën.

BAHRI THAÇI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar të pranishëm,

Fillimisht duhet përshëndetur fakti që më në fund ky ligj është në Kuvend, pas një rrugëtimi të gjatë dhe mendoj që ky është një lajm shumë i mirë për shëndetësinë dhe për qytetarët kosovarë.

Ligji për sigurimin shëndetësor është bazë për reformimin e sistemit shëndetësor në secilin vend, andaj do të duhej të ishte praktikë edhe në vendin tonë. Për këtë arsye, unë konsideroj se Ligji për sigurimin shëndetësor të cilin e kemi sot përpara pa dyshim se është një ligj shumë i rëndësishëm në shoqërinë kosovare.

Unë kam pasur disa sugjerime dhe vërejtjeje, po i përmendi disa shpejt e shpejt. Shërbimet shëndetësore, sipas këtij ligji, do të garantohen nëpërmjet listës së shërbimeve shëndetësore themelore, e që në këtë ligj nuk është e përcaktuar saktësisht cilat do të jenë këto shërbime themelore shëndetësore. Do të ishte mirë që gjatë amendamentimit të ligjit në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale ta dimë saktësisht se cilat do të jenë këto shërbime shëndetësore, të cilat do të trajtohen.

Sidoqoftë, pas leximit të kujdesshëm, mendoj se Ligji është mjaft i elaboruar në aspektin e themelimit të institucionit të sigurimeve shëndetësor, nga ai cili presim të ofrojë mbrojtje dhe kujdes shëndetësor shumë të mirë për qytetarët e vendit. Sigurimi shëndetësor do të jetë i detyrueshëm për të gjithë qytetarët e vendit. Ligji e përcakton në mënyrë mjaft të qartë se sigurimin shëndetësor të obligueshëm do ta ofrojë vetëm fondi publik i sigurimeve shëndetësore si institucion publik dhe mendoj që ky element është mjaft i rëndësishëm për shfrytëzimin më racional të mjeteve financiare të kufizuara, në veçanti në kushtet aktuale ekonomike të vendit tonë.

Në nenin 8 të këtij ligji synohet rregullimi i sigurimit vullnetar, duke mos lejuar përzierjen e kompetencave dhe besoj se këtu është menduar për zbatimin praktik të parimit të solidaritetit, parim ky i cili theksohet edhe në Ligjin për shëndetësinë. Uroj që ky parim të zbatohet sa më mirë që të jetë e mundur, por mendoj se edhe duhet të sigurohen mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit, në mënyrë që të parandalohet çdo lloj i mundshëm i konfliktit të interesit me kompanitë private.

Edhe pse ligji ka theksuar se të gjithë qytetarët duhet ta paguajnë premiumin për ta pasur të drejtën e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore për veten dhe familjen, po ashtu përcaktohet se disa shërbime shëndetësore do të shfrytëzohen pavarësisht nga statusi i shërbimit shëndetësor, që nënkupton se do të ofrohen falas. Këto shërbime janë shërbimi emergjent i kujdesit shëndetësor, shërbimi i kujdesit shëndetësor për fëmijë nën moshën 18-vjeçare.

Shpresoj që janë menduar mirë burimet e financimit për këtë kategori të shërbimeve. Në ligj gjithashtu theksohet se qëllimi i tij është realizimi i mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor për qytetarët dhe banorët e Republikës të Kosovës, me theks të veçantë kategorive të varfra. Shpresoj që këtë herë me këtë ligj Qeveria do t'i përmbushë qëllimet të cilat i ka përcaktuar vetë.

Ne si grup parlamentar e përkrahim plotësisht këtë ligj, ndërsa vërejtjet tona do t'i adresojmë në komisionin përkatës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për “Vetëvendosjen”, flet Faton Topalli.

FATON TOPALLI: I nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Nuk ka asnjë dyshim se miratimi i Ligjit për sigurimin shëndetësor e ka një rëndësi të veçantë për shëndetin e qytetarëve të Republikës së Kosovës, aq më shumë kur merret parasysh se sigurimet sociale, në përgjithësi, e në veçanti edhe sigurimet shëndetësore e paraqesin bërthamën e të drejtave elementare të njeriut të sanksionuara me akte ndërkombëtare, që e mbrojnë këtë kategori të të drejtave universale.

Prej përfundim të luftës e deri me tani, qytetarët e Kosovës nuk e gëzuan këtë të drejtë sado universale dhe sado e garantuar të jetë kjo me të drejtat e njeriut. Ironia më e madhe është që qeveritë e deritashme kanë krijuar kushte dhe bazë ligjore për t'i siguruar makinat nga përplasjet dhe dëmtimet, por nuk kanë krijuar kushte dhe mundësi për ta siguruar shëndetin e njeriut.

Projektligji për të cilin do të votohet sot në parim, me gjithë rëndësinë e madhe që ka për qytetarët e Republikës së Kosovës, nuk përkon me kërkesat reale dhe nuk siguron qëndrueshmëri nëpërmjet fondit, i cili duhet të themelohet për t'i mbulua shpenzimet shëndetësore.

Edhe pse që pretendohet që ky ligj të ketë karakter solidar, të shprehë elemente të barazisë dhe të jetë një instrument për uljen e varfërisë për shkak të shpenzimeve të larta shëndetësore, në thelb e reflekton të kundërtën - pabarazinë, solidaritetin formal dhe një fond që nuk garanton përmbushjen e obligimeve për ruajtjen dhe vendosjen e shëndetit.

Më lejoni që me këtë rast t'i shfaq disa nga vërejtjet themelore për projektligjin. Neni 6, paragrafi 1, thotë që sigurimi shëndetësor është e drejtë dhe detyrim për të gjithë qytetarët dhe banorët e Republikës së Kosovës. Në fakt, është më shumë obligim, por më pak e drejtë, sepse ligji i propozuar sjell padrejtësi ndërmjet qytetarëve të Republikës tonë.

Neni 11 i projektligjit për sigurimet shëndetësore është diskriminues. Sipas këtij neni, punonjësit që punojnë në ndërmarrjet private, që kanë qarkullim më të vogël se 50 000 euro në vit, paguajnë 100% të shumës së përcaktuar për sigurim shëndetësor, derisa punonjësit në ndërmarrje publike dhe në ndërmarrjet që kanë qarkullim vjetor mbi 50 000 paguajnë vetëm gjysmën e shumës. Duke pasur parasysh që të punësuarit e kanë për obligim ta paguajnë sigurimin shëndetësor për të gjithë anëtarët e familjes që nuk punojnë nën moshën 18-vjeçare, kjo ndikon në rritjen e shpenzimeve që në shumë raste janë vështirë të dallueshme.

Ne sot kemi diku 120 000 ndërmarrje të regjistruara në Kosovës, ndërsa 34% e tyre e fshehin numrin e punonjësve të punësuar. Nëse kemi pra 40 000 të punësuar, që nuk janë të regjistruar, dhe kanë nga 4 anëtarë të familjes të familjeve i bie automatikisht që 160

mijë qytetarë nuk do të kenë sigurime shëndetësore, respektivisht sigurimi i tyre do të mbulohet nga Buxheti i Kosovës.

Subjektet ekonomike që kanë qarkullim vjetor më të vogël se 50 000 euro nuk paguajnë TVSH. Rregullimi sipas projektligjit për çështjet e pagesës rrit ekonominë informate. Ndërmarrjet që kanë qarkullim më të madh, për t'i ikur bashkëfinancimit solidar të sigurimit shëndetësor të punonjësve të tyre, do ta ulin artificialisht nivelin e qarkullimit vjetor. Ky trajtim i ndryshëm i qytetarëve i cenon të drejtat elementare të njeriut dhe bie ndesh me nenin 24 të Kushtetutës për barazi para ligjit, madje edhe me vetë projektligjin, i cili në nenin 6 thirret në parimet e barazisë.

Neni 8 i projektligjit thotë që qytetarët dhe banorët e Republikës së Kosovës kanë të drejtë të kenë sigurim shëndetësor vullnetar. Duke qenë se kjo kategori e sigurimeve shëndetësore përmban objekt të rregullimit të veçantë, kjo çështje do të duhej të rregullohej me një ligj të veçantë, duke përkufizuar përgjegjësitë dhe kompetencat lidhur me këtë lloj të sigurimit shëndetësor.

Një problem shumë serioz i projektligjit për sigurimin shëndetësor është fakti që me ligj nuk përcaktohen shërbimet shëndetësore që do të mund t'i marrin qytetarët në bazë të ligjit. Kjo e drejtë, sipas ligjit, i përcaktohet fondit.

Duke pasur parasysh interesin e qytetarëve, ne mendojmë që lista e shërbimeve themelore që garantohej me sigurimin e obligueshëm shëndetësor duhet të jetë pjesë e ligjit, por edhe të mos ndryshojë çdo vit. Neni 31 i projektligjit e njeh të drejtën që fondi të kontrakttojë shërbime shëndetësore me të gjitha institucionet shëndetësore të licencuara nga Ministria e Shëndetësisë, madje duke u dhënë përparësi institucioneve të licencuara ndërkombëtarisht, që zakonisht janë institucionet e huaja që veprojnë në Kosovë.

E para, ky është një diskriminim ndaj institucioneve vendase dhe, e dyta, është një përpjekje e pacipë, mund të them, për të mbështetur grupet të caktuara të interesit.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me fondin. Fondi i mbulon shërbimet esenciale dhe këto mund të mbulohen nga institucionet publike në Kosovë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Përfundoje më shpejt! Vazhdoje zoti Topalli!

FATON TOPALLI: ...mendoj se ka edhe një varg kritikash sa i përket këtij ligji. Ne do t'i paraqesim në komision, në fakt ligjin e miratojmë tani në parim, por në qoftë se nuk bëhen ndryshimet, ne do ta kundërshtojmë.

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Është pritur gjatë ky projektligj, ose siç është quajtur Ligji i reformave në sistemin shëndetësor. Mirëpo, është shqetësuese se pse opinioni i Departamentit të Buxhetit ka theksuar: Në kornizën buxhetore 2014-2016 nuk është planifikuar buxhet shtesë që lidhet me zbatimin e këtij ligji.

Me aprovimin e këtij projektligji, nga Qeveria e Kosovës do të kërkoj rishikimin e prioriteteve, të cilat duhet lëvizur ose ndryshuar nëpërmjet dokumentit të kornizës afatmesme buxhetore. Pra, përpos kostos shtesë buxhetore, që është paraqitë nga Ministria e Shëndetësisë, nenet 7, 11, 13 kanë ekstra ndikim buxhetor.

Çështjet kryesore të trajtuara rregullojnë themelimin, organizimin, funksionimin dhe financimin e sistemit publik të sigurimeve shëndetësore, të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira. Ligji ka si qëllim sigurimin e qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative shëndetësore. Kemi shërbime shëndetësore të obligueshme dhe vullnetare.

Sipas Qeverisë, reformat në sektorin shëndetësor parashihen në tri shtylla: riorganizimi i sistemit shëndetësor, sigurimi i financimit të qëndrueshëm të sektorit të shëndetësisë dhe decentralizimi i menaxhimit të resurseve profesionale njerëzore.

Në strategjinë sektoriale 2010-2014, si objektiv strategjik është financimi i qëndrueshëm i sistemit shëndetësor, që referohet edhe në Planin e Veprimit. Në Raportin e Progresit për Kosovën 2013 si sfidë ka qenë mungesa e shëndetësisë si prioritet dhe mungesa e fondeve që ndikon në zbatimin e reforma dhe të legjislacionit, si dhe shpenzimet tejet të larta nga xhepi i qytetarëve 40 deri 60%. Me këtë bien poshtë pohimet e kësaj Qeverie se shëndetësia është prioritetet saj dhe pohimet tjera se te ne shëndetësia është falas.

Kjo formë e financimit të sektorit shëndetësor ka rezultuar e pamjaftueshme, sepse ky buxhet ka qenë i pamjaftueshëm për t'i mbuluar nevojat më bazike, siç janë: furnizimi me barëra dhe material harxhues, pra nuk ka pasur as cilësi, e as kualitet të shërbimeve.

E mira që mendohet apo parimet e këtij projektligji janë transparenca, barazia, qëndrueshmëria, llogaridhënia, por më kryesorja - solidariteti, i cili ndihmon që asnjë qytetarë i Kosovës të mos mbetet pa sigurim shëndetësor. Lirohen nga pagesa familjet e varfra, të burgosurit, invalidët, pensionistët, familjet e martirëve, pensionistët e “Trepçës”, veteranët dhe pjesëtarët e luftës, anëtarët e viktimave civile.

Këtu, ose është harruar, ose është bërë lëshim, e nuk janë përmendur familjet e dëshmorëve të kombit, andaj mendoj se gjatë amendamentimit duhet të përfshihet patjetër edhe kjo kategori. Pra, ky projektligj popullatës do t'i sjellë dhe është i mirëseardhur, sepse, më në fund, po shihet një shpresë e trajtimit adekuat shëndetësor, ashtu siç e meritojnë qytetarët e Kosovës. Dhe, për invalidët e luftës që është përcaktuar se lirohen nga pagesa, ata që kanë shkallë të invaliditetit 60%, mendoj se kjo shkallë e invaliditetit duhet të zbresë.

Mirë që janë përcaktuar se cilat shërbime do të ofrohen, e që do të paguhen nga fondi dhe cilat shërbime duhet të paguhen nga pacientët dhe këto janë kryesisht shërbime estetike.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e ka shqyrtuar projektligjin dhe do ta përkrahë, kurse kontributin tonë të mëtutjeshëm, do ta japim në Komisionin Parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka Jeton Svirca.

JETON SVIRCA: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Kam kënaqësi të veçantë që në emër të Grupit Parlamentar të flas dhe t'ia jap përkrahjen e plotë ministrit dhe Projektligjit për sigurimin shëndetësor, akti i shumëpritur juridik nga ne dhe nga qytetarët e Kosovës, i cili do të mundësojë ndarjen përfundimtare të shëndetësisë kosovare nga funksionimi në rrethanat e nënfinancimit të rëndë, si dhe avancimin e saj drejt skemave bashkëkohore evropiane nëpërmjet sigurimit të financimit të qëndrueshëm të sistemit shëndetësor në të gjitha nivelet e funksionimit dhe në të gjitha format e pronësisë.

Mund të them se ligji, me zgjedhjet e propozuara, do të gjejë përkrahjen e plotë të Kuvendit, e që shpresoj se do ta ndihmojë shtetin e Kosovës që brenda periudhës sa më të shkurtër kohore ta sigurojë njërin prej standardeve më të larta ndërkombëtare në shëndetësi, qasjen universale ndaj shërbimeve cilësore shëndetësore për të gjithë qytetarët dhe banorët e vendit pa asnjë diskriminim, si e drejtë themelore e njeriut.

Ligji është mjaft i elaboruar siç tha edhe ministri, rregullon themelimin, organizimin, funksionimin dhe financimin e sistemit publik të sigurimeve shëndetësore, si dhe të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira.

Projektligji paraqet qartë qëllimin e tij për sigurim të qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative shëndetësore, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësorë dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor, veçanërisht në rastet e sëmundjeve të rënda nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor.

Të nderuar deputetë,

Miratimi i Ligjit për sigurimin shëndetësor paraqet mundësi reale për përmirësimin përmbajtësor të gjendjes në sektorin shëndetësor, duke mos ndikuar në qëndrueshmërinë fiskale të vendit. Ne i përkrahim të gjitha skemat e pagesës të paraqitura edhe në rezymenë e ministrit dhe gjithashtu i thërrasim të gjithë deputetët se miratimi i këtij projektligji, i cili ka paraqitur pra sfidë shumëvjeçare për institucionet e vendit, si për Qeverinë, ashtu edhe për Kuvendin e Kosovës, prandaj miratimi i tij si pjesë esenciale e reformës gjithëpërfshirëse të sistemit shëndetësor të vendit do të paraqesë sukses të madh, të përbashkët, si dhe ju ftoj të gjithëve që ta votoni dhe ta mbështetni. Koalicioni për

Kosovë të Re kontributin e vet eventual do ta japë në Komisionin Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Grupi “6+”, Fikrim Damka e ka fjalën.

FIKRIM DAMKA: Teşekkür ederim Sayın Başkan vekili Sağlık sigorta Yasa Taslağını grup olarak incelediğimiz ve uzun zamandır beklenen bu yasanın Meclise gelmesi ve bir an Önce yürürlüğe girmesi gerektiğini düşünmekteyiz. Sağlık Yasası ile birlikte gelmesi beklenen bu Yasanın bir yıl gecikmeli gelmesi bile olumlu.

Sağlık sigortası olmayan tek ülkeyiz herhalde bölgede. Sağlık sektörüne hız kazandıracak ve alınan hizmet karşılığının hastanelere bir ek gelir olarak gelmesi, hastanelerde kalite ve hizmet alımını iyileştireceği ortadadır. Tabi ki bu kaynağın ve ya sağlık sigorta fonunun iyi idare edilmesi gerektiğine vurgu yapmak istiyorum. Çünkü bugün birçok ülkede bu sağlık harcamaların yüksek olması ve fonun yetersiz kalması bütçe açıklarına neden olmaktadır. Tabi ki bu havuzun doldurulması için öngörülen süre düşünülürse bizdeki yaşlılık oranının çok yüksek olmaması bu fonun iyi kullanılmasına imkan sağlayacaktır, ama diğer taraftan yüksek işsizlik oranının bunun kullanımında ve hizmet alımında sorun teşkil etmesi muhtemeldir.

Grup olarak bu Yasanın bugünkü sağlık sektörünün daha iyi olmasına şüphesiz katkı sağlayacağına inanmaktayız ve desteklemekteyiz.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Faleminderit! Murselj Haljilji, në emër të Grupit SLS, e ka fjalën.

MURSELJ HALJILJI: Zahvaljujem gospodine predsedavajući!

Uvaženi ministre,

Kolege i koeginice poslanici,

Naša Parlamentarna grupa je razmatrala Nacrt zakona o zdravstvenom osiguranju i doneli smo odluku da isti podržimo u načelu. Međutim imamo neke primedbe, o njima ću sada nešto reći, ali potpuni doprinos mi čemo dati u nadležnim komisijama.

Što se tiče prvog poglavlja, gde stoji ‘opšte odredbe’, smatramo da je potrebno da se taj naslov promeni u ‘osnovne odredbe’, jer preciznije ovjašnjava i govori o tom poglavlju. Takođe smatram da je potrebno da jedno ovako značajno pitanje bude razjašnjeno ovim zakonom malo preciznije i konstatovaću da je trebalo preciznije objasniti da se zdravstveno osiguranje deli na pravo na zdravstvenu zaštitu. Ne vidim u ovom tekstu pravo na nadoknadu zarade za vreme priveremene sprečenosti za rad. Složićete se da veliki broj radnika može da odsustvuje sa rada usled bolesti i usled korišćenja zdravstvene zaštite, ali nije regulisano to vreme kako će se nadoknadati ta zarada dok se koristi zdravstvena zaštita.

Takođe u nekim centrima ne postoje adekvatne medicinske usluge, pa je potrebno da se građani leče van mesta svog borališta, odnosno prebivališta, i tu nije predviđena naknada troškova prevoza za lica koja koriste zdravstvenu zaštitu van mesta svog prebivališta. Smatramo da je to veoma korisno, i to čemo insistirati u nadležnim komisijama da bude uvršćeno, a sve u cilju da se bolje zaštiti zdravlje građana.

Takođe smatramo da je izostavljen deo koji bi mogao puno da znači našim ljudima, znači osiguranim licima, koji rade u inostranstvo. Ne vidim to poglavlje za lica koja su van Kosova, a mogu da zatraže pomoć zdravstvenog, pa šta sa njima, gde će on da se leči, ko će te troškove da snosi, takokde nije predviđeno.

Takođe smatram da ima mesta da se ovde uvrsti i kada nismo u mogućnosti da pružimo zdravstvenu zaštitu licima koji to traže na Kosovu, da to učine i u inostranstvo. Znači način kako da lica se upućuju na lečenju u inostranstvo nije predviđeno ovim zakonom, a mislim da je veoma potrebno.

Takođe pravo na lekove i medicinska sredstva, nije uvršćen u ovaj zakon, ili uglavnom neka pitanja jesu urađena, ali ne dovoljno precizno, i to stvara nejasnoće oko korišćenja tog prava.

Medicinska rehabilitacija se takođe ne spominje, jer je veoma bitna i medicinska rehabilitacija posle bolesti ili porvreda, koje su sastavni deo ove priče, odnosno ovog Nacrta zakona koje trebalo bi da budu.

Takođe posebno poglavlje koje mi kao parlamentarna grupa želimo da istaknemo jeste zaštita pravo osiguranih lica. Koji je postupak u toku, koji će postupak da se koristi predpostavljam upravnih postupaka, ali to nije sprovedeno, samo posebno poglavlje gde piše 'pravo na žalbu'. Ja mislim da to nije dovoljno, potrebno je precizirati kakav je to postupak, koji su to rokovi, pred kojim organima, lice koje ima pravo na zdravstvenu zaštitu, može i to pravo da ostvari ako mu je ugroženo, odnosno ako nije zadovoljan sa time.

Ne bih da dužim, pošto već je ova sednica odužena, mi ćemo kao parlamentarna grupa da podržimo ovaj Nacrt zakona u načelu, a naravno u nadležnim komisijama ćemo dati svoj doprinos da isti popravi, a sve to u cilju bolje zaštite zdravstva, ili zdravstvene zaštite na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në diskutimet e deputetëve. Në emër të grupeve nuk ka. Fjalën e ka Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Zoti ministër,

Këtë ligj shumë të kërkuar për t'i dhënë formë të vërtetë shërbimit shëndetësor të Republikës së Kosovës, unë në parim do ta përkrah me disa vërejtjeje, të cilat janë në rrafshin organizativ për funksionimin sa më të mirë të këtij ligji dhe po ashtu duhet t'u tregohet edhe qytetarëve se ky ligj do të kërkojë edhe një kohë. Ne si deputetë duhet të punojmë shumë. Do ta kërkojë edhe një kohë, ndoshta më shumë se një vit, që të hyjë në një funksionalizim ndoshta dhe ta arrijë një 50% të funksionimit të tij për të qenë në duart e qytetarëve.

Orientimet e mia janë në pagesat për shërbimet e kujdesit shëndetësor, ku janë penaltitë të cilat shihen për shembull te neni 25, pika 6, forma e cila duhet të plotësohet, të

ndryshohet për penaltinë që i shkaktohet një personi, i cili zihet i pasiguruar. Mandej tek format kontraktuale të fondit me agjencitë, jo vetëm me shërbimet brenda-spitalore dhe shërbimin shëndetësor brenda Republikës së Kosovës, por edhe me kontraktimet të cilat duhet të jenë të specifikuara dhe qytetari ynë kur gjendet jashtë Republikës së Kosovës.

Identifikimi i saj dhe çfarë forme mund t'i jepet është cekur në një nen këtu shkarazi. Mandej tek organizimi dhe drejtimi i fondit, vërejtjet ose qartësimi im është të punësuarit në fond, në pikën 3, neni 27, thotë të punësuarit në fond nuk i takojnë Shërbimit Civil të Kosovës. Duhet një arsyeshmëri pak më e madhe, të jepet pse nuk i takojnë.

Mandej tek neni 29, tek drejtimi, fondi drejtohet, thuhet nga bordi, janë emëruar një sërë me funksion ministra dhe përfaqësues të asociacionit të komunave, përfaqësuesi i Shoqatës së Pacientëve, unë propozoj që në këtë bord të futet edhe një përfaqësues i Shoqatës së Kompanive të Sigurimeve, sepse edhe nga ta, meqë ligji parasheh edhe miks të sigurimit shëndetësor privat dhe sigurimin e fondit po ashtu edhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve. Derisa kanë të drejtë nga odat e mjekëve, sindikata është pjesa sociale e cila duhet të kontribuojë në vendimmarrje të bordit.

Po ashtu, në kohëzgjatjen e drejtuesit të bordit për një vit unë mendoj që është një kohë e shkurtër që të rrijë në një vit, mund të rrinë një pjesë e ministrave me funksion, por mendoj që duhet të zgjidhet në një formë pak më të organizuar.

Mandej tek mbikëqyrja e fondit, është që fondi, ku në pikën 5 thotë fondi ka të drejtë që në pikën 32, pika 5, fondi ka të drejtë që të realizojë marrëdhënie kontraktuale me institucionet e kujdesit parësor shëndetësor nëpërmjet drejtorive komunale të shëndetësisë në bazë të Rregullores së veçantë, të miratuar nga Qeveria.

Nuk ka të drejtë por është e obliguar, duhet, është obligative, se mund të mbetet shërbimi primar i pambuluar, kështu që nëse lihet ligjërisht ka të drejtë mund edhe të mos ketë të drejtë, ne duhet ta obligojmë mendoj, është obligative.

Këto ishin dhe do të mundohem të jem konstruktiv edhe me amendamentet të cilat do t'i paraqes në komision për t'i plotësuar edhe qëndrimet tjera rreth këtij ligji të cilin po përsëris edhe një herë i mungojnë edhe mekanizmat implementues të këtij ligji. Ne kemi cekur edhe disa herë, sistemi i informimit shëndetësor me shpresë që është premtuar në fund të vitit 2015, do të funksionalizohet, do të jetë edhe bazë e fillimit dhe e implementimit të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ka fjalën deputeti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Sigurisht që ne mund të jemi shumë të kënaqur që e kemi më në fund draftin e këtij ligji, një ligji shumë të rëndësishëm dhe organik dhe unë nuk di si formohet rendi i ditës në Kryesi, por kur janë ligjet kaq të rëndësishme do të ishte shumë e natyrshme që këto të

jenë ndër pikat e para të rendit të ditës, për arsye se unë s'besoj që ka ndonjë çështje më me interes për publikun, sot.

Mendoj se ligji ka arritur që t'i deklarojë parimet e rëndësishme dhe t'i elaborojë mjaft mirë.

Unë do të ndalem në dy çështje që nuk janë për mua shumë të qarta dhe duhet të qartësohen.

Nëse ligji duhet t'i kontribuojë siç thuhet qasjes më të madhe dhe cilësisë më të lartë në shërbimet shëndetësore primare, sekondare dhe terciare në Kosovë nga lista e caktuar, kuptohet ne duhet të shohim çka po ndodh me sistemin e deritashëm të financimit.

Me buxhetin e deritashëm të Kosovës janë mbuluar barnat, janë mbuluar pagat, janë mbuluar shpenzimet kapitale. Me këtë ligj që krijon diku 66 milionë në vit sigurisht krijohet një fond shtesë, fond shtesë mbi këtë, prandaj ne duhet të shohim në politika edhe në ligj si do të ndërtohet ky komplementaritet, sepse në këtë ligj ne shohim vetëm për ato pjesë të popullatës që nuk kanë aftësi të paguajnë do të kemi grantin e buxhetit, në fond. Po thashë e kemi fondin për shërbime dhe e kemi, përsëri mbetet si do të korrespondojmë me këtë pjesën që ne për çdo vjet e ndajmë me buxhet në shëndetësi.

Mendoj se kur te shohim në tërësi, tërë buxhetin që do të shkojnë në paranë publike më mirë të them që do të shkojë në shëndetësi, ne do të jemi në gjendje të shohim se sa me të vërtetë kemi krijuar kushte që të rriten cilësia e shërbimeve shëndetësore, por unë jam i bindur se kjo është një përpjekje shtesë dhe do të ndikojë në këtë trend.

Çështja tjetër, ministri në fjalë na tha që do të jetë 7%, 3.5% plus 3.5% dhe unë u qetësova pak. Kjo nuk do të jetë një barrë e rëndë dhe besoj që edhe bizneset dhe ndërmarrësit nuk do ta kundërshtojnë.

Duhet shikuar edhe një herë kjo çështja e këtyre bizneseve më të vogla që nuk janë të regjistruara për TVSH. Mendoj se aty duhet dhe ato ta kenë një tretman të njëjtë, nuk kanë arsye ndoshta të shkojnë me 3.5 euro për anëtarë. Kjo çështje mendoj se mbetet e hapur dhe le të diskutohet në komisione.

Ajo që mua më brengos më së shumti është neni 13 i këtij ligji ku kemi një pasiguri në realizimin e të drejtave. Në qoftë se popullata paguan kontributin, ajo është një kontratë me fondin dhe me shoqërinë, prandaj nuk mund të ketë kufizime të tilla se benefitet do të paguhen nëse ka fonde, nëse Qeveria ka marrë vendime, nëse ka fonde të mjaftueshme. Këto gjëra, duhet të jemi shumë të sigurt, edhe duhet t'i shohim sepse kjo krijon një lloj pasigurie. Ne kemi vu në ligj obligimet me përqindje të caktuar, kemi pakon e shërbimeve, kemi gjithçka dhe njerëzit kur t'i paguajnë këto presin shërbimin komplet.

Prandaj mendoj që ky nen, neni 13, është formuar neni më problematik dhe duhet ta shqyrtojmë seriozisht në punën e mëtejme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë pajtohem me zotin Muhamet Mustafën që në fillim të mbledhjes të jenë pikat më të rëndësishme, bile propozoj që ato dy pikat e deklaratave pa obligime të kalojnë në fund, veç duhet Kuvendi të vendosë. Dhe këtë pikë, po edhe pse e qet Kryesia, ku e ka qitur, Kuvendi mund të lypë ta qetë të parën. Nëse është e rëndësishme koha, unë besoj nuk e humb koncentrimin. Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Padyshim se është një prej mbase ligjeve më të rëndësishme që po i diskutojmë këtu në Kuvend, për shkak se e mbulon një çështje jashtëzakonisht të ndjeshme të cilën deri tash e kemi pasur siç e dimë të gjithë të pambuluar.

Për të qenë më i shkurtër konsideroj se parimet që janë vendosur si parime pra themeltare të këtij fondi dhe përgjithësisht idesë, mekanizmit të sigurimit shëndetësor, jo të gjitha, natyrisht, me rëndësinë e njëjtë, por janë disa të cilat janë shumë të rëndësishme. Dhe ato më të rëndësishme natyrisht që janë barazia, llogaridhënia, universaliteti, solidariteti e kështu me radhë që përmenden këtu te neni 4 si parime, por pastaj mendoj që në disa pika ligji, disa prej këtyre parimeve të rëndësishme, nuk është se i përmban deri në skaj, pra i shkel vetë ligji, vetë klauzolat ligjore, parimet e fondit. Pra, në njëfarë mënyre po shkelen parimet e fondit pa u themeluar ai.

Parimi i parë që shkelet është universaliteti. Pra, për sa kohë që nga fondi i sigurimeve shëndetësore janë të parashtruar një pjesë e qytetarëve të Kosovës, pra familjet, anëtarët e ngushtë të atyre personave të cilët janë të punësuar në këto ndërmarrje e që janë nën qarkullimin vjetor ose të regjistruara për TVSH dhe që janë nën qarkullimin 50.000 euro në vit, atëherë këto po shkelen, ky parimi i universalitetit se nuk po janë të gjithë të barabartë karshi qasjes së tyre në fondin e sigurimeve shëndetësore. Tash këtu mund të thuhet që këta do të mbulohen nga buxheti i Qeverisë për shëndetësi e kështu me radhë, por megjithatë ne nuk po e bëjmë këtë fond me këtë nen, nuk po e bëjmë universal, po nuk po e bëjmë të qasshëm për të gjithë dhe kjo mendoj që paraqet problem.

Problemi tjetër që paraqitet këtu është edhe solidariteti, për shkak se solidariteti do të kishte pasur kuptim po të ishte gjithë shoqëror, pra solidaritet të pjesshëm nuk ka. Nëse disa janë më solidarë, ose disa përbëjnë, janë anëtarë të një grupi që është solidar në mes veti duke i përjashtuar të tjerët, atëherë vetë ideja e solidaritetit bie poshtë, bie në ujë. Pra, bashkë me universalitetin dhe solidariteti tashmë na u thyen në këtë ligj dhe konsideroj që këto duhet të sanohen, përndryshe parimet kryesore të fondit po shkelen.

Dhe, parimi i barazisë. Mendoj që këtu duhet të ndalemi pak më shumë. Unë konsideroj që edhe universale edhe solidariteti nëse nuk e kanë komponentin e progresivitetit përbrenda, që nuk e ka fondi, atëherë kjo e shkel parimin e barazisë, sepse barazia nuk mund të jetë vetëm barazi në shanse siç po pretendon në ta këtë fondi, por duhet të jetë gjithsesi barazimi me rezultatet.

Dhe, në këtë drejtim konsideroj që edhe koncepti i barazisë po shkelet kur po i barazojmë të gjithë me pagesë ose detyrimet që i ata i kanë përballë fondit, sepse ne e dimë që në Kosovë të ardhurat janë të ndryshme dhe kur të ardhurat janë të ndryshme, pra kur qytetarët e Kosovës përfitojnë në forma të ndryshme nga e mira e përgjithshme, atëherë natyrisht që proporcionalisht duhet edhe barrën për të mirën e përgjithshme ta ndajnë. Pra, nuk ka kurrfarë kuptimi që disa të fitojnë nga e mira e përgjithshme shumë më shumë se disa tjerë dhe pastaj kur vjen që ta mbajnë barrën në këtë rast të financimit të sistemit shëndetësor, aty ta paguajnë të njëjtën përqindje, pra të barazohen në përqindje, sepse kështu pastaj pa progresivitetin po na zhduket parimi i barazisë që është një prej parimeve bazë që duhet ta përcjellë këtë fond.

Pra, konsideroj që njëjtësimi, thjeshtësia e premimeve për të gjithë qytetarët është në kundërshtim me idenë e barazisë dhe natyrisht që do të kishte qenë e domosdoshme që këtu të kemi progresivitet siç kemi progresivitet në tatimet dhe si do ta rrisim progresivitetin në sistemin fiskal të Kosovës për të krijuar barazi.

Pra, natyrisht se barazia vjen nga kompleksiteti i sistemit dhe jo nga thjeshtësia e tij.

Çështja e dytë që dua ta ngre përballë fondit është edhe ajo që e nisi zoti Faton Topalli, meqë është e sanksionuar në nenin 31, për të drejtat kontraktuale që i ka fondi dhe me të cilat institucione. Konsideroj se natyrisht që roli primar i fondit duhet të jetë sigurimi ose përballimi i kostos së shëndetit për qytetarët, veçanërisht për ata që anëtarësohen në fond, po në anën tjetër një prodhim i domosdoshëm i fondit duhet të jetë edhe rritja e cilësisë së shërbimeve në sektorin publik. Prandaj konsideroj që fondi domosdoshmërisht duhet t'i japë prioritet shërbimit publik, sistemit shëndetësor publik në kontratat e veta dhe përgjithësisht kjo niset nga parimi që sistemi privat apo ku ta di unë, spitalet private, klinikat private e kështu me radhë, duhet të jenë komplementare në sistemin e përgjithshëm të shëndetësisë dhe jo që ato të jenë prioritare karshi dhe në dëm të sektorit publik, sepse nëse këto para që mblidhen në fondin e sigurimeve shëndetësore nuk e ndihmojnë ringjalljen e sektorit publik, atëherë nuk kemi bërë asgjë, çka është më keq, në njëfarë mënyre në afat të gjatë e kemi shkatërruar në interes të përgjithshëm për qytetarët e Kosovës jo vetëm të kësaj gjenerate, por edhe të gjeneratave të ardhshme.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Sevdije Lama e ka fjalën.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Fillimisht e përshëndes ministrin për draftimin e këtij ligji, e kam vetëm një vërejtje e cila u tha edhe më herët, te kontraktimi i shërbimeve shëndetësore, përkatësisht nenit 31, pika 5, fondi ka të drejtë që të realizojë marrëdhënie kontraktuale me institucionet e kujdesit parësor shëndetësor nëpërmjet drejtorive komunale të shëndetësisë në bazë të Rregullores së veçantë të miratuar nga Qeveria.

Fondi duhet të obligohet ngase është e pakuptimtë që të mbetet nën dëshirën dhe vullnetin e fondit që me kë të dojë të lidhë kontratë, shembull me këtë apo atë komunë.

Shpresoj të jetë një gabim teknik dhe që komisioni të ketë parasysh dhe ta rregullojë gjatë amendamentimit, përndryshe do ta përkrah ligjin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Justina Shiroka-Pula.

(Ndërprerje e incizimit)

Regjia, edhe një herë, zonjës mikrofonin. Justina Shiroka-Pula e ka fjalën.

JUSTINA SHIROKA-PULA: Në parim, ky projektligj jo vetëm që është domosdoshmëri, por duhet të jetë ndihmesë e madhe në konsolidimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sistemit shëndetësor në Kosovë. Për funksionalizimin e këtij ligji janë disa parakushte elementare e në veçanti do t'i përmend disa më esenciale.

Nën 1. Sistemi informativ shëndetësor në Kosovë përkundrejt investimeve disa milionëshe në këtë fushë ende nuk është në funksion një data-bazë e evidencës dhe regjistrimit unik të shëndetësisë.

Nën 2. Lista unike e momentit e çmimeve për të gjitha shërbimet shëndetësore të kujdesit themelor që realizohet në sektorin publik apo privat duhet të reflektojë edhe në disa nene të propozuara në ligj si dhe një projektion real afatmesëm buxhetor të këtij ligji.

Nën 3. Funksionalizimi i mjekësisë primare familjare që po promovohet 14 vjet nënkupton se do të vjen një kohë kur çdo qytetar në Kosovë do të ketë mjekun familjar personal, do të ketë një kartelë shëndetësore si një gurthemel i një sistemi të rregulluar me mundësi të monitorimit dhe planifikimit korrekt të shpenzimeve.

Ndërsa tani do t'i jap disa komente të cilat lidhen direkt me disa nene. Për shembull, në nenin 13 të drejtat nga sigurimi shëndetësor i obligueshëm pika 3 në faqen 16 është shkruar: Vështirësitë e parashikuara për gjendjen financiare të fondit do të menaxhohen nga rezervat e fondit ose do të zgjidhen në vitin pasues nëpërmjet të procesit të përcaktimit të premiumit në pajtim me këtë ligj. Megjithatë, nëse në çfarëdo kohe gjatë vitit fiskal bilanci fiskal i fondit bëhet negativ, Qeveria do të rivendosë këtë ekuilibër nëpërmjet ristikioneve në pagesën e ofruar të shërbimeve ose rritjen e bashkëfinancimit. Kjo do të shkaktojë konfuzion tek personaliteti shëndetësor ashtu edhe ashtu janë të pakënaqur.

Do të propozoj të riformulohet që Qeveria në periudhën tranzitore pesëvjeçare deri në konsolidimin e plotë të fondit të ruajë balancin fiskal pozitiv me mjete buxhetore nga buxheti i Kosovës.

Ndërsa në nenin 14, i cili përfshin shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor mendoj dhe propozoj se duhet specifikuar edhe disa shërbime siç janë: do të duhet të specifikohen edhe shërbimet për të sëmurit kronik jo infektiv, siç janë të sëmurit nga diabeti, tensioni dhe reumatizmi. Gjithashtu të shtohet edhe një shërbim siç është Shërbimi për anomalitë apo devijimet e të pamurit, sidomos për fëmijët deri në moshën 18 vjeçare.

Prandaj, qëllimi i hartimit të këtij projektligji duhet të jetë ngritja në nivel më të lartë të shërbimeve dhe sigurimeve shëndetësore në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nazane Breca e ka fjalën.

NAZANE BRECA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë jam e lumtur shumë që sot e kemi këtë projektligj kaq të rëndësishëm në Kuvend për miratim, në parim do ta miratoj dhe shpresoj se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale shpejt do ta bie edhe në leximin e dytë sepse implementimi i këtij ligji do të ndikojë shumë në reformat në shëndetësi, do të ndikojë në ngritjen e kualitetit të shërbimeve shëndetësore dhe do t'i zgjidhë shumë çështje që kanë të bëjnë me punëtorët shëndetësorë.

Unë gjatë leximit kam hasur në disa paqartësi, pra i kam disa vërejtje të cilat do të mundohem t'i paraqes, aq sa arrij. Do të mundohem që mos t'i përsëris ato që kolegët e mi veç i kanë cekur më herët.

Do të filloj me nenin 7, ku në pikën 1.3. thuhet: shërbimet e tjera esenciale të kujdesit shëndetësor të përcaktuara nga fondit do të ofrohen pavarësisht nga statusi i sigurimit shëndetësor, po nuk saktësohet se cilat janë ato shërbime dhe kush i përcakton ato.

Në nenin 8, në pikën 4 kur flitet për Agjencinë private të Sigurimeve Shëndetësore mirë është të përdoret fjala: nuk e përjashton detyrimin e obligueshëm të qytetarit, banorit e kështu me radhë, mos të vazhdojë deri në fund.

Në nenin 12, pika 2, thotë: personit i cili nuk arrin ta paguajë premiumin gjatë tre muajve radhazi në periudhën e pritjes i ndërpritet mbulesa me sigurimin shëndetësor nga fondit. Për të ripërtërirë mbulimin me sigurimin e premiumit duhet të paguhet me kohë për të paktën 3 muaj radhazi pa ndërprerje ose 6 muaj me ndërprerje brenda 12 muajve të fundit, para se të fitohet shfrytëzimi i të drejtave nga siguri shëndetësor i obligueshëm. Personi i cili nuk arrin që t'i paguajë premiumet e caktuara me shumë se 3 herë në 5 vjetët e fundit, nuk do të përfitojë nga kjo periudhë e pritjes dhe me mbulimin e sigurimit shëndetësor do të ndërpritet menjëherë pas dështimit për të paguar edhe një kistë të vetëm.

Ky paragraf dhe ky rregullim nuk besoj se përmbush as parimin e qëndrueshmërisë e as të efikasitetit, planifikimi i resurseve dhe projektimi i tyre në të ardhmen po thuaj se do të jetë i pamundur, në qoftë se mbetet kështu.

Në nenin 15 kur është fjala për barërat thuhet që: në reçetën zyrtare duhet të jetë emërtimi ndërkombëtar i pambrojtur me siguri që është menduar në emërtimin gjenerik, se e kemi këtë shprehje që e përdorim ne në mjekësi e ndoshta kishte me qenë më mirë të ishte përdorur kjo shprehje.

Në nenin 21 në pikën 1, thuhet: në qoftë se dy ose më shumë anëtarë të familjes janë të punësuar në institucionin nga paragrafi 1.1 të këtij neni, të gjithë janë të obliguar që të bëjnë pagesën e premiumit të obligueshëm të sigurimit shëndetësor. A ndahet premiumi familjar, nuk qartësohet ndërmjet dy të punësuarve, apo paguhet dyfish? Secili, dy fish paguhet, mirë. Domethënë janë këto pika.

Në nenin 22 pika 2, premiumi për sigurimin shëndetësor të obligueshëm për qytetarët dhe banorët e tjerë sipas nenit 21 paragrafi 1.3 i këtij ligji mund të bazohet në koston e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor të propozuar nga fondi dhe të miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi dhe llogaritet në baza vjetore si vlerë fikse e miratuar nga Qeveria dhe Kuvendi në kuadër të procesit buxhetor.

Në qoftë se llogaritet si vlerë fikse dhe jo si përqindje e të ardhurave, atëherë parimi i solidaritetit do të shkelet.

Neni 23 pika 4, thotë: pagesa e premieeve nga neni 21, paragrafi 1.3 i këtij ligji mund të bëhet në llogarinë e fondit si pagesë vjetore tremujore ose mujore për person ose për anëtar të familjes jo më vonë se dita e 15 e muajit që i paraprinë muajit prej të cilit personi do të jetë i mbuluar me sigurim.

Ky elasticitet në pagesën e premiumit do të krijojë problem në planifikimin e buxhetit të fondit dhe projeksionit të shpenzimeve, do të thotë do të ketë problem.

Këto ishin disa pika që mos t'i përsëris ato tjerat që i thanë kolegët e mi, unë kontributin tim do ta jap edhe në Komisionin Funkcional dhe shpresojmë se shpejt ta bimë për lexim të dytë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Blerta Deliu-Kodra e merr fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

Përshëndetje për ministrin,

Përshëndetje për deputetët që janë këtu në sallë.

Është mirë që përfundimisht sot ka ardhur në Parlament Projektligji për sigurime shëndetësore meqë Kosova vazhdon do të thotë të mbetet vendi i vetëm në rajon që ende nuk e ka një ligj të tillë të cilin po thuaj se e kanë gjithë rajoni.

Mungesa e ligjit ka bërë të vështirë do të thotë gjendjen e pacientëve dhe punën e personelit shëndetësor në Qendrën Klinike Universitare, por edhe në spitalet tjera rajonale.

Projektligji bashkë me ligjet tjera përcjellëse një pjesë e të cilave do të thotë erdhën sot në seancë, do të ndikojë në rritjen e fondeve për shëndetësi si dhe do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë në punë, por edhe në ofrimin e shërbimeve më kualitative për pacientët.

Do të ndalem konkretisht tek Instituti i Onkologjisë në QKUK, institut në të cilin do të thotë trajtohen në baza ditore 130 pacientë e që trajtimi i sëmundjeve malinje në Kosovë pacientëve u kushton 300 euro, do të thotë në baza mujore. E nëse marrim për bazë standardin e jetesës për qytetarët e Kosovës kjo shifër është tejte e lartë, prandaj mendoj se projektligji për sigurime shëndetësore do të ketë ndikim pozitiv tek pacientët për faktin se projektligji realizon mbrojtje financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët e në theks të veçantë për kategoritë në gjendje të rëndë sociale dhe unë do të ndajë këtu shqetësimin e njëjtë me kolegen do të thotë Kadriu, e cila e përmendi nenin 11 të të siguruarit e obliguar ku përveç kategorive të tjera janë përfshirë invalidët, personat e riatdhesuar dhe mungojnë do të thotë familjet e dëshmorëve dhe shpresoj se kjo do të vijë në ligj, sepse edhe familjarët e dëshmorëve duhet trajtuar me Ligjin për sigurime shëndetësore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Suzan Novobërdaliu.

SUZAN NOVOBËRDALIU: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Natyrisht se të gjithë e mirëpresim këtë ligj të rëndësishëm meqë parafolësit theksuan disa gjëra që kam pasur në plan t'i them, unë do të ndalem vetëm në dy nene, në nenin 11 ku do të thotë te pika 2 paraqiten personat e liruar nga pagesa e premiumit dhe bashkëfinancimit, tek pika 2.3 do të thotë këtu kufizohen personat me aftësi të kufizuara, thuhet se lirohen nëse janë të strehuar në shtëpitë për persona të moshuar si dhe në shtëpitë për integrim në komunitete, propozoj që mos të jenë të kufizuar në këtë mënyrë, natyrisht edhe kjo të jetë veç të përfshihen edhe personat me aftësi të kufizuar pa marrë parasysh se ku janë të strehuar.

Në pikën 3, do të thotë prapë paraqiten familjarët, qytetarët dhe banorët nga kategoritë në vijim dhe përmenden në vijim cilët janë të liruar, do të thotë nuk pajtohem që thanë që familjet e dëshmorëve nuk janë të përfshirë, sepse të njëjtit janë të përfshirë në pikën 3.4, derisa nuk e di zotëri ministër pse i anashkaloni familjarët e personave të pagjetur. Nuk janë këtu në këtë ligj dhe mendoj se duhet të jenë, do të thotë prindërit, bashkëshorti, bashkëshortja, do të thotë edhe fëmijët e tyre.

Gjithashtu nuk e kam të qartë, do të thotë tek neni 14, shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor, tek pika 6.7 do të thotë në shërbime, këtu përmenden pajisjet ortopedike.

Tani unë nuk e kam të qartë sepse si pajisje ortopedike unë llogaris edhe protezat e ndryshme, a i përfshini këtu edhe karrocet për personat me aftësi të kufizuara apo jo, do të thotë, nëse nuk nënkuptohet ajo tek pajisjet atëherë kisha dashur që të shtohet edhe ajo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Vjollca Krasniqi e merr fjalën.

VJOLLCA KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot u trajtuan disa ligje në këtë segment edhe unë si shumë kolegë mendoj që ky është një ndër projektligjet më të rëndësishme që po e trajtojmë sot.

Do të doja disa vërejtje të mia t'i them në lidhje me këtë projektligj duke filluar nga disa përkufizime.

Në nenin 3, paragrafi 1.1 është çka e nënkuptoj me fjalën qytetar, do të thotë kemi, qytetar nënkupton personin me shtetësi të Republikës së Kosovës sipas ligjit mbi shtetësinë e Kosovës ose person i kualifikuar si refugjat në pajtim me ligjin. Mendoj që shprehja: i kualifikuar, nuk është shprehje tamam për këtë emërtim.

Kemi paragrafin 1.5 po të këtij neni: anëtarë të familjes së ngushtë nënkupton bartësit të sigurimit. Gjithashtu mendoj se ky është një gabim dhe mendoj që në gjuhët angleze dhe serbokroate janë më mirë të përpiluara.

Neni 7 thotë: Shërbimet e garantuara shëndetësore, pavarësisht nga statuti i sigurimit shëndetësor. Mendoj se shprehja apo fjala: statuti, duhet të zëvendësohet me fjalën: statusi.

Gjithashtu paragrafi 1 pikë 3, është i paqartë. Shërbimet e tjera esenciale të kujdesit shëndetësor të përcaktuara nga fondi do të ofrohen pavarësisht nga statusi i sigurimit shëndetësor; vërejtje që e bëri edhe kolegja Breca.

Neni 8, paragrafi 2, siguri shëndetësor vullnetar plotësues nuk mund të zbatojë politika. Unë mendoj që shprehja: zbatoj, duhet të ndryshohet dhe të thuhet: nuk mund të përcaktojë politika.

Dhe ajo që më shtyri më së shumti të marrë fjalën është neni 11 të cilin e tha edhe kolegja Novobërdaliu, është: qytetarët të cilët lirohen nga pagesa e premiumit, individët të cilët janë duke jetuar në institucione shtetërore, fëmijët nën kujdes të sforcuar apo nën kujdestari, unë mendoj që në këtë nen ose në këtë paragraf duhet të futen edhe personat me nevoja të veçanta apo me aftësi të kufizuar të përhershme që nuk jetojnë në këto strehimore, por që jetojnë në familjet tona.

Gjithashtu në po këtë nen, paragrafi 1.3 është: qytetarëve ose banorëve të cilët janë të liruar nga obligimi për të paguar këtë premium në pajtim me këtë ligj, në gjuhën shqipe është i paqartë dhe duhet të harmonizohet me po këta paragrafë të gjuhëve tjera.

Përndryshe, do ta përkrah dhe votoj këtë projektligj.

KRYESUESI: Salihe Mustafa e merr fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!
Ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Projektligji për sigurime shëndetësore është vërtet i rëndësishë së veçantë, është e vërtet se dot ë ishte më mirë sikur Ligji i sigurimeve shëndetësore të aprovohej bashkë me Ligjin e shëndetësisë, por edhe tani nuk është vonë, sepse në Ligjin e shëndetësisë veç është përgatitur baza për këtë ligj.

Kur e them këtë e kam parasysh formimin e Agjencisë Financiare të Shërbimeve me Ligjin e shëndetësisë i cili është paraardhës i Ligjit të sigurimit shëndetësor.

Unë do të ndalem te disa vërejtje apo sugjerime. Shembull te neni 6, paragrafi 2 ku thuhet: Sigurimi shëndetësor i obligueshëm përfshin shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor në listën nga neni 3, paragrafi 1.9.

Është normale që në ligj t'i referohemi neneve të caktuara, por jo edhe nenit ku janë përkufizimet duke pasur parasysh faktin se ky ligj do të implementohet për herë të parë në Kosovë dhe duhet të jetë sa më i qartë.

Në nenin 28 përshkruhen detyrat e Fondit të sigurimeve shëndetësore. Duke pasur parasysh faktin që fondi ia propozon për miratim bordit mbikëqyrës premiumet, bahskëpagesat, pagesat shtesë e të tjera, ky bord mbikëqyrës përbëhet nga 8 anëtarë siç janë ministrat, ministri i Shëndetësisë, i Punës, i Mirëqenies Sociale, ministri i Financave ose përfaqësuesit e tyre. Përfaqësuesi i Odës, i Shërbimit spitalor klinik universitar, përfaqësuesi i kujdesit parësor shëndetësor dhe drejtori i Fondit.

Te përfaqësimi i odave të profesionistëve shëndetësorë mendoj se duhet të sqarohet se si do të përfaqësohen odat duke pasur parasysh faktin se kemi 5 oda të profesionistëve shëndetësorë sipas ligjit në fuqi.

Gjithashtu mendoj që bordi duhet t'i ketë 9 anëtarë e anëtari i nëntë duhet të jetë përfaqësuesi i sindikatave.

Të nderuar kolegë edhe në shumë vende të rajonit është e rregulluar në këtë mënyrë, është përfaqësues në bord edhe përfaqësuesi i sindikatave.

Te neni 37, paragrafi 3 i këtij projektligji bie ndesh me Ligjin e shëndetësisë.

Në nenin 37 të këtij projektligji thuhet: Në afat prej 3 muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji Ministria e Shëndetësisë themelon këshillin përgatitor për themelimin e fondit; ndërsa me Ligjin e shëndetësisë thuhet: Agjencia financiare e shëndetësisë është paraardhës i Fondit.

Mendoj se duhet të thuhet: Agjencia financiare e shëndetësisë në Ministrinë e Shëndetësisë do t'i bartë të drejtat dhe përgjegjësitë në fond dhe të caktohet afati kohor.

Të nderuar është e qartë se do të kemi shumë punë në komision, por edhe gjatë fazës së implementimit do të kemi shumë vështirësi duke pasur parasysh faktin se në Kosovë ka

shumë kategori të cilat duhet të lirohen, por megjithatë mendoj se është koha e fundit që të fillohet me Ligjin për sigurimin shëndetësor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Aurora Bakalli e merr fjalën.

AURORA BAKALLI: Të nderuar deputetë,
Projektligji i shumëpritur dhe i shumëpërfolur për sigurimin shëndetësor më në fund ka arritur për shqyrtim.

Shqyrtimin në Kuvendin e Kosovës të këtij projektligji ne si Lëvizje për Bashkim e mirëpresim dhe konsiderojmë se mungesa e këtij ligji, pra e sigurimeve shëndetësore ka qenë një e drejtë e mohuar e qytetarëve tonë për një periudhë të gjatë kohore.

Për të qenë korrekte ky variant i projektligjit më është dukur shumë më i mirë se sa variantet e përparme që janë diskutuar. Domethënë e vlerësoj faktin se me këtë variant punëdhënësi është i obliguar t'i paguajë 50% të shumës së premiumit për derisa në variantin e mëparshëm është përmendur se e gjithë barra do t'u binte të punësuarve.

Gjithashtu e vlerësoj se parashihet që premiumi të ndahet në bazë të përqindjes së të ardhurave për dallim prej variantit paraprak ku mendohej që të gjithë të paguanin në shumën e njëjtë.

Ndërsa unë ju kisha lutur zoti ministër për disa sqarime nëse ka mundësi sa i përket projektligjit që e kemi para vetes.

Kur jemi te lirimi nga pagesa e premiumit dhe bashkëpagesave thuhet kështu: Qytetarët dhe banorët nga kategoritë në vijim do të lirohen nga pagesa e premiumit, bashkëpagesave dhe detyrimeve tjera të bashkëfinancimit vetëm nëse identifikohen si të varfër, sipas kriteriumeve të testit zyrtar të nxjerrë me aktin nënligjor nga Ministria e Shëndetësisë dhe disa ministri tjera e në këtë kategori janë pensionistët e moshës dhe kontributdhësit, pensionistët e Kompanisë “Trepça” dhe të tjerë të cilët u përmendën.

Më duket se nuk është korrekte që pensionistët duhet të kategorizohen si të varfër, sepse mjaft janë nëpërkëmbur dhe mjaft u është ulur dinjiteti i tyre me ato të ardhura simbolike që i marrin, por për t'u liruar nga pagesa e premiumeve duhet të kenë epitetin e të varfërve që ta gëzojnë këtë të drejtë.

Konsideroj se vetëm ata të pensionuar që janë të paktë në numër do të duhej të liroheshin, vetëm ata që kanë marrëdhënie pune do të duhej të liroheshin nga, po mendoj do të duhej të paguanin premiumin, kurse të tjerët duhet të lirohen.

Në anën tjetër, më intereson për ata që lirohen nga pagesa e premiumeve, a do të paguajë Qeveria në fond në emër të tyre që besoj se do të duhej të ishte kështu?

Sa përket lidhjes së kontratës me fondin më intereson të di çfarë do t'i kenë gjasat institucionet shëndetësore të licencuara private që janë më të vogla, po e ritheksoj - të

licencuara, domethënë i kanë arritur kushtet që të veprojnë, sipas kriterëve që i pash mu duk se gjasat e tyre janë të vogla dhe duket se vijnë ditë të këqija për këto institucione të vogla shëndetësore çka mua personalisht nuk më pëlqen.

Skema e sigurimit shëndetësor po quhet e obligueshme, si mendoni ta bëni të obligueshme për qytetarët, me çfarë masash? Unë përpos në një nen ku e pashë se qytetarët të cilët nuk janë të regjistruar do të paguajnë dyfishin e çmimit nuk kam parë të tjera masa që do të ndërmerrni për t'i obliguar qytetarët që të paguajnë premiumet e tyre.

Neni 37, pika 11 thotë se data e fillimit të mbledhjes së premiumeve do të specifikohet me akt nënligjor. Më intereson të di përafërsisht kur mendoni se do të jetë data e fillimit të premiumeve?

Çështje tjetër është se a mendoni se ngecjet në implementimin e sistemit informativ shëndetësor të integruar do të paraqesin problem për implementimin e këtij ligji, personalisht mendoj që është një problem mjaft i madh pa funksionim... të arrijmë të implemendojmë ligjin që jemi duke e shqyrtuar.

Këto janë disa nga çështjet që më interesojnë. Në parim ne si LB do ta votojmë pro. Faleminderit!

KRYSUESI: Faleminderit! Halit Krasniqi e merr fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, nënkryetar!

Do të përpiqem të përmbledh telegrafikisht të gjithë atë që e kisha konceptuar për trajtim në këtë temë, e cila për të gjithë ka qenë preokupim dhe të gjithë qytetarët e Kosovës kanë qenë të pakënaqur me shërbimet shëndetësore, por tani këtë ligj e konceptoj dhe perceptoj që është një reformë në shërbimin shëndetësor dhe do të jetë një kërcim në cilësinë e jetës së qytetarëve, e cila do të ndërrojë gjithanshëm.

Shumë herë ka qenë temë diskutimi në grupin tonë parlamentar edhe shumë herë e kemi trajtuar si nevojë imediate që ky ligj të vijë dhe të kalojë në Kuvend.

Ligji duhet t'i përmbajë standardet ndërkombëtare dhe për këtë ministri është shumë i ndërgjegjshëm dhe e vërej një përkushtim të tij jashtëzakonisht në formulimet që u prezantuan në projektligj. Nevojë imediate për qasje universale është theks i veçantë edhe realizimi i nivelit të garantuar për përkujdesje shëndetësore, duhet të jetë gjithashtu një nga shtyllat e këtij ligji rregullimi i të drejtave dhe raportet e sigurimeve dhe të siguruarve, të cilët duhet të gëzojnë përkujdesje adekuate.

Ky ligj do të fusë në garë, kështu e kuptoj, institucionet shëndetësore private dhe ato publike dhe kjo e ngrit cilësinë e shërbimeve që do të marrin qytetarët pranë tyre.

Miratimi i këtij ligji pritet nga të gjithë qytetarët e Kosovës dhe deri tani ka qenë hendikep i papërshtueshëm, sepse kjo ka krijuar probleme të mëdha edhe të institucioneve që kanë afruar shërbime, por edhe të kategori sociale të cilat u apostrofuam

nga diskutuesit e mëparshëm të cilët natyrisht që në rasate të keqësimit të gjendjes shëndetësore, përveç se kanë dyshuar në cilësinë e shërbimeve kanë pasur sfida edhe për t'u përgjigjur shpenzimeve që i kanë kërkuar ato shërbime, kështu që kjo është një lehtësim për jetën e qytetarëve dhe ministrin e përgëzoj dhe natyrisht që do të jetë shumë i mirëpritur dhe i përkrahur nga të gjithë deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Do të provoj të jem i shkurtër dhe të mos i përsëris disa nga vërejtjet të cilat u dhanë në ligj, mirëpo fillimisht dua të mbështes ministrin që e ka sjell Projektligjin për sigurime shëndetësore dhe kur kemi debatuar e diskutuar për Ligjin për shëndetësi, atëherë kemi diskutuar që nevojë e domosdoshme Ligjin për sigurime shëndetësore që një herë e përgjithmonë edhe shëndetësia kosovare ta marrë rrugën e saj të sigurt për trajtimin e shumë problematikave të cilat janë në këtë segment.

Dua t'i bëj vetëm disa vërejtje teknike, në veçanti tek qëllimi apo fushëveprimi i ligjit, te qëllimi kur thuhet se sigurimi ... financiar, do të thotë edhe mbrojtje nga varfëria, unë mendoj se nuk e ka vendin te sigurimet fjala varfëria, apo zvogëlimin e varfërisë përmes Ligjit për sigurime shëndetësore për arsye se politikat e varfërisë trajtohen me ligje tjera jo me Ligjin për sigurime shëndetësore, mendoj që është e tepërt të jetë kjo dhe pastaj te çështja e sigurimeve apo të atyre, të cilët lirohen nga bashkëpagesa dhe pagesa e premiumit.

Mendoj që ndoshta është koklavitur pak kjo çështje për arsye se është mirë që kategoritë të cilat lirohen nga pagesa e saj, mirëpo nuk mund të flasim për sigurime shëndetësore kinse dikush lirohet nga pagesa, mirëpo është dikush tjetër i cili do t'ua mbulojë këtë sigurim për ta, prandaj personat të cilët mbulohen nga pagesa përmes institucioneve tjera, qoftë nëse janë ato institucione shtetërore, publike, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo nëse mendohet që kjo pagesë bëhet nga komunat për nga janë personat të cilët kanë nevojë apo personat e varur, persona të cilët do të mbulohen nga ky fond, nëse komuna merr përsipër pagesën e këtyre premiumeve dhe bashkëpagesave të këtyre personave.

Gjithashtu ministër te kjo kategori, te neni 3.5 kur thuhet se veteranët dhe pjesëtarët e luftës, mjafton veteranët, veteranët e luftës të Ushtrisë Çlirimtare, po flasim për ta dhe pjesëtarët e UÇK-së. Ne e dimë që kohëve të fundit kanë aplikuar për statusin e pjesëtarëve të rënëve të UÇK-së afro 62 mijë persona dhe nëse shkohet në këtë formë që të lirohen të gjithë pjesëtarët, mendoj që nuk është korrekt në raport me ata të cilët kanë aplikuar, mirëpo nëse këtë të drejtë e shfrytëzojnë veteranët atëherë tek neni tjetër, neni 2.5. thuhet se invalidët e luftës me shkallë më të lartë të paaftësisë bashkëshortja dhe fëmijët e tyre nën 18 vjet në prapun zyrtar të paaftësisë minimale prej 60% edhe veteranët e UÇK-së edhe invalidët e UÇK-së janë pjesë prapë domethënë veteranë, edhe invalidë dhe veteranë, prandaj nëse e keni selektuar veteranët me 60% është një diskriminim

brenda një kategorie të njëjtë, në veçanti te personat të cilët janë për shembull edhe me 10%, edhe me 20%, domethënë me shkallë të invaliditetit minimal të vlerësuar.

Mendoj se kjo është jo korrekt, neni 2.5 dhe kjo duhet të jetë për të gjithë invalidët të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të gjithë veteranët e UÇK-së, të rregullohet në këtë formë nëse është menduar ashtu në raport me pjesën tjetër.

Gjithsesi te detyrat dhe realizimi i detyrave dhe objektivave të fondit mendoj që duhet të investohet shumë dhe t'i kushtojë Ministria një përkushtim më të madh sistemit të informimit shëndetësor me qëllim të implementimit e pastaj të këtyre politikave të sigurimit shëndetësor dhe te bordi menaxhues i fondit, domethënë është përcaktuar ministri ose përfaqësuesi i tij, do të ishte mirë të precizohej kush është anëtar i bordit, a është ministri apo përfaqësuesi, jo edhe, edhe, edhe.

Domethënë, mirë është mirë t'i bëjmë gjërat precize për arsye që mos të kemi pastaj problematika me menaxhimin, mendoj që ky bordi menaxhues është një prej organeve kyçe i cili ka për t'i zhvilluar edhe politikat e sigurimeve shëndetësore, prandaj do të duhej të lihen në formën e tillë me ose, ose, të precizohet sa e kush janë anëtarë të bordit, me çfarë të drejte dhe besoj se ndoshta për shkak që shumica e këtyre zgjedhjeve të fundit, kohëve të fundit janë nga neuropsikiatria, besoj se që është mirë këtu që duhet të jetë edhe neuropsikiatër gjithsesi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministër, nëse ke shkurt, sepse do të kalojmë në votime. Urdhëro, ministër!

MINISTRI FERID AGANI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Nuk do të zgjatem, vetëm shkurt. Ju falënderoj për diskutimin, komentet, sugjerimet që i dhatë dhe kritikën, natyrisht edhe për mbështetjen.

Vetëm disa sqarime për hir të punës së mëtutjeshme që i kemi në projektligj, që të mos kemi dilema.

Kur është në pyetje thyerja e parimit të barazisë, drejtësisë, universalitetit më mirë të themi solidaritetit që u përmend, se jo të drejtësisë, mendoj që duhet pak më me kujdes të lexohet teksti i projektligjit.

Në esencë të punësuarit në ndërmarrjet me më pak se 50 mijë euro qarkullim në vit ose që kanë tatim në vlerë të shtuar të deklaruar, ata nuk lirohen nga pagesa e premiumit të sigurimit shëndetësor, ata e paguajnë sigurimin shëndetësor sikur qytetarët e tjerë.

Pse është bërë kjo ndarje, vetëm për t'i ikur informalitetit, sepse ka qenë rreziku në qoftë se i obligojmë edhe pronarët e ndërmarrjeve të vogla për t'i paraqitur për ta bërë pagesën për punëtorët e tyre, atëherë ata ka qenë rreziku real dhe në bazë të hulumtimeve kjo është vërtetuar se ata de fakto nuk do t'i paraqesin punëtorët, nuk do t'i paraqesin punëtorët dhe do të rrisin informalitetin, prandaj është bërë ky dallim.

Përndryshe, në qoftë se shihet ngarkesa, shihet që 3.5 euro për një anëtar të familjes dhe 3.5% në pagën mesatare është shumë e njëjtë mujore. Është shumë e njëjtë mujore sa i përket ngarkesës.

Progresiviteti nuk është në projekt, bile është një vlerë e këtij ligji se e kemi afirmuar dukshëm progresivitetin në krahasim me variantin e mëparshme se bëhet fjalë për 3.5% në pagën e cila ndryshon, varësisht prej punëtorit, do të thotë nuk janë të gjithë me një pagë, por vlera, ngarkesa është ndryshe. Do të thotë ngarkesa shkon duke ndryshuar.

Te neni 13, në asnjë mënyrë ligji nuk lejon që lista e shërbimeve themelore të kujdesit shëndetësor të cenohet gjatë vitit. Shërbimet do t'u ofrohet qytetarëve në çfarëdo mënyre, në qoftë se fondi thuhet bie në ekonomizim negativ atëherë në atë situatë ose do të zvogëlohen pagesat ofruesve të shërbimeve shëndetësore ose do të rritet bashkëfinancimi i qytetarëve, atyre që kanë për ta bërë pagesa, por jo të cenohet vëllimi ose cilësia e shërbimeve shëndetësore për vitin i cili bëhet fjalë.

Kur është në pyetje buxheti, u përmend natyrisht që në kornizën afatmesme të shpenzimeve tash 2014-2016 do t'i parashohim këto mjete shtesë që janë 18 milionë euro në vit. Pra, kaq është kostoja e Ligjit për sigurimin shëndetësor në vitin 2015 dhe tutje.

Kur janë në pyetje definimi i të pagjeturve dhe familjeve të pagjeturve dhe familjeve të dëshmorëve si shfrytëzues të benefiteve të fondit, nuk ka kurrfarë dileme në atë që ne si sponsor të ligjit gjithsesi kemi pasur parasysh këto kategori dhe pa asnjë dilemë këta qytetarët dhe banorët do të jenë shfrytëzues të këtyre benefiteve, por kanë qenë të përfshirë me emërtimet të cilat janë në paragrafin 3.4, 3.5, 3.7 - viktimat civile të luftës, familjet e martirëve, veteranët dhe pjesëtarët e luftës, pjesëtarët e luftë mu këtë duke përfshirë dhe synuar këtë kategori të familjeve të dëshmorëve, por mund të specifikohet edhe më qartë pa asnjë problem, sepse janë kalkuluar, janë pjesë të kalkulimeve financiare, nuk paraqesin kurrfarë problemi dhe mund t'i specifikojnë në mënyrë të qartë ashtu siç është kërkuar edhe sonte, pa asnjë problem.

Një çështje specifike ka qenë identifikimi i të varfërve, në mesin e këtyre kategorive që u përmend, është një çështje e cila ka pasur të bëjë edhe me aspektin e funksionimit financiar të fondit dhe këtu në këtë aspekt është lënë kjo që të rregullohet me akt nënligjor. Në esencë qëndrimi i Ministrisë është që të gjithë ata të cilët kana një asistencë sociale nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të jenë shfrytëzues të dobive të benefiteve të këtij fondi. Pra, edhe kalkulimet shkojnë në atë drejtim dhe mendoj që nuk do të ketë cenime serioze të këtyre të drejtave të këtyre kategorive të qytetarëve edhe kur përpilohet ai akt nënligjor. Pra, edhe kur përpilohet ai besoj se do ta kemi këtë situatë.

Dy fjali për të ardhmen, mendoj se ju interesojnë, kur do të fillojë pagesa e premiumeve, kur i kemi planifikuar?

Sipas projektit të Bankës Botërore i cili është kah e mbështet dhe veç ka filluar me e mbështetur zbatimin e Ligjit të sigurimeve shëndetësore pas miratimit të tij e kemi një projekt prej 25.6 milionë dollarë i cili është në proces të akomodimit brenda marrëveshjes

me Bankën Botërore nga ana e Qeverisë së Kosovës, një pjesë e mjeteve është liruar si paradhënie të shfrytëzohet, kemi filluar vetëm punën në themelimin e sistemit informativ të fondit të sigurimeve shëndetësore, planifikohet që prej tetorit të këtij viti të fillojë grumbullimi i premiumeve.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Zonja e zotërinj deputetë, ju lutem uluni!

63 deputetë janë. Tash i kemi tri votime, ju lutemi t'i kryejmë punët, kjo është me rëndësi, kemi punuar me efektivitet dhe e nxjerr në votim Projektligjin për sigurimin shëndetësor. Votojmë tash!

Me 63 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për sigurimin shëndetësor.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregullore ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportin me rekomandime.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës

Zenun Pajaziti a ke çka thua, apo kalojmë në votime? Zoti Pajaziti, shkurt!

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

Janë gjithsej 24 amendamente, ka pasur një koordinim dhe një akordim brenda komisionit për këtë projektligj, pas një monitorimi që e kemi bërë si komision dhe pas kësaj gjendjeje që ka qenë aty është i mirëseardhur ky ligj, ju ftoj ta votoni të gjithë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti Pajaziti!

Janë 24 amendamente.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 11

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 12

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 13

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 14

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 15

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 16

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 17

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 18

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 19

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 20

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 22

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 23

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

E lus regjinë dhe deputetët që të votojmë për ligjin me të gjitha amendamentimet që i miratuam. Pra, me ligjin e amendamentuar.

63 deputetë janë të pranishëm. Votojmë tash!

Me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

12. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie

Zonja e zotërinj, do t'i propozoni anëtarët për Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve.

PDK-ja i propozon 2 anëtarë. Zoti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

PDK, do të thotë Grupi Parlamentar i PDK-së i propozon dy deputetë: Xhevahire Izmakun e cila do të jetë edhe kryesuese dhe deputetin Ramë Vataj për këtë Komision ad hoc. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! LDK-ja propozon, unë e kam një listë. A është kjo? Pra, propozon deputetin Salih Morina dhe Sadri Ferati. Faleminderit!

“Vetëvendosja”, Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Deputeten Albulena Haxhiu!

KRYESUESI: Faleminderit! AAK-ja? Burim Ramadani e ka fjalën.

BURIM RAMADANI: Faleminderit! Deputeten Teuta Haxhiu.

KRYESUESI: Koalicioni Kosova e Re?

MYZEJENE SELMANI: Deputetin Jeton Svirca.

KRYESUESI: SLS e propozon Jelena Bontiq.

KRYESUESI: Grupi “6+”?

MUFERA SHINIK: Albert Kinolli.

KRYESUESI: Atëherë, një votim i hapur formal për këtë komision.

Faleminderit! A ka kundër?

Faleminderit për bashkëpunim dhe shihemi në mbledhjet tjera.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*